

MYZAFER SPAHO

949.65-184/1844

+355/486-51

S 85

RRETH
E RROTULL
E NË DEVOLL

949.65.194-1544
+355(496.5)

S

S 85

MYZAFER SPAHO

R

RRETH E RROTULL E
NË DEVOLL

(Nga ditarët e Luftës nacionalçlirimtare)

34 x 80

~~49587~~

LIBRARI E SHIETI
"PROHABIT"

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PARATHËNJE

Libri «Rreth e rrotull e në Devoll», i shkruar nga Myzafer Spaho, është një dokument i rëndësishëm historik. Ai flet për ngjarjet më kryesore të Luftës nacionalçlirimtare në Devoll.

Ky libër është një radhitje kronologjike ngjarjesh të luftës në Devoll. Një pjesë e shënimeve janë mbajtur qysh gjatë luftës, prandaj ato flasin me saktësi për vendin, kohën dhe mënyrën e zhvillimit të ngjarjeve më kryesore. Këtu qëndron edhe vlera e librit, për të cilin nuk duhet të ketë pretendime nga ana letraro-artistike.

Si përgjegjës politik në çetë dhe në batalion, si pjesëmarrës i ngjarjeve që përshkruan, autori pasqyron në to jo vetëm aksionet luftarake, por edhe veprimtarinë e gjerë politike e organizative të organizatave të partisë dhe të shtabeve drejtonjëse. Duke lexuar këto shënime dalin qartë: 1) roli i Partisë Komuniste si udhëheqëse e Luftës nacionalçlirimtare. Në të gjitha rastet e veprimeve të gjera politike, organizata e Partisë mbilidhej rregullisht, shqyrtonte situatën, bënte kritikën e veprimtarisë së saj dhe merrte masa për veprime të mëtejshme. Lidhjet e çetës dhe më vonë të batalionit me komitetin qarkor të Partisë ishin të pandër-

prera; 2) lufta e gjerë e partizanëve të Devollit, të cilët kanë luftuar jo vetëm në krahinën e tyre por edhe në zona të tjera si në Leskovik, Përmet, Mokër e kudo që shihej e nevojshme; 3) lidhja e ngushtë me popullin, e cila ishte baza e sukseseve të komunistëve dhe partizanëve. Populli e furnizonte çetën dhe batalionin jo vetëm me ushqime e veshmbathje, por edhe me luftëtarë.

Gjatë Luftës nacionalçlirimtare (kompani të plota partizanësh dhe kuadro të zgjedhura, me urdhër të Partisë, shkuan në Brigadën e parë sulmuese, në Brigadën e katërt sulmuese, në Brigadën e shtatë sulmuese, në Brigadën e pesëmbëdhjetë sulmuese dhe në Brigadën e njëzetë sulmuese. Më në fund i gjithë batalioni u inkuadrua në radhët e Brigadës së nëntë sulmuese.

Kudo që kanë shkuar, partizanët e Devollit, si të gjithë partizanët e krahinave të tjera, kanë luftuar me heroizëm dhe e kanë mbajtur gjithmonë lart flamurin e partisë.

Eshtrat e dëshmorëve që prehen në vorrezat e dëshmorëve në Bilisht, janë një dëshmi e përjetshme e qëndrimit patriotik e luftarak të popullit të Devollit, i cili me besim të patundur në udhëheqjen e drejtë të Partisë Komuniste dhe të udhëheqësit të dashur shokut ENVER HOXHA nuk kurseu asgjë për arritjen e fitores së plotë mbi armiqtë.

Besnik i traditave të tij dhe të Luftës nacionalçlirimtare, populli i Devollit ka mbajtur një qëndrim të lartë patriotik dhe luftarak edhe mbas çlirimit të vendit. Në vitin 1949, në ditët e proklacioneve të egra të monarkofashistëve grekë, po-

pulli i Devollit qëndroi i paepur e krah për krah me forcat e armatosura të Ushtrisë sonë Popullore. Në brezin e gjatë kufitar, nga një anë me monarkofashistët dhe nga ana tjetër me renegatët e Beogradit, populli i Devollit ka qenë roje vigjilente dhe i gatshëm për të asgjësuar agjentët dhe diversantët.

Për të zbatuar vijën e partisë në fshat, lidhur me kolektivizimin, populli i Devollit bëri një luftë të ashpër me kulakët. Ai ka ngritur kooperativa të mëdha bujqësore, ka vendosur organizimin socialist të punës në fshat dhe me aftësinë e vullnetin që e karakterizon ka arritur suksese të mrekullueshme në lulëzimin e krahinës së tij.

Nën udhëheqjen e partisë sonë të lavdishme dhe të shokut ENVER HOXHA populli i Devollit, si i gjithë populli shqiptar, do të ecë gjithmonë përpara në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe do t'i dërmojë kokën çdo armiku që do të guxojë të prekë sado pak kufitë e atdheut tonë të shtrenjtë.

Mihallaq Ziçishti

DY FJALË MBI DEVOLLIN

Devoll i thonë lumit që buron nga malet e larta të Gramozit dhe që prej andej rrjedh në tokën e atdheut tonë. Devoll i thonë edhe luginës së ngushtë që shtrihet midis malit të Moravës dhe Vargmaleve të Thata. Devollin u thonë edhe banorëve të fshatrave të bukura që shtrihen në të dy anët e luginës, që nga rrjedhja e Devollit e gjer te gryka e Çergonjit!

Për pozicionin e saj gjeografik, si dhe për prodhimet e shumta bujqësore e blegtorale, krahina e Devollit është bërë vazhdimisht shesh luftrash të gjata me ushtritë e huaja si ato turke, greke, serbe, austriake, franceze e të tjera që kanë shkëlqur në Devoll gjer në vitin 1920. Këto ushtri kanë vrarë e kanë djegur, kanë plaçkitur e kanë shkatërruar çdo gjë, por devollinjtë asnjëherë nuk u janë nënshtruar.

Edhe në Luftën e dytë botërore Devolli u bë një qendër zjarri e rëndësishme kundër forcave fashiste. Më 1940-1941 Devolli u bë sheshi i përleshjeve të përgjakshme midis popullit grek dhe forcave skllavëronjëse fashiste italiane.

Krahina e Devollit, me qendrën e saj Biliishtin, zë një sipërfaqe shumë të vogël në pjesën

më juglindore të atdheut tonë. Ajo kufizohet në pjesën më të madhe me Greqinë dhe në fshatrat e Malit të Thatë edhe me Jugosllavinë. Një rrugë e rregullt automobilistike rreth 26 km e gjatë e lidh Bilishtin me Korçën nga ana juglindore, ndërsa një rrugë tjetër, që kalon nga Boboshtica nëpër Dardhë-Bozhigrad-Poloskë e që del në Bilisht, e lidh këtë të fundit me Korçën nga ana veriperëndimore. Të dyja këto rrugë përbëjnë një unazë rreth Devollit. Nga këto rrugë kryesore, në të cilat qysh në atë kohë kalonin jo vetëm kamionat por edhe tanket e autobлиндat, fshatrat e ndryshme të Devollit nuk janë më tepër se 5 km larg.

Shumica e tyre lidhen me rrugën kryesore me xhade të rregullta automobilistike, gjë që i krijonte armikut kushte të favorshme veprimi. Megjithatë edhe në Devoll shpërtheu dhe u zhvillua lufta e gjerë partizane kundër forcave fashiste italo-gjermane dhe shërbëtorëve të tyre.

Zëri i Partisë sonë Komuniste Shqiptare, që u themelua më 8 Nëntor 1941, kumboi edhe në Devoll. Edhe aty luftuan me vendosmëri kundër armikut njësitet guerrile, organizatat e Partisë Komuniste, çetat e batalionet partizane — i gjithë populli i asaj krahine. Me besim të patundur në udhëheqjen e drejtë të Partisë dhe të birit më të dashur të popullit tonë, shokut ENVER HOXHA, devollinjtë u hodhën pa ngurrim në kryengritjen e armatosur.

Armiku ushtroi terrorin për të mposhtur devollinjtë. Ai dogji qindra shtëpi të fshatrave Poloskë, Hoçisht, Kuç, Braçanj, Bradvicë, Grapsht e të tjera.

Me qindra fshatarë u arrestuan dhe u futën në kampet e burgjet fashiste. Midis tyre ishin Ilija, Ylli, Xha Feimi, Xhevdeti, Shabani, Gurja, Fani, Miti, Ilua, Ligori dhe shumë të tjerë. Por të gjitha këto masa jo vetëm që nuk e ulën rezistencën e devollinjve ndaj armikut por e shtuan edhe më tepër urrejtjen kundër tij. Mbas çdo përlëshjeje me fashizmin, në radhët e çetës e të batalionit hidheshin me dhjetëra partizanë të rinj si nga Hoçishti, Poloska, Bradvica, Babani, Ziçishti, Dardha, Grapshti, Bitincka e nga fshatra të tjera.

Buzë xhades Bilisht-Korçë, në një lulishte të bukur, nën kodrinat e gjelbëruara të Devollit, prehen eshtrat e dhjetëra dëshmorëve që ranë trimërisht në betejat për çlirimin e vendit tonë.

Për këta dëshmorë, për Devollin e tyre, për devollinjtë mund të shkruhet shumë! Por në këtë libër po përshekruhen vetëm disa nga ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur në Devoll gjatë luftës së ashpër dhe heroike të pullit tonë.

MUAJT E PARË TË VITIT 1942

Fashistët italianë lëviznin në të gjitha anët e Devollit. Rruga automobilistike Korçë-Bilisht-Follorinë, buçiste vazhdimisht nga zhurma e motorave të tankeve, autobлиндave dhe kamionave. Gryka e Cangonjit dhe ajo e Kapshticës e thëthënin këtë zhurmë dhe e shpërndanin në të gjithë luginën e Devollit. Ajo bëhej edhe më e fortë, kur në qiellin e Devollit fluturonin edhe aeroplanët fashistë. Dhe kjo zhurmë përsëritej çdo ditë!

Por veç forcave lëvizëse të armikut, që kalonin nëpër rrugën automobilistike, në Devoll kishte edhe forca fashiste të përqëndruara.

Në Bilisht, në Zëmlak dhe në fshatra të tjera, garnizonet e armikut përbënin batalione të mëdha dhe të armatosura. Çdo mbrëmje ata futeshin brenda telave me gjemba, kishin frikë, kurse gjatë ditës dilnin nga strofkat e tyre dhe shkonin edhe në fshatrat e tjera. Ata shkonin për të rrëmbyer ndonjë vezë, pulë... a ndonjë dele. Kish edhe prej atyre që në qilaret e shtëpive rrëmbenin edhe pekmez, djathë, turshi dhe po të gjenin edhe raki.

— Ujku shëtiti vetëm natën, ulkonja fashiste të rëmben edhe në mes të ditës, — thoshin fshatarët e Devollit.

Populli nuk i duronte këmishëzinjtë. Ai ushqente për ta një urrejtje shumë të madhe. Kur i shihte, nuk linte fjalë pa thënë. Në fillim ai fliste vesh më vesh, me zë të ulët... Njerëzit pëshpërisnin, mallkonin, shanin... midis tyre. Urrejtja shfaqej më me forcë dhe më hapur nga më të rinjtë.

«Armiku do plumbin! Ai duhet zhdukur! Armiku na ka shkelur vatrat tona! Ai duhet shporrur!...» — të tilla ishin fjalët tona. Ne nuk dinim shumë. Me këto fjalë të përgjithshme bisedonim ne. Por më vonë gjuha jonë filloi të zgjidhej, të bëhej më e mprehtë...

Po, në fillim ne ishin gjysmëmemece por u shëruam nga kjo sëmundje vetëm kur filluam të ushqeheshim nga Partia.

Traktet e Partisë Komuniste Shqiptare filluan të qarkullonin edhe në Devoll. Prej tyre mësonim gjëra të reja. Ato na sqaronin se ç'ishte fashizmi dhe si duhej luftuar kundër tij. Gjuha e trakteve ishte e thjeshtë dhe kuptohej nga të gjithë. Zjarri i tyre ngrohte edhe zemrat e më të dobtëve.

Traktet, komunikatat, broshurat dhe çdo material tjetër studjohej me kujdes. Ato kalonin dorë më dorë me parullën e pavdekshme: «Lexojë, shpërndaje, armikut mos ja dorëzo!»

Komunistë, simpatizonjës dhe aktivistë të Luftës nacionalçlirimtare, të rinj dhe të reja i punonin ato në mbledhje me fshatarët. Prej tyre fshatarët

mësonin se ç'bëhej jo vetëm në Shqipëri por edhe në të gjithë botën.

Për komunistët që kryenin atentate kundër agjentëve kryesorë të fashizmit thurreshin legjenda popullore. Dhe këto legjenda përhapeshin me shpejtësinë më të madhe dhe për shumë ditë me radhë bëheshin objekt bisede midis fshatarëve.

«U lumtë trimave! Kështu e do dushmani! Ore, po bjeri si në luftën e Vlorës!... Tani kemi «edhe kokë» prandaj s'duhet të trembemi» — thoshin pleqtë ata që kishin parë edhe luftëra të tjera.

Me këto fjalë populli i Devollit shprehte gëzimin e tij për zgjerimin e luftës kundër pushtuesit italian dhe dashurinë për partinë, që e udhëhiqte në atë luftë.

Në komunikatat e partisë jepeshin sqarime edhe për luftën e Ushtrisë së Kuqe. Në atë kohë Ushtria e Kuqe kishte filluar kundërgoditjet. Sulmi nazifashist mbi Moskë kishte dështuar. Armatat e STALINIT i sprapsën gjermanët. Mbas disa muajve forcat e mëdha të popullit sovjetik, të udhëhequra nga strategu më i madh i kohës J.V. Stalini, ishin hedhur në kundërsulm të përgjithshëm për ta shpartalluar plotësisht armikun. Të gjitha këto lajme fshatarët i dëgjonin gojëhapur. Ata çuditeshin dhe gëzoheshin. Shumë prej tyre thoshin: «Moskovi do t'ua thyejë turinjte Duçes dhe Hitlerit... Bolshëvikët e Xha Leninit, nuk e shkelin varrin e tij. Forca e Moskovit... është edhe forca jonë.»

Me këto fjalë fshatarët e Devollit shfaqnin dashurinë e tyre për popullin e madh sovjetik, për partinë e madhe të Leninit dhe të Stalinit.

Lajme të tilla, për «Vendin» dhe për «Botën», siç thoshin fshatarët, kërkoheshin vazhdimisht. Atë ishishin të nevojshme për të gjithë. Për të marrë këto lajme ne shkoni sa më shpesh në Korçë.

Fuat Babani, që ishte përgjegjës i punës së partisë në Devoll, bënte çmos që të siguronte sa më tepër materiale të tilla. Të gjithë mbanim lidhje me të.

Materialet për Arrëzë e Sinicë i merrnin direkt Andoni dhe Ndreku, për Progër e Maçurisht — Dhosi dhe Lefteri, për Poloskë e Ziçisht — Mihaçllaqi e Medati, për Hoçisht, Baban e Bilisht ne me Izminin e Faikun. . . e kështu me radhë. Materialet përhapeshin me shpejtësi. Në çdo fshat bëhej komentimi i tyre. Qëllimi i partisë për forcimin e luftës kundër fashizmit njihej nga të gjithë. Kështu u shtuan edhe aktivistët e Luftës nacionalçlirimtare, u formuan grupet edukative të simpatizonjësve të partisë, njësitet guerrile me nga tre a katër veta dhe aktivet e Rinisë Komuniste.

Kudo diskutohet për direktivat e partisë. Të gjithë kërkoni të dinin sa më shumë. Të rinjtë ishishin edhe më kuriozë. Ata kërkoni të mësonin jo vetëm mbi luftën, por edhe mbi çështje të tjera. Në takime, në mbledhje, ata pyesnin: «Ç'është socializmi? Ç'është komunizmi? Si do të ndahet pasuria mbas luftës? Si do të jetë qeverisja?..»

Shumë pyetjeve ne u jepnim përgjigje të drejta, por kishte edhe pyetje, të cilave u jepnim përgjigje gjysmake. Nga broshurat dhe librat e ndryshme të partisë që na vinin vazhdimisht, ne mëso-

nim gjëra të reja, të cilat na ndihmonin për t'i kuptuar drejt ato pyetje që ne u ishim përgjigjur jo saktë.

* * *

Ditën e mërkurë, më 27 maj 1942, së bashku me Llaqin u mbledhëm në shtëpinë e Midatit në Poloskë për të shqyrtuar punën tonë. Ndërsa ne ishim në mbledhje, Ylli dhe Shefqeti i vogël bënë roje para portës. Në atë mbledhje doli se shumë të rinj ishin të pakënaqur mbasi nuk i merrnim në qdo mbledhje. Grupet edukative dhe njësitet guerrile ishin ende shumë të ngushta. Në to ne zgjidhnim vetëm disa. Të tjerët mendonin se ne mbanim «hatër».

Nëpër fshatrat kishin filluar të punonin kundër nesh agallarët dhe bejlerët. Djemtë e tyre bënin propagandë se fashizmi nuk zdukej me luftë. Ata që flisnin më shumë ishin Ali Agushi dhe Hydbi Kulla, të cilët kishin mbaruar Normalen e Elbasanit dhe ishin mësues. Ata shëtisnin fshat më fshat dhe krijonin baza nëpër agallarët e bejlerët. Ata e quanin veten «nacionalistë». Që kur ishte nxënës në Normalen e Elbasanit Aliu hiqej si «patrioti» më i mirë.

Për të gjitha çështjet që diskutuam në Poloskë informuam Fuatin në Baban dhe Taqin e Nevzatin në Korçë. Në mbrëmje vonë u shpërndamë... secili në drejtim të vet.

ÇETA «MORAVA»

Ditën e martë, në 26 qershor 1942, u bë mbledhja e grupit edukativ të Babanit e Stropanit. Në të morën pjesë: Guçja, Malja, Hamdiu, Fuat Agastra, Qamua e të tjerë. Fuat Babani foli shumë, si për frontin sovjetik, për çetat partizane, për detyrat tona...

— Ngado bëhet luftë, — tha Fuati. — Ushtria e kuqe nuk tërhiqet më. Stalini i gozhdoi fashistët. Partizanët sovjetikë po i shkatërrojnë prapavijat e armikut. Në vendet e pushtuara nga fashizmi popujt janë ngritur më këmbë. Në Jugosllavi lufta partizane po zgjerohet çdo ditë. Në Greqi e në Francë lëvizja çlirimtare po shkon përpara. Edhe në Shqipëri lufta po zgjerohet. Çetat partizane në Pezë, në Dibër dhe kudo janë hedhur mbi armikun. Njësitet guerrile po pastrojnë çdo ditë spiunët e shitur tek fashizmi. Në përpjekje me armikun u vra heroikisht sekretari politik i Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste Shqiptare shoku Qemal Stafa. Në përleshje me fashistët derdhën gjakun bijtë e partisë Perlat Rexhepi, Jordan Misja e Branko Kadija. Njëpër male po ngrihen çetat partizane. Edhe në Gorë dhe në Mokër u formuan çeta të tilla. Situata është në favorin tonë. Ne duhet të përgatitemi më mirë, të shtojmë bazat në çdo fshat, të armatosemi sa më shumë, të shtojmë numrin e pjesëtarëve në njësitet guerrile. Ne, — përfundoi Fuati, — duhet të jemi gati për aksione të guximshme.

Fjalët e tij ishin fjalët e partisë. Ato na dhënë zjarr dhe kurajë. U shpërndamë të gëzuar... me forca të reja... Lëvizjet tona nga një fshat në tjetrin u shtuan. U shtuan edhe mbledhjet... sqarimet... Lajmet e reja përhapeshin me shpejtësi. Ato shtoheshin nga dita në ditë.

Më 21 korrik 1942 shokët e Korçës dogjën depot e Fabrikës së Birrës. Më 22 korrik të po atij viti në Korçë komunistët dogjën zyrat e fashizmit. Nga Nevzati dhe Taqi morëm urdhërin e Qarkorit që në mbrëmjen e 24 korrikut të prisnim në Devoll të gjitha linjat telefonike të armikut. Urdhërin e zbatuam.

Njësitet guerrile të fshatrave të Devollit u hodhën në veprim. Detyra e caktuar u krye me sukses. Atë natë ky aksion u krye në të gjithë Shqipërinë. Armikun e zuri frika.

Për këtë aksion të përgjithshëm Shoku Enver Hoxha, në Kongresin I të Partisë Komuniste Shqiptare, tha:

«...Dhe më 25 korrik 1942 asnjë vijë telefonike dhe telegrafike nuk punonte në gjithë Shqipërinë. Ato ishin prerë nga guerriljet tona. Forcat italiane në Greqi të trembura nga kjo situatë, lajmëronin me ngutësi komandën e tyre:

Gjendja alarmuese e Shqipërisë na vë në rrezik forcat tona që kemi në Greqi, nuk i ndejmë shpatullat e sigurta»).

Në ditët e para të korrikut në Moravë u dukën partizanët e parë: Thimi, Sofokliu, Endri, Ilua, Todi i Vogël etj, të cilët ishin pjesëtarët e parë të grupit partizan. Me shokun Raqi Themeli si komisar politik ata formuan çetën partizane të Devollit. Me vendim të Qarkorit, ajo u quajt çeta «Morava». Çeta e mori këtë emër sepse Morava do të ishte baza kryesore e veprimit të saj. Çeta filloi të hynte fshat më fshat. Ajo ishte e vogël në numër. Kujdesi i popullit për të ishte shumë i madh. Bazat ku e shpinte ai ishin shumë të sigurta.

Duke kaluar nga njëri fshat në tjetrin, më 7 gusht¹⁾ 1942 çeta u ndesh në Gjyras me një patrullë milicësh, që udhëtonin nga Bilishti në Korçë. Dy këmishëzinj mbetën të vrarë. Ky aksion bëri bujë. Gëzimi i fshatarëve ishte i madh. Ata e komentonin atë në mënyra të ndryshme.

— Po bëhet si në kohën e Çerçizit e të Themistokliut, — thoshin pleqtë.

— E po... kështu ka lezet... Lufta s'bëhet me llafe, — thoshin të rinjtë.

— Më plaçin sytë, — thoshte Eqremi, — po s'e bënë partizanët atë që thonë!

Por armiqtë e popullit filluan të vepronin kundër partizanëve dhe të shpifnin për ta.

1) 7 gushti ka mbetur edhe si dita e formimit të batalionit «Fuat Babani» në Devoll dhe festohet çdo vit

«Partizanët janë agjentë të Moskës e të Athinës, ata duan t'i venë zjarrë Shqipërisë» thoshin.

Qëllimi i armikut ishte që ta largonte popullin nga lufta kundër fashizmit. Por partizanët shkolin në çdo fshat dhe i sqaronin fshatarët. Raqi fliste pa pushim. Ai nuk lodhej. Fliste ngadalë. Edhe kur i bënin pyetje me thumb, ai nuk nxehej. E merrte gjithnjë shtruar dhe u linte fshatarëve të kuptonin se partizanët nuk ishin agjentë të Moskës apo të Athinës, porse ishin ngritur në luftë kundër pushtuesve e tradhëtarëve të vendit.

Xha Nesimi i Braçanjit në fillim nuk ishte i qartë, por partizanët e bindën atë dhe ai u thoshte të tjerëve:

— Këta do t'ja zbardhin faqen kombit... Ata që lehin kundër partizanëve nuk janë në tërezi...

KOMUNISTË DHE NACIONALISTË

Veprimet e çetës e detyruan armikun të kundërvepronte. Parullat kundër Luftës nacionalçlirimtare shtoheshin. Ali Agushi nga Stropani, Hydbi Kulla nga Tresteniku, Fuat Tefiku nga Eçmeniku, Demirsha Rexhepi nga Stropani e shumë të tjerë si këta po e shtonin veprimtarinë e tyre.

Disa herë u takuan edhe me ne. Ata e hiqnin veten nacionalistë të kulluar, kurse neve na quanin të gabuar. Për këtë ne haheshim gjithmonë. Grindja më e madhe u bë të djelën në mbrëmje, me 30 gusht 1942. Së bashku me Fuat Babanin u mblodhëm në

shtëpinë e Demirshahut në Stropan. E filluam shtruar, por dalëngadalë muhabeti u trash:

Ju jeni bolshevikë, — na tha me inat Demirshahu. — Juve ju heq për hunde Moska.

— Le t'i bashkojmë forcat për të mirën e atdheut, — propozoi Fuat Eçmeniku.

— Ne kemi njerëz të zot që na udhëheqin, — fliste me diplomaci Aliu.

Pastaj hidhej Hydbiu:

— Gani Zëmlaku, Sami Bitincka, Mahmut Zëmlaku, Emin Suli me shokë janë udhëheqës të kombit në rrethin e Korçës.

Ndërroni rrugë sa s'është vonë... Kuptojeni se ushtritë e blinduara të «Duçes» nuk zhduken lehtë!

— Ata i kanë në mendje të gjithë patriotët e ndershëm që mendojnë për Shqipërinë, — thoshte Aliu me mburrje.

Në atë mbledhje u përmendën edhe Safet Butka, Fazlli Frashëri e Lumo Skëndoja.

Biseduam gjatë. Fuati me durim u foli «nacionalistëve» për personat që Hydbiu i quante udhëheqës të «kombit». Ai tha se Gani Zëmlaku më 1939 e kishte pritur Zogun në shtëpinë e tij kur ai do të arratisej nga Shqipëria për në Greqi, se Mahmut Zëmlaku qysh në fillim ishte vënë në shërbim të milicisë fashiste, se Sami Bitincka kishte vënë dhjetëra kopsa fashiste për t'u bërë deputet.

— Të tillë janë të gjithë krerët tuaj. Ata nuk e luftojnë fashizmin. Ne do të vazhdojmë rrugën tonë. Jeta do të vërtetojë se kush ka të drejtë, — me këto fjalë e mbylli Fuati diskutimin e tij dhe u ngrit.

Kur dolëm nga shtëpia e Demirshahut ishte mesnatë. Morëm rrugën për në Baban. Fuati shkoi

në Korçë dhe e njoftoi komitetin qarkor të Partisë për gjithshka folëm me «nacionalistët». Edhe ne ua spjeguem të gjitha shokëve tanë.

NJË PARTIZAN MË SHUMË

«Do të të pyes për çetën, se kam një mik që ka dy javë që rri fshehur në shtëpinë time. Ai ka vrapuar një njeri në Krrabë të Tiranës dhe ka ikur. E kam kushëri. Ai kërkoi të dalë partizan». Kështu e nisi bisedën një «miku» im të enjten e 10 shtatorit 1942, kur më ndali tek çezma e Demirit.. në Bllisht.

Mendova se mos më bënte ndonjë provokim, mbasi «miku» im ishte edhe mik i njohur i fashizmit, megjithatë i vajta në shtëpi. Nënë Sherikua më priti me gëzim. Pas pak më solli një tas me kos dhe bukë të ngrohtë. Më folën përsëri për njeriun e fshehur.

Dyshimi im u largua, kur papandehur u hap dera e sergjenit, prej nga doli një djalë i bëshëm i veshur me brekushe të zeza. Ai e kishte dëgjuar bisedimin tonë.

— Të lutem, shok, mos më mendo më! Merrmëni në çetë dhe keni për të parë se si do të luftoj. U çmenda në këtë dhomë! — kështu tha ai dhe më përqafoi duke qarë. E pyeta gjatë, e hodha fjalën andej e këtej, por s'i nxora dot asgjë. Ai dukej djallë i thjeshtë dhe me shpirt të pastër. U ngrita të ikja. Ai s'më linte. Desh përgjegje. Dhe përsëri më përqafoi duke më thënë:

— Fundja një taksidar që ai qen që vrava... Ja piu gjakun milletit.

Biseduam me shokët dhe njoftuam Komitetin Qarkor. Mbas dy javësh na lajmëruan se ai mund të merrej në çetë.

Në fund të shtatorit shkua me Medatin në Ziçisht. Një pjesë e çetës ishte në shtëpinë e Mi-hallaqit. E njoftuam Raqin se me aprovim të Qarkorit «njeriu i fshehur» në Vishocicë, mund të merrej në çetë.

Raqi u gëzua që do të kishte edhe një luftëtar tjetër, por, kur i thamë se do shkonim ta merrnim që atë natë e ta sillnim në Ziçisht, u vrenjt një herë dhe filloi të dridhte mustaqet. Por s'kaluan disa minuta dhe na tha duke buzëqeshur:

— Edhe ju dyshoni, atje mund të bini në ndonjë grackë. Le të vijnë me ju edhe tre partizanë të çetës. Le t'ju ndodhen për çdo të papritur.

Dhe, si me të qeshur, shtoi:

— Ju edhe vetë mund ta bëni punën, por ja që e kam si merak. . .

Mesnatë. U nisëm për Vishocicë. Nga Ziçishti në Poloskë na udhëhiqte Llaqi, nga Poloska, në Kuç e drejt Vishocicës Medati. Rrugën e bëmë shpejt. Lumin e Devollit e kaluam pa vështirësi. Ai nuk kishte ujë shumë, se shirat ende s'kishin filluar. Hy-më në arat e Vishocicës. Duke ecur në një arë me misër, pranë një mezhde, u dëgjua një zhurmë. Medati dha shenjë të ndaleshim. Të gjithë u shtrimë barkaz në pozicion. Zhurma shtoej. Todi i vogël thirri: «Ndal!», por përgjegje s'morëm.

Zhurma shtoej edhe me shumë. Todi na dha urdhër të qëndronim gati në vend, kurse vetë u drejtua andej nga vinte zhurma.

Të gjithë prisnim në hendek. Bëmë gati pushkët dhe revolet. U vumë në gatishmëri luftimi.

Pas pak u dëgjua zëri i Todit:

— Hajde gjederit hajde, ti ha skripckë, ne shtrihemi në hendek. Jazëk të qoftë! — tha, dhe duke u afruar nga ne e ngriti zërin:

— Ejani, o ditëzinj, se s'ka gjë! Një kale s'paska të ngopur...

Të gjithë ja plasën gazit, por disa zëra që u dëgjuan përreth e prenë të qeshurën. Këto ishin zërat e fshatarëve që po zgjoheshin për të filluar punën (ata flinin në fushë).

Vazhduam rrugën. Hymë në fshat. Mbërritëm tek shtëpia e «mikut». I thirrëm atij të dilte jashtë, por ai u frikësua: mendoi se mos kishin ardhur fashistët për ta arrestuar kushëririn e «fshehur».

— Kaq s'paskeni besim — na pyeti «miku», që erdhët pa na lajmëruar?

Medati ja priti:

— Lëri dënglat tani, se s'kemi kohë! Nxirr shpejt atë mikun dhe gjer nesër në drekë mos dil nga shtëpia, as në arë, as në Bilisht mos shko!

Ndërkaq njeriu i fshehur doli vetë tek porta dhe qëndroi prapa saj. Ai e kishte kuptuar që në fillim se ne ishim partizanë. Bisedën tonë e kishte dëgjuar nga dritarja dhe tani kishte dalë i vendosur: «Edhe sikur të mos kenë ardhur për mua, s'do t'u ndahem. Do t'u qepem pas, pa le të më bëjnë ç'të duan», thoshte ai me vete. Ai mbante në sup një maliher grek dhe një gjerdan me fishekë. Edhe në errësirën e natës dukej fytyra e tij e qeshur dhe e gëzuar.

— Me gjak do ta provoj besimin që më dhatë, — na premtoi që në takimin e parë.

U kthyem në Ziçisht. Në blokun e Raqit u shtua edhe një emër tjetër, Selman...

SPASTROHET NJË ARMIK...

Ditët e fundit të shtatorit çeta ishte në Vërlen. Nga Bilishti u njoftua se togeri i milicisë fashiste Loni Trebicka kishte ardhur nga Korça që të shkonte në Hoçisht. Me të marrë njoftimin, një skuadër e vogël partizanësh doli nga Vërlen. Pasi kaloi vreshtat dhe përrrenjtë arriti në fushën e Hoçishtit. Partizanët u vendosën në një shtëpi të vjetër, në atë të Zaharajt, tek pusi, që ndodhet në xhaden Bilisht — Hoçisht. Ndenjën gjer pasdite, kur afër tyre, hipur mbi një kalë, u duk Loni Trebicka.

Në Bilisht kishte pirë e ishte bërë «çakërcejf» dhe rrugës këndonte pa pushim një këngë italiane.

Ecte pa merak! Atij nuk i shkante ndër mend se edhe ditën, se edhe në mes të fushës, mund të lëviznin partizanët. Ai e mblodhi veten vetëm kur nga shtëpia e Zaharajt u dëgjuan të shtëna pushkësh. Partizanët shtinë mbi Lonin dhe e goditën për vdekje. Ai u kërrus mbi kalë dhe ra anash për tokë. Kali i trembur filloi të vraponte nëpër arë. Loni i pagoi me kokën e vet poshtërsitë që kishte bërë në Hoçisht dhe në fshatrat e tjera. Ai u vra me vendim të çetës. Vrasja e tij i bëri të mendohen agjentët e tjerë. Emri i çetës përmendet me mirënjohje nga populli.

Çdo fshatar i Devollit kërkonte t'ja çonin çetën në shtëpi. Ata e kishin për nder e krenari që t'u shkonin partizanët për drekë ose për darkë. Ndonjërit bile i mbetej edhe hatri kur merrte vesh se çeta kishte vajtur në shtëpinë e dikujt dhe nuk kishte vajtur në shtëpinë e tij.

FUAT BABANI — PARTIZAN DHE KOMANDANT

Agjentët e shitur e informonin armikun për çdo aktivitet që kryhej kundër tij. Nëpër fshatrat e Devollit u dendësuan patrullat fashiste.

Më 27 shtator një grup karabinierësh shkoi në Baban, dhe pyeti ku ndodhej Fuati. Shokët e njësitit e lajmëruan Fuatin dhe kur shkuan karabinierët në shtëpi të tij nuk e gjetën.

Duke kaptuar muret njerin pas tjetrit, Fuati doli në rrugën që shkon për në Stropan. U vendos në një bazë, në mëhallën e Mançkallinjve, në të dalë të Babanit.

Që të nesërmen u njoftua Komiteti Qarkor i Korçës. Mbas 5 ditësh erdhi urdhëri që Fuati të kalonte si partizan në çetën «Morava». Ato ditë çeta «Morava» ishte në Bradvicë.

Largimi i Fuatit na rëndoi shumë neve që punonim në terren. Ne e ndjenim në çdo hap mungesën e tij.

Komiteti Qarkor i Partisë për Korçën emëroi komandant çete Fuat Babanin. Në atë kohë çeta «Morava» numëronte 18 partizanë.



Fuat Babani

Të mërkurën e 28 tetorit 1942 shkollat i mbyllëm më shpejt se zakonisht. Të gjithë u grumbulluam në shtëpinë e Izminit në Baban. Atje kishin ardhur edhe shokë të tjerë: Mihallaq Ziqishti, Faik Tackia, Midat Polóska, Raqi Grabocka nga një anë dhe Lefter Lakrori e Xhemil Progëri nga ana tjetër. Nga Eçmeniku me Myzaferin ardhni dhe një shok tjetër, i dërguar nga Komiteti Qarkor i Korçës. Mbasi u njohëm me të deleguarin, filluam mbledhjen.

— Lufta kundër fashizmit, — filloi të fliste Todua, — po zgjerohet. Partia po e udhëheq atë me guxim. Fronti Nacionalçlirimtar është forcuar. Konferenca e Pezës, që u mbledh në shtator, zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm Antifashist të Frontit Nacionalçlirimtar. Organizimi i këshillave nacionalçlirimtare të fshatrave dhe të krahinave është tani detyra kryesore. Ato janë baza e pushtetit tonë popullor, ato duhet ta mobilizojnë të gjithë popullin.

Në këtë situatë duhet të jemi sa më të organizuar. Me vendim të Qarkorit në Devoll formohet celula e partisë. Ju do të jeni anëtarët e saj. Detyra e celulës është të zgjerojë radhët e saj dhe të forcojë lidhjet me popullin.

Në fund të mbledhjes zgjodhëm përgjegjësin e celulës dhe delegatin për në konferencën e partisë të qarkut. Pastaj ndamë detyrat. Secilit nga ne ju caktuan 3-4 fshatra, për të cilat do të përgjigjej para celulës. Detyra jonë ishte që të shtonim numrin e simpatizonjësve të Luftës nacionalçlirimtare, të siguronim baza për strehimin e çetës partizane dhe të demaskonim parullat e armikut.

Vendimet e celulës filluan të zbatoheshin me

shpejtësi. Komunistët e celulës dhe partizanët e çetës i shtuan lidhjet me popullin. Në të gjitha fshatrat u bënë mbledhjet e njësiteve guerrile dhe të këshillave nacionalçlirimtare. Edhe në to u zgjodhën kryetarët dhe komandantët. Bazat e Luftës nacionalçlirimtare në Devoll u shtuan. Në çdo fshat u ngritën njësitet guerrile me nga 7-15 njerëz. Në këshillat nacionalçlirimtare u zgjodhën njerëzit më të mirë. Radhët e tyre po shtoheshin vazhdimisht. Duke pasur një mbështetje të tillë, çeta i zgjeroi veprimet e saj.

Ato ditë edhe «nacionalistët» formuan çetën e tyre, në krye të së cilës ishin bijtë e bejlerëve dhe të agallarëve. Organizata e Ballit Kombëtar filloi të vepronte edhe në Devoll. Celula dhe çeta ju përgjegjën me aksione.

Më 28 Nëntor çeta «Morava» dhe njësitë i Dobranjit goditën postën kufitare në Bozhigrad. Fashistët u dorëzuan dhe u çarmatosën. Po atë ditë partizanët asgjësuan një patrullë fashiste në Bigëll të Dardhës. Më 23 dhjetor çeta «Morava» propozoi një patrullë tjetër të milicisë fashiste në Bredhat e Drenovës. Të nesërmen, fashistët italianë, me një kompani të armatosur gjer në dhëmbë, të etur për hakmarrje, mbërritën në Dardhë, por atje u pritën me pushkë nga të rinjtë e fshatit. Duke luftuar trimërisht, në përpjekje me armikun u vranë Kristo Isaku dhe Lekë Jani Panolli. Ata s'pranuan të dorëzoheshin. Italianët, të egërsuar në kulm, mbasi dogjën shtëpinë e Thomajt, filluan arrestimet. Të rinjtë komunistë Miço Zdruli dhe Miço Tollko i arrestuan dhe i tërhoqën në Korçë, ku i pushkatuan që atë ditë. Por ata s'u përkulën asnjëherë dhe në çastet e fundit të jetës thirrën: «Poshtë fashizmi! Rroftë Partia!»

Çeta dhe celula filluan aksionin e hapjes së depove të dhjetarëve. Armiku desh të tërhiqte nga fshatrat drithërat e grabitura. Që në fillim u hapën në Bozhigrad depot e dhjetarit Shefqet Ismaili. U morën 170 kv. grurë. Dauti për çetën, Emini për Bozhigradin dhe Haretua, Ilua e Perua për Qytezën etj. përgatitën listën e fshatarëve të varfër që do t'u jepej bereqeti. Në Baban, ku çeta ishte e vendosur në shtëpinë e Xha Feimit, u hapën depot e misrit. Edhe ky misër ju nda atyre fshatarëve që kishin shënuar në listë Xha Xhevairi, Fuati dhe Qamoja.

Aksioni i hapjes së depove vazhdoi edhe në janar të vitit 1943. Më 8 janar në mbrëmje çeta hapi 3 depo të tjera me misër: atë të Progrit, që kishte 80 kv. misër, të Cangonjit me 120 kv. misër dhe atë të Bitinckës me 150 kv. misër. Më 12 janar çeta hapi depon e Menkulasit me 195 kv. misër dhe atë të Poloskës me 60 kv. misër. Në këtë aksion morën pjesë shokët e këshillave nacionalçlirimtare dhe të njësiteve guerrile si Loni, Rahimi e Pirroja, për Progrin, Malja, Qaniu, Qemali, Faiku, për Bitinckën Mukja, Sejtaliu, Xha Kasua, Zarifi për Poloskën e shumë të tjerë. Ata sollën me vete edhe fshatarët që do të merrnin bereqetin.

Veprimet e çetës ngjallën panik në armiqtë.

Komanda e karabinierisë italiane në Korçë dha alarmin për hapjen e depove. Me anën e shkresës Nr. 193 ç/2 dt. 22. 11. 1942 (dokument që ndodhet në muzeumin e Korçës) ajo njoftonte mëkëmbësin mbretëror, kryesinë e këshillit të ministrave dhe komandën eprore në Tiranë se:

«Në orën 0.30 të datës 22.m.v. në Sul Bozhigrad u duk një çetë e armatosur prej 100 vetësh. Ajo mori 170 kv. grurë prej magazinës së dhjetarit Shefqet Ismaili. Me të kanë qenë afro 100 persona të tjerë. Mbas dy orësh u larguan në drejtimet Dobranj-Ziçisht.

Hetimet vazhdojnë:

Për gjeneral brigade (Silvio Robini)
koloneli i ngarkuar (Cino Caraj)

Këshu çeta e vogël «Morava», me aksionet e saj të guximshme e bëri armikun të mendonte se i kishte shtuar forcat e veta. Ai kujtonte se çeta për-bëhej prej 100 vetash, kurse ajo nuk kishte më shumë se 30 partizanë.

NË RRUGËN E ÇETËS

Fashistët ndiqnin çdo veprim. Por Partia nuk flinte. Ajo e dinte se gjer ku kishte arritur nuhatja e armikut. Komiteti qarkor i Partisë ishte në dijeni për gjithshka.

— Një pjesë e shokëve të Devollit duhet të kalojnë në çetë, — na njoftoi përfaqësuesi i qarkorit në Korçë më 5 shkurt 1943. Shokët që mbetën në Devoll tani për tani janë mjaft.

Të nesërmen u takova me Hamdinë në Baban. Kur ja tregova vendimin e partisë, Hamdiu menjëherë shprehu gatishmërinë për të ardhur në çetë.

Biseduam që të rrinte edhe ca kohë, por ai nuk bindej. Hymë në shtëpi të tij. U përshëndetëm me Myrvetin të shoqen e Hamdiut dhe me Xha Feimin.

Hamdiu hipi në tavan, prej nga nxori pushkët tona dhe bombat e dorës, Myrveti, po na shikonte. Hamdiut s'ju durua e i tha:

— Ç'm'i çakërit ata sy ashtu, moj grua, nuk e sheh se ne po dalim partizanë?

Myrveti në fillim mbeti pak e habitur, por shpejt e mbloodhi veten e tha:

— Që do të dilnit partizanë, kjo dihej, po nuk kuptoj pse nuk më thatë qysh më përpara, por po ikni si hajdutët.

I thashë Hamdiut të rrinte atë natë në shtëpi, por ai u nxeh dhe më tha:

— Hajde-hajde, po pse ti do të ma hedhësh mua? E ku t'ju gjej unë nesër? Jo, unë do të vij që sonte!

Ishte e kotë ta zgjatje. U përshëndetëm dhe dolëm. Xha Feimi e Xha Seiti na porositën të mos i turpëronim e na uruan rrugë të mbarë. U nisëm për në Hoçisht. Tek korijet provuam pushkët duke shkrehur nga një fishek dhe vazhduam rrugën. Në mbrëmje, kur sapo kish fillur të errej, hymë në Hoçisht. Shkuam tek Sanda ku, simbas lajmërimit që kishim bërë më parë, ishin mbledhur të gjithë shoqët e celulës. Atje zhvilluam mbledhjen e Partisë. Folëm mbi gjendjen që ishte krijuar, analizuam punën tonë të muajit janar dhe caktuam detyrat për shkurtin. Pastaj shqyrtuam informatat që kishim marrë për postën kufitare të Braçanjit. Doli se ato ishin të plota.

Në fund zgjodhëm përgjegjës in e celulës në vend të Myzaferit që do të shkonte në çetë. Kjo detyrë ju ngarkua Raqi Grabockës. Të nesërmen, më 7 shkurt në mëngjez, së bashku me Faikun e me Hamdinë, mbërritëm në Vërlen, ku ishte çeta jonë.

NË PËRPEKJE ME ARMIKUN

Në Vërlen më 8 shkurt, studjuam mënyrën e çarmatosjes së postës kufitare të Braçanjit. Të dhënat e celulës ishin të mjaftueshme. Më 9 shkurt 1943 një togë partizanësh prej 20 vetash u nis për në Braçanj. Rruga ishte e gjatë, bënte ftohtë, por asnjëri nga partizanët s'u lëkund. Pjesëmarrjen në aksion ata e quanin privilegj. Në orën 11 të natës rrethuan postën. Gurtaliu, Hakiu, Qemali e shokë të tjerë të njësiteve Dobranj e Braçanj na prisnin buzë lumit. Ata na udhëhoqën gjer në gardhet e postës kufitare.

Para se të hapnim zjarr u thamë fashistëve italianë që të dorëzoheshin, por ata nuk u bindën. Italianët arritën të shtinin vetëm një herë, sepse ushtarët shqiptarë, që bënë pjesë në efektivin e postës, i detyruan ata të ulnin armët.

6 ushtarë shqiptarë, me në krye Pjetër Prengën, u bashkuan vullnetarisht me çetën. 5 ushtarë italianë u çarmatosën. Një mitraloz i lehtë, 6 pushkë dhe shumë municione ranë në duart e çetës.

Lajmi i çarmatosjes të postës së Braçanjit u përhap qysh të nesërmen me shpejtësi. Populli thoshte fjalët më të mira për çetën.

Më 11 shkurt arritëm në Bitinckë. Qemali, Saliu, Faiku e të tjerë na prisnin me padurim. Qëllimi i çetës ishte të asgjësonte postat kufitare në Tren dhe në Zagredec, por kjo nuk u arrit, sepse fashistët, të frikësuar se mos u ndodhte si në Braçanj, ishin shpërngulur në Korçë. Për këtë na njoftoi me zemër të thyer Raif Treni (Kolami).

Më 19 shkurt bazë e strehimit të çetës «Morava» u bë Pojani.

Pojanakët ishin mësuar të prisnin e të përcill-

nin çeta të ndryshme partizanësh. Seiti, Xhumja, Sabua, e të tjerë na ndanë nëpër baza. Pojanakët u kujdesën shumë për ushqimin e pastrimin e partizanëve. Do të qëndronim

edhe të nesërmen në Pojan, por «miqtë e paftuar» na i prishën planet.

Në orët e para të pasdrekës së 20 shkurtit një kamion me ushtarë, që kontrollonte linjën telefonike, po vinte me shpejtësi drejt Pojanit. Në krye të fshatit ai goditet nga rojet partizane. U dha alarmi dhe ne të gjithë dolëm nga bazat. Afër xhamisë, ku kishin qëndruar fashistët, filloi përpjekja. Disa italianë zunë pozicione mbrojtjeje pas mu-

reve dhe nëpër hendeqe. Partizanët shtinin vazhdimisht. Disa italianë u vranë qysh me plumbat e parë. Italianët që mbetën gjallë nuk deshën të dorëzoeshin. Ata vazhdonin të shtinin. Ndërkohë dy partizanë, Raqi e Selmani, dolën në koshin e minaresë, prej nga lëshuan bombat e dorës mbi fashistët që ishin futur në vijën e ujit. Goditja nga sipër i detyroi fashistët të shpërnguleshin në një vend tjetër. Por kur po lëviznin u ndodhën para zjarrit partizan dhe s'u ndjenë më.

8 italianë, që kishte kamioni i ndërlihdjes fashi-



Raif Treni (Kolami)

ste, mbetën të vrarë. Ndër të vrarët ishin edhe 2 nëntogerë. Çeta mori me vete pushkët e tyre dhe materialet e tjera të vlefshme.

Pojani është në mes të fushës. Rreth tij kalojnë xhadet kryesore Korçë-Bilisht dhe Bilisht-Pogradec, nga ana e Malit të Thatë. Gati një orë larg tij ndodhet Zëmlaku. Atje ishte vendqëndrimi i një grupi artilerie dhe këmbësorie armike. Pojani është vetëm 15 km. larg nga Korça. Në anën tjetër të Pojanit shtrihet Këneta e Maliqit. Mbas aksionit të kryer nuk mund të qëndrohej në fshat

Vendosëm të lëviznim grupe-grupe në drejtim të Malit të Thatë. Kur kapërcyem xhadenë e Zvezdës dhe po ecnim drejt Podgories, një aeroplan zbulimi u duk në qiellin e Pojanit. Pak më vonë një bombardues i rëndë erdhi nga Korça mbi Pojan. Ai lëshoi mbi fshat bombat e tij shkatërruese. Tymi dhe flaka filluan të duken mbi Pojan. Nuk shkoi shumë kohë kur në fshat mbërriti një kolonë kamionash me ushtarë. Ata vinin nga ana e Pendavinjit dhe Zvezdës. Fashistët po vepronin me shpejtësi. Ata kishin llogaritur të izolonin dhe të asgjësonin çetën partizane në mes të fushës, por plani i tyre dështoi. Kjo i xhindosi në kulm. Aeroplani i zbulimit u vu në ndjekje. Ai fluturonte rreth zonës së Pojanit. Më në fund, kur ishte gati më të errur ai e diktoi vargun e partizanëve që ishin në Koritë. Dha shenjën dhe grupi i artilerisë nga Zëmlaku filloi të shtinte drejt çetës. Predhat e topave filluan të pëlcisnin mbi Koritë, por ishte vonë.

Partizanët, duke bërë zikzake të shpejta, u futën në përroin e Koritës. Kur errësira mbuloi dhenë shumë në Podgorie. Partizani i ri Abas Ali Çipani ishte plagosur në gjunjë.

Nga Podgoria çeta kaloi në Çaushti e Zboq dhe me 23 shkurt arriti në Kolanec. Atje u bë mbledhja e celulës. I deleguar ishte Todua. Në mbledhje u shqyrtua gjendja politike dhe ushtarake e çetës dhe u bënë disa ndryshime. Më 26 shkurt u nis nga Vinçani dhe mbërriti në Boboshticë e pastaj në Dardhë. Atje çeta u nda në shtëpitë e Endrit, Vasos, Sofokut etj.

Nga shokët e Dardhës mësuam për terrorin që kishin ushtruar fashistët në Pojan mbas ikjes së çetës.

Kryetari i komunës së Pojanit me 24-II-1943 lidhur me përpjekjen në Pojan, i shkruante prefekturës në Korçë:

«U vranë 2 nëntogerë dhe 6 ushtarë italianë. Forcat italiane bënë raprezalje. U grumbulluan 60-70 fshatarë, mbi të cilët filloi të qitte me mitraloz një autobлиндë. Pati 20 të vranë dhe 8 të plagosur. Vranë gruan e Hysen Tosunit. Italianët dogjën 8 shtëpi, 10 plevica, 4 dyqane e 18 kafshë. Në Zvezdë pushkatuan 3 veta. Dëmet llogariten në 16.000 franga shqiptare. Fshati u bombardua edhe me artileri»

Më 2.III.1943 kryetari i komunës dha edhe një raport tjetër:

«Më 26.II.1943 forcat italiane erdhën përsëri. Arrestuan 19 persona. U dogjën 13 shtëpi. U plaçkitën 3-4 dyqane.»

Të gjitha këto dokumenta, që ndodhen në Muzeumin e Luftës nacionalçlirimtare, vërtetojnë barbarizmat fashiste në Pojan.

NGA SINICA NË POLENË

Me 23 shkurt në shtëpinë e Shefqet Poloskës u bë mbledhja e njësitit gueril, ku merrnin pjesë Ylli, Shefqeti dhe përfaqësues të njësiteve të tjera. Kjo mbledhje u bë për të festuar ditën e Ushtrisë së Kuqe.

Më 28 shkurt në Sinicë bëmë mbledhjen e grupit edukativ të Partisë. Studjuam kapitullin e parë të broshurës së Leninit «Fshatarësisë së varfër». Kjo broshurë ngjalli një interesim shumë të madh. Në të flitej për ndarjen e tokës fshatarëve.

Mbledhjen do ta vazhdonim gjatë, por e ndërpreme, sepse na erdhi një letër nga Komiteti Qarkor, me anën e së cilës kërkohet që të nisej delegati për në konferencën e partisë për qarkun. U vendos që të nisesha menjëherë.

Rruga ishte mbushur me dëborë. Bënte cikmë. Atë natë duhej të flinim në Boboshticë së bashku me Vason dhe të nesërmen të futeshim në Korçë. Para se të ndaheshim, Raqi më tha:

— Hap sytë! Ti nuk ke qenë ilegal në qytet. Ecë me kujdes! Mundohu të shohësh edhe mbrapa me bisht të syrit.

Shkopsiti rrypin, ku varej naganti i tij me dorëzë të bardhë dhe dy bomba me kurris breshke e ma ndeu përpara:

— Ma jep beretën, — më tha. Ti merri këto... janë më të sigurta... ndoshta s'u vjen radha por s'dihet... Atje ka fashistë, spiunë që mund të të qëllojë t'u kalosh përkrah. Po e pe ngushtë, që-llor!»

Fjalët e Raqit më mallëngjyen. Ai mendonte si komunist, si shok, si vëlla... U përqaftuam dhe u

ndamë. Të nesërmen në drekë me korrierin që erdhi nga Korça shkuam për një natë në shtëpinë e Raqi Grabockës dhe ditën tjetër në shtëpinë e Naumit. Na pritën me ngrohtësi. Këto familje dhe shumë si këto ishin mësuar të strehonin ilegalët në qytet Ditën tjetër mbërritëm në Polenë.

Në konferencë kishin ardhur delegatë nga të gjitha celulat e terrenit dhe të çetave. U takuam me shokë të njohur dhe të panjohur. Në mbrëmje filloi konferenca. Atje u sqarua gjendja e jashtme dhe e brendshme, u tha se punët në frontin e lindjes shkonin shumë mirë, se armatat e Stalinit po asgjësonin divizione fashiste njërin mbas tjerit, se fitorja më e madhe ishte arritur në fillim të shkurtit në Stalingrad, ku ishin vrarë e ishin zënë rob mbi 300.000 gjermanë, se grushtet e Ushtrisë së Kuqe po ndihmonin të gjithë popujt në luftë kundër fashizmit. Atje u tha se në Ballkan dhe në Evropë po zgjerohet lufta partizane, se në vendin tonë sukseset ishin të mëdha, se vija që ndiqte Partia në Luftën nacionalçlirimtare kishte gjetur mbështetje në popull, se çetat ishin hedhur në sulm. Në Gjorm, në Voskopojë, në Selenicë dhe në shumë vende të tjera, partizanët kishin asgjësuar garnizonet e armikut. Njësitet e armatosura nëpër qytete vazhdonin pa ndërprerje luftën kundër armiqve e tradhëtarëve.

Pastaj u fol për çështjet organizative të partisë dhe për detyrat politike. Në fund u zgjodh komiteti qarkor për Korgën.

TRE DËSHMORET E PARË

Mbas konferencës me Gaçon u larguam nga Polena. Më 5 mars pasdreke u nisëm për Dardhë. Në Boboshticë qëndruam për darkë tek Kiçua. Ai deshte të na mbante edhe më, por ne nuk ndenjëm, sepse, sipas urdhërit që kishim marrë, duhej të paraqiteshim menjëherë në çetë për të njoftuar mbi punimet dhe vendimet e konferencës. Ishte natë. Bënte ftohtë. Era e Moravës fishkëllente. Ecnim nëpër borën e ngrirë. Hëna, që ndriste lart në qiell, na ndihmonte të mos humbisnim rrugën. E përpjeta e Bigllës na lodhi, na dërsiu. Në mesnatë arritëm në Dardhë. E ëma e Gaços, teto Thomaidha dëgjoi trokitjen e parë dhe u ngrit menjëherë. Hymë brenda. Pasi u ngrohëm mirë e mirë tek zjarri, hëngrëm bukë dhe ramë të flëmë.

Të nesërmen në mëngjez bëmë mbledhjen e aktivitetit të rinisë. Të rinjtë e të rejat e Dardhës i pritën me entuziazëm vendimet e konferencës së partisë. Mbasdreke u nisëm për në Grapsht, ku na thanë se ndodhej çeta jonë. Kur ra muzgu i mbrëmjes hymë në fshat. Shkuam në shtëpinë e At Vasilit, ku ishte edhe Raqi me dy partizanë. Pasi u përshëndetëm e u përfaquam me njëri-tjetrin, Raqi tha:

— Këtu në Grapsht jemi 19 partizanë. Fuati me shokët e tjerë ndodhet në Hoçisht. U ndamë para 3 ditëve që ta kemi më lehtë për të lëvizur nëpër fshatra. Ne tani jemi shumë, s'kemi si i biem më qafë vetëm një fshati, të reja s'ka. Tani ngjeshuni mirë, hani, e shpejt na tregoni për andej!

Raqit nuk i durohej. Ai desh t'i mësonte sa më parë detyrat e reja që kishte caktuar Partia. Kur po ja shpjegoja me hollësi punimet e konferen-

cës, sytë e tij të zinj shkëlqenin nga gëzimi. Ai buzëqeshte dhe shpesh dridhte mustaqet. Biseduam gjer vonë. Më në fund u shtrimë të flëmë. I thamë njëri-tjetrit natën e mirë... Por gjumi s'na zuri menjëherë dhe, siç ishim shtrirë, biseduam edhe për një kohë.

Të nesërmen, në mëngjezin e 7 marsit, u ngritëm me alarmin e rojeve partizane. Ato na lajmëruan se në drejtim të Hoçishtit kishin dëgjuar zbrazje pushkësh. Dolëm shpejt... Kaluam në vendin e rojeve. Në atë kohë asgjë nuk ndihej. Qielli i Grapshtit ishte bërë pus. Nga errësira e madhe s'mund të dalloje as përroin e madh që ishte nën fshat dhe as kodrat e mëdha karshi tij. Mbas pak hymë në shkollë. Atje u mblodhën edhe mjaft fshatarë.

— Zhurma e zbrazjeve m'u duk sikur vinte nga Vërleni, — tha njëri nga fshatarët.

— Mua m'u duk sikur vinte nga Cangonji, — tha një tjetër.

Komentet ishin të ndryshme. Ndërkohe në shkollë u grumbulluan të gjithë partizanët që ishin në Grapsht. Raqi tha me zë të lartë:

— Bëhuni gati, shokë! Do të nisemi për rrugë, ndoshta për luftë. Asgjë s'dihet me saktësi, por njoftimet e rojeve na bëjnë të dyshojmë. Ne dimë se pjesa tjetër e çetës ndodhet në Hoçisht, por ajo mund të ketë lëvizur, mund të jetë përpjekur gjëkundi. Megjithëse shokët e dinë drejtimin tonë, gjer tani nuk kemi marrë ndonjë lajm.

Në orën 10.30 u ndamë me fshatarët dhe u nisëm për rrugë. Sa dolëm nga fshati dhe po zbrisnim drejt përroit, një grup partizanësh mbërritën në fshat. Ata vinin nga Hoçishti. U kthyem.

Partizanët na thanë se në mëngjezin e asaj dite

grupi partizan që ndodhej në Hoçisht ishte përpjekur me fashistët italianë. Në përpjekje dhanë jetën 3 shokë, 3 anëtarë të Partisë Komuniste Shqiptare, 3 bij të denjë të popullit tonë, komandanti i çetës «Morava», Fuat Babani, komisari i nozullimeve të çetës, Demir Muharem Progridhe përgjegjësi i rinisë komuniste të Devollit Avdulla Progrid (Hoxha).

Ja si ndodhi:

Forcat fashiste morën informata të sakta se në Hoçisht kishte partizanë. Në mëgjezin e 7 marsit ata u nisën nga Bilishti me 600-700 veta. Në të afëruar të Hoçishtit u ndanë në 3 kolona. Një kolonë mori rrugën nga ana e Vërlenit, një kolonë tjetër nga ana e Gracës dhe kolona qendrore nga xhadja e fshatit. Plani i tyre ishte të zinin Shëndëllinë dhe Satrivaçin. Afër mëngjezit plotësuan rrethimin e largët. Ata ecnin nëpër arat e mbuluara me dëborë të udhëhequr nga tradhëtarët vendas.

Mbas rrethimit, kur ende s'kishte aguar, kolona qendrore lëvizte drejt fshatit. Roja partizane shtiu mbi të. Në fshat u dha alarmi dhe partizanët po dilnin në drejtimin e paracaktuar drejt Moravës. Shokët e bazave të fundit të fshatit duhej të bënin rrugën më të gjatë gjer në krye të fshatit. Një rrugë të tillë kishin për të bërë edhe Fuati, Demka e Avdullai. Që të tre dolën menjëherë dhe, ashtu si shokët e tjerë, u tërhoqën përpjetë. Fashistët, që kishin zënë Shëndëllinë, i qëlluan. Partizanët hapën zjarr mbi armikun, për t'i ndihmuar shokët. Fuati, Avdullai e Demka duke qëlluar mbi armikun vazhdonin rrugën përpjetë. Por duke mos pasur vendmbrojtje goditen për vdekje nga plumbat e armikut.

Këta ishin tre dëshmorët e parë partizanë në

Devoll, 3 komunistët e parë të çetës, që me gjakun e tyre lanë kodrat e Hoçishtit.

Humbja ishte e rëndë! Hidhërimi i të gjithëve ishte i madh.

«Shoku Fuat Babani, re në krye të çetës që komandoje...!» Kështu shkruante Komiteti Qarkor i Korçës në komunikatën që nxori pas vrasjes së 3 shokëve. Fuati kishte mbushur vetëm 25 vjet të jetës së vet. Vitet e para i kaloi në fshat, në Baban, ku mbaroi 4 klasë të shkollës fillore. Familja, që ishte në gjendje të mirë ekonomike, e dërgoi në Korçë. Atje Fuati mbaroi klasën e 5-të të fillores dhe vazhdoi studimet në Liceun Kombëtar.

Filloi për Fuatin jeta e studentit, që aq shumë e dëshironte. Ndërmjet studentëve ai shquhej për zellin në mësim dhe për moralin e lartë. Duke qenë i tillë, ai merrte pjesë vazhdimisht në revoltat e studentëve kundër akteve të padrejta zogiste.

Më 1939, kur Italia fashiste pushtoi Shqipërinë, Fuati u ndodh në radhët e para të studentëve vullnetarë që kërkonin të luftonin kundër pushtuesve. Kur fashizmi hyri në Korçë, mbasi kërkuan armë e nuk u dhanë, Fuati me disa të rinj të tjerë u hodh në Greqi, por s'kaluan shumë kohë dhe u kthye përsëri në Shqipëri.

Si mbaroi shkollën e mesme, shkoi në Itali, për të vazhduar universitetin. U regjistrua në fakultetin e inxhinierisë. Prirjet për t'u bërë një inxhinier i mirë ai i kishte shfaqur qysh në shkollën e mesme. Por në mes të vitit shkollor (më 1941) ai braktis studimet dhe kthehet në atdhe. Me themelimin e Partisë Komuniste Shqiptare Fuati bëhet anëtar i saj.

Si anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare futet

në popull dhe fillon punën jo vetëm në fshatin e lindjes por në të gjithë Devollin. Puna e tij nuk ishte e lehtë. Ai duhej të luftonte kundër armikut si dhe kundër shumë njerëzve të farefisit të tij, disa prej të cilëve ishin me fashizmin. Megjithëse e pati të vështirë të luftonte kundër rrethit familjar, Fuati asnjëherë nuk ju nënshtrua presionit të klasës, nga e cila rridhte.

Ai lëvizte nga një fshat në tjetrin dhe krijonte lidhje të shumta për zgjerimin e luftës. Kjo bëri që armiku ta ndiqte këmba këmbës. Më në fund la fshatin dhe hyri në çetën «Morava», ku fitoi dashurinë dhe simpatinë e të gjithë partizanëve. Aty Fuati caktohet komandant i çetës, të cilën e udhëheq gjer më 7 mars.

Bashkë me Fuatin ra dëshmor edhe Avdullai. Ai ishte më i ri, sa kishte mbushur 22 vjeç. Kish lindur në Progër. Mbasi mbaroi filloren në fshatin e vet, familja e dërgoi në Elbasan për të vazhduar

studimet në shkollën e mesme. Avdullai me sjelljen, zgjuarsinë dhe kujdesin që tregonte për shokët fitoi dashurinë e tyre. Pushtimi i vendit nga fashistët bëri që Avdullai të linte shkollën, kur ishte në vitin e fun-



Avdulla Progri (Hoxha)

dit, dhe të bashkohej me të rinjtë antifashistë. Në fund të vitit 1942 ai qëndroi në fshat, për të luftuar kundër armikut. U fut në radhët e Rinisë Komuniste Shqiptare. Duke qenë i vendosur për të luftuar deri në fund armikun, ai nuk kursehej në punë, nuk trembej nga asnjë aksion. Për këto cilësi, në janar të vitit 1943, celula e Devollit e pranoi në radhët e Partisë Komuniste Shqiptare. Nga Celula ngarkohet të punojë me rininë e Devollit. Punon dhe nuk lodhet. Por armiku e zbulon dhe e ndjek. Më 6 mars largohet nga fshati dhe drejtohet për në Hoçisht, ku ai e di se ndodhet çeta. Së bashku me Fuatin dhe Demkën shkon në një shtëpi për të kaluar natën. Të nesërmen, vritet nga plumbat e armikut.

Demka ishte pak më i madh se Avdullai, 23 vjeç, bir i një familjeje të varfër fshatare. Demka që në moshën më të njomë duhej të mbante në kurriz barrën e familjes. Për të përballuar nevojat e familjes ai hyn në punë në tregëtarë të ndryshëm në Korçë. Shkollën qytetëse, që e filloi në Korçë, nuk e mbaroi plotësisht. Në kohën e pushtimit fashist Demka mori pjesë në rrethet e rinisë komuniste korçare dhe punoi ilegalisht për përmbysjen e fashizmit. U diktua nga armiku dhe ishte në rrezik të kapej. Me urdhër të Qarkorit kaloi partizan në çetën «Morava». Pastaj, me rekomandim të Qarkorit, hyri në celulën e çetës. I shkathët, i dashur, i sjellshëm dhe i palodhur, ai fitoi menjëherë simpatinë e partizanëve.

Si komisar i nozullimeve të çetës ai përpiqej të plotësonte nevojat e saj me çorape, fanella etj.

Kështu të tre shokët që e kaluan bashkë natën,

edhe dëshmorë bashkë ranë. Vetëm hakmarrja mund të zbuste zemrat e popullit dhe të partizanëve.

LARG DEVOLLIT

Dëbora shtohet çdo ditë. Tokë e zezë nuk duhet gjëkund. Kanalet e thella dhe të ngushta midis muveve të dëborës ishin rrugët e qarkullimit të çetës dhe të popullit. Lëvizja ishte e vështirë, por çeta duhet të qarkullonte. Ajo nuk duhet të bëhet objekt i palëvizshëm për armikun. Humbja e shokëve në Ho-

çisht dhe barbarizmat e armikut ndjeheshin rëndë, por nuk duhet të ulnin shpirtin luftarak të partizanëve dhe të popullit, ato duhet ta forconin vigjilencën e tyre. Më 10 mars bëme mbledhjen e celulës në shtëpinë e Mistos në Bradvicë. Gjendja u shqyrtua me hollësi dhe u tha se armiku s'është nënvleftësuar, se çeta nuk duhet të qëndronte për shtumë ditë në një fshat dhe se duhet të mbaheshin parasysh të dhënat e popullit mbi lëvizjet e armikut. Për gjithshka u informua Komiteti Qarkor. Në letrën përgjegjeje që na i dërgoi ai menjëherë, thuhej se çeta duhet të nisesh për në zonën e Kolonjës, se duhet të evitohet



Demir Progri

qdo e papritur. Në atë letër të firmosur nga Petro Papi (Vreshti) na tërhiqej vëmendja për humbjen në Hoçisht dhe porositeshim të ishim vigjilentë.

Më 4 mars, që në mëngjes, u nisëm nga Dardha për në Kolonjë. Dëbora ishte e madhe. Rruga nuk dallohej fare. Nga Shenpjetri gjer në Nikolicë atë ditë nuk kishte shkelur këmbë njeriu. Por më keq dhe më vështirë ishte të kaloje Gramozin. E përpjeta e tij na mori frymën. Trashësia e dëborës vende-vende i kalonte 2-3 metrat. Shpesh, herë njëri, herë tjetri, fundoseshim në dëborë. E atëhere të qeshurat s'mbaronin, por edhe ndihma e menjëhershme nuk mungonte.

Mbas 10 orësh udhëtimi arritëm në fshatin Kozel. Para se të hynim në fshat bëmë një mbledhje të shkurtër me partizanët, të cilëve u folëm për punën armiqësore të Safet Butkës dhe për kujdesin që duhej patur se mos ndesheshim me ndonjë nga bashibozukët e tij, të cilët edhe mund të na provokonin.

Lamë në Kozel 30 partizanë dhe u nisëm për Shtikë, ku kishte qenë dhe çeta partizane e Kolonjës. Në Shtikë gjetëm edhe një çetë «ushtarake» të Ballit me Safet Butkën. Në bazat u futëm me ndërhyrjen e Postolit. Atje takuam edhe Muharem Butkën. Ai ishte i sëmurë.

Nga Shtika e Kozeli shkuam në Vodicë. Atje na pritën krahëhapur. Në Vodicë kishte punuar edhe Josif Pashkoja.

Nga Vodica, me lajmërim të Josifit, së bashku me Raqin, u nisëm për Luaras, ku takuam Josifin, Beharin, Petritin e të tjerë.

Nga Luarasi u nisëm për në Qytezë e Selenicë të Pishës. Në Qesarak, më 17 mars, u bë mbledhja

e komandantëve dhe e komisarëve të çetave. Mestani kërkonte të tregonte autoritet dhe supremaci, ai deshte t'i transferonte komandantët dhe komisarët siç ja desh qejfi, pa pyetur Komitetin Qarkor të Partisë, por s'i eci.

Josifi me shokë nuk i aprovuan propozimet e tij dhe Mestanit i ra hunda.

Pasi kaluam Qinamin, Radovickën, Piskalin e Zavalanin, më 20 mars në mbrëmje, u vendosëm në Barmash. Të nesërmen në mëngjez, një spiun nga fshati shkoi në Ersekë dhe njoftoi se çeta ishte në fshat. Mbasdite, një kaçiator italian vërtitej mbi shtëpitë e fshatit. Ai hodhi një numër bombash të kalibrit të vogël.

Dolëm nga Barmashi dhe u drejtuam për në Novoselë. Raqi me një pjesë të çetës u nis për në Borovë. Në Gostivisht u ndamë me Petritin, i cili bashkë me çetën e Kolonjës u nis për në Skrapar. Në Borovë u takuam me Riza Kodhelin e Foni Thanon. Megjithëse fshatarët e Kolonjës nuk ishin të pasur, ndanë me ne edhe kafshoren e gojës.

Më në fund ikëm nga Kolonja e shkuam drejt Voskopojës e Rëzës së Korçës. Kaluam Gjonomadhin e u drejtuam për në Polenë, Vockop e së fundi në Vinçan, ku më 13 prill u takuam me Teki Kolanecin. Me çetën e Gorës u nisëm për në Kolanec. Më 14 prill në Kolanec bëmë mbledhjen e celulës. Todua ishte i deleguar i Komitetit Qarkor. Në mbledhje vendosëm:

a) Të bëhej riorganizimi i çetës. Efektivi i saj arrinte në 100 veta. Çeta të ndahej në dy kompani, dhe secila të kishte komandantin e komisarin e vet. Komisarë të kompanive u caktuan Raqi dhe Faiku, ndërsa komandantë Batua dhe Miti. Ilua me Thimin

u caktuan si komisarë nozullimesh, kurse Myzaferi komisar i çetës.

b) Një pjesë e çetës (25 partizanë) të nisej në Devoll. Në krye të tyre të ishte Raqi. Detyra e këtij grupi ishte të spastronte spiunët si Igumenin e Shëndëllisë të Hoçishtit, Demir Poloskën etj. Celula studjoi të dhënat që kishte mbledhur për këta elementë, të cilët bashkëpunonin me armikun. Igumeni dhe Thimi, ishin provokatorët e humbjes së shokëve në Hoçisht. Ky grup duhej gjithashtu të zhvillonte një punë sa më të gjerë politike dhe të pregatishte terrenin për hyrjen e të gjithë çetës në Devoll.

c) Pjesa tjetër e çetës të nisej në zonën e Mallit të Thatë, të demaskonte veprimtarinë armiqësore të bandave balliste dhe të riorganizonte këshillat nacionalçlirimtare.

Të nesërmen, më 15 prill, në luadhet e Kolanecit u bë mbledhja e çetës. I deleguari i Qarkorit na komunikoi vendimet e celulës. Të gjithë ishin të gëzuar. Kënga oshëtiu menjëherë!

DY DËSHMORE TË RINJ

Mbas mbledhjes së çetës u kthyem në Kolanec. Atje erdhi dhe Medati nga Devolli, i cili na foli për vrasjen barbare të Raqi Grabockës dhe Shyqri Vishocicës:

— Me 25 mars, — tha ai, — Lefter Lakrori dhe Syrja Çakçiri shkuan në Vishocicë. Atje u takuan me Raqin dhe shqyrtuan situatën e krijuar mbas largimit të çetës si dhe caktuan detyrat e tyre. Para së gjithash ata duhej të mblidhnin grupet edukative dhe njësitet guerrile dhe t'i gjallëronin e t'i aktivizonin sa më shumë. Pasi i rrahën bashkarisht problemet, u ndanë.

Lefteri iku në Progër, kurse Syrjai në Poloskë. Në Poloskë, pranë shtëpisë së tij, Syrjai diktoi një patrullë karabinierësh. U detyrua të ndërronte menjëherë drejtim, të kalonte nëpër vreshta dhe të futej në lumë. Pastaj u drejtua për në Progër. Ndërkohë në Vishocicë u dëgjuan zbrazje pushkësh. Pak më vonë njësitë e Vishocicës njoftoi se një skuadër fashiste kishte mbërritur në fshat porsa ishin larguar Lefteri me Syrjanë dhe kishte rrethuar menjëherë shkollën. Sekretari i celulës, Raqi Grabocka, ishte duke dhënë mësim. Karabinierët hynë në klasë, e kapën, e hoqën zvarrë përjashta dhe e godisnin, e shtynin, e përplasnin.

Pastaj e pyetën për veprimtarinë e tij komuniste, por ai nuk hapi gojë. Ndërkohë një patrullë



Syrja Çakçiri

tjetër fashiste solli para shkollës një anëtar të njësitit guerril të fshatit. Ai ishte shoku i Raqit, Shyqyri Vishocica. I vendosën të dy në mes të sheshit, para shkollës dhe i pyesnin, i kërcënonin, i godisnin... por nga goja e tyre nuk doli asnjë fjalë. Fashistët nuk duruan gjatë dhe mbi trupat e tyre lëshuan një breshëri plumbash. Kështu të dy shokët ranë të vrarë nga plumbat e armikut. Mbas këtij krimi, bishat e Musolinit u larguan nga fshati.

Armiku po përdor terrorin, ai ka futur edhe spiunë. Ne duhet të hakmerremi.

Me këto fjalë e përfundoi Midati tregimin mbi humbjen e shokëve në Vishocicë.

Lajmi për vrasjen e Raqit dhe Shyqyriut na hidhëroi të gjithëve.

NJË «MESTAN» NË MAL TË THATË

Nga Kolaneci, në Rëmbec e Bulgarec, më 18 prill, 80 partizanë, të çetës «Morava» hymë në zonën e Podgorijes-Alarup-Bllacë-Bratomirë...

Në Bulgarec takuam Ziqiriun. Edhe ai ishte larguar nga Hoçishti, ku ishte mësues. Djegjet, torturat dhe vrasjet e armikut në Pojan e Hoçisht përmendeshin më shpesh në Podgorije. Ato ishin shfrytëzuar prej armikut për të futur frikën në popull. Aty punonte kundër Luftës nacionalçlirimtare komandanti ballist Dule Alarupi. Ai kërkonte të hiqej si «zot» i krahinës. Me forcë dhe gënjeshtër kishte organizuar një «besëlidhje» të 15 fshatrave, për të mos pranuar partizanë nëpër shtëpi. Por ne shkuam, dhe populli na priti. Ne e thirrëm atë në mbledhje dhe ai nuk mungoi. Kundër urdhërave të Dules, fshatarët siguruan për partizanët strehimin dhe ushqimin.

Dule Alarupi me bashibozukët e tij, tërbohët për këtë dhe kërkon takim me shtabin tonë. Takohemi.

— Simbas marrëveshjes me Rahman Zvarishtin — thotë ai — kjo zonë i është lënë vetëm atij dhe nuk duhet të vijë partizanët. Kjo është një zonë asnjansë dhe nuk «dua» të përzihet as me partizanët e as me ballistët. — Dulja fliste sikur ajo zonë të ishte çifliku i tij personal!

Bëmë mbledhjen e «parive» të fshatrave që kishte sjellë Dulja dhe para tyre demaskuam qëllimin reaksionar të «besëlidhjes». Në shkollën e Podgories bëmë mbledhjen e gjithë popullit. Fshatarët e rrëzuan këshillin e vjetër nacionalçlirimtar dhe zgjodhën këshillin e ri me elementët më të vendosur. Ata që kishin bashkëpunuar me Dulen nuk u zgjodhën në këshillin e ri.

Në Bllacë, na erdhi nga Pogradeci Isuf Kamba. Ai na sqaroi më mirë mbi pelivanllëqet e Dules dhe dallaverat e Rahmanit.

Nga zona e Podgories, më 21 prill, kaluam në Kakaç-Gribec, e me 24 prill qëndruam në Osnat për t'u takuar edhe me çetën që komandohej nga Teki Kolaneci. Aty kishin ardhur edhe Rahmani dhe Dule Alarupi. U mblodhëm bashkarisht. Biseduam, ose më mirë bëmë shamatë: Rahmani, me qëndrim oportunist, anonte nga Dulja. Ai e quante si të drejtë pretendimin e Dules, për të mos hyrë në zonën e «tij». Ne nuk qemë dakord, dhe nga kjo, mbasi nuk i eci fjala, ai doli me inat nga mbledhja dhe iku nga Osnati së bashku me Dulen. Dulja desh të komandonte një lloj si Mestani në Kolonjë. Nga Osnati më 24 prill arritëm në Meçan — Desmirë, ku erdhën Nesti Titani dhe Todo Manço.

Todos i bëmë raportin përkatës.

Nga Mançoni në Plovisht — Gjyras — Lavdar — Shipckë — Dajmanec — Vinçan — Goskovë, më 30 prill çeta arriti në Vockop. Në atë mbrëmje simbas urdhërit të Komitetit Qarkor, së bashku me njësitet e fshatrave, mblodhëm telin e linjave telefonike dhe po atë natë e dorëzuan në Voskopojë.

Me mbledhje, konferenca, shpërndarjen e të dhjetave dhe organizimin e këshillave nacionalçlirimtare e kaloi çeta muajin prill 1943 në Rrëzë e Gore, duke lëvizur herë e veçuar dhe herë e bashkuar me çetat e tjera partizane.

Ndërkohë grupi i partizanëve që shkuan me Raqin në Devoll, hidhet në veprim. Populli gëzohet kur sheh partizanët e tij. Raqi bën mbledhje të shumta nëpër fshatra. Një pjesë e këshillave nacionalçlirimtare riorganizohen. Parullat e Ballit Kombëtar demaskohen. Agjentët e armikut, si Demir Poloska dhe Igumeni i Hoçishtit asgjësohen. Ata e paguajnë me kokën e tyre tradhëtinë kundër popullit.

SULMI MBI LESKOVIK

Në ditët e para të majit të vitit 1943 Voskopoja, e djegur nga fashistët, me fshatrat e saj rreth e rrotull bëhet qendër e madhe e lëvizjes partizane. Ditën e 1 Majit ishim në Shipckë. Prej andej u nisën për në familjet e tyre në Devoll, Hakiu, Kasua, Resuli dhe Shefqeti. Në Shipckë me Medatin bëmë një mbledhje me fshatarët. Më 4 maj ishim në Porodinë, ku u takuam me Nevzatin e Ziqëriun, më 5 maj në Goskovë, ku erdhi dhe Ibrahimimi dhe me 6 maj në Klocë, ku, së bashku me Spiro Shalësin, bëmë mbledhjen e Këshillit nacionalçlirimtar dhe të njësitit. Më 9 maj, në lëndinat e Voskopojës, Ko-

miteti Qarkor i Rinisë së Korçës organizoi një miting të gjerë të rinisë antifashiste. Nga fshatrat e nga qyteti i Korçës erdhën mbi 300 të rinj e të reja. Kënga dhe vallja nuk pushonin. Nën diellin e ngrohtë të pranverës mitingu vazhdoi 3 orë. Në miting e morën fjalën shumë partizanë dhe ilegalë nga qyteti. Atje u fol mbi fitoret e Ushtrisë së Kuqe, mbi fitoret e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare e të tjera. Të gjithë folën me urrejtje për terrorin e zi fashist. Ata që dëgjonin mezi përmbaheshin.

Regjistrimi i vullnetarëve filloi. Lista arriti në 200 veta dhe u ndërpre. Vetëm 80 veta u pranuan në radhët e partizanëve qysh atë ditë.

— Të tjerët do t'i lajmërojnë më vonë, — tha ai që drejtonte mitingun.

Vullnetarët e rinj formuan një kompani. Shumë prej tyre deshën të vinin në çetën tonë «Morava», por nuk u lanë të shpërndareshin.

Për drekë i mbajtëm në Shënprodhom. Prej andej i përcollëm në barakat e Zvarishtit dhe ja dorëzuam Nuriut.

Mbas ikjes së vullnetarëve të rinj, manastiri i Shënprodhomit u bë baza e qëndrimit dhe e furnizimit të çetës sonë, të Çetës së Kolonjës, të Rrëzës, të Gores e të çetave të tjera që erdhën atje njëra pas tjetrës.

Me vendim të Qarkorit të Partisë, të gjitha çetat, nën drejtimin e një shtabi të vetëm, më 12 maj filluan lëvizjen drejt Leskovikut. Në mëngjezin e 15 majit, në pyjet e Gërmenjit, u bë mbledhja e të gjitha çetave. Komandat u përziën. Partizanët u ndanë në skuadra sulmonjëse. Çeta «Morava» doli e gjitha vullnetare. Një pjesë shkuan me skuadrën sulmonjëse që komandonte Tekiu. Në orën 3 të

mëngjezit të 18 majit, Leskoviku u rrethua plotësisht.

Goditja filloi më parë me grupin e Petrit Dumes. Siç dukej italianët e prisnin një gjë të tillë, sepse u përgjegjën menjëherë me zjarr. Ndonëse të rrethuar, italianët nuk dorëzoheshin. Ata ndihmoheshin edhe prej aeroplanëve. Ata bënë më tepër se 40 fluturime, duke bombarduar dhe mitraluar forcat tona. Prej bombardimit të tyre u ndezën 2-3 shtëpi. Shpërngulja e armikut nga strofka e tij nuk qe e mundur.

Më në fund në mbrëmje, me urdhër të shtabit të veprimeve, u tërhoqëm në drejtim të Vrepckës. Gjatë këtij luftimi, u vranë 3 partizanë, ndërmjet të cilëve dhe një partizan i çetës «Morava», Enver Dajlani nga Hocishti. Ky, duke qenë në krye të skuadrave sulmonjëse, u vra që në sulmin e parë mbi armikun. Në mëngjez të 17 majit dolëm prej Vrepcke dhe qëndruam për të ngrënë në pyllin sipër Podës. Ndërsa çetat ishin shpërndarë, në orën 5 pasdreke, në grykat e Shalësit u dëgjuan të shtëna. Petriti u ndesh me autokolonën armike. Çetën e arritëm në Sanjollas. Erdhi Tekiu dhe bashkë marrim xhaden.

Italianët kishin edhe mortaja, por partizanët nuk trembeshin. Në orën 7 të mbrëmjes një autobлиндë, si çau pritë partizane vazhdonte rrugën drejt Korçës. Ndërkohë në qiellin e errët fluturonte një bombardues i ardhur nga Korça. Mbas autobлиндës ecte një maqinë. Ajo kaloi diçka pritë, por kur ju afrua pritës ku ishte Tekiu, një karabinier ra i vranë. Atë e goditi plumbi i Tekiut.

Në pritën mbi Sanjollas, autokolona u ndalua nga zjarri partizan dhe ushtarët zbritën nga maqinat.

Vaskë Nuni, një partizan i çetës «Morava», bërtiti me zë të fortë: «Përpara, shokë, këmbë prej tyre mos lëmë të gjallë!» dhe u hodh në mez të ushtarëve italianë. U kapën 29 robër, midis të cilëve edhe një nënkolonel.

Errësira ishte e madhe. Në orën 11 të natës Medati njoftoi:

— Italianët po godasin nga prapa. Duket se kanë çarë ndonjë vend besoj nga Shalësi.

Kur dolëm me Tekinë në xhade dëgjuam zhurmën e një autokolone që qëndronte në grykat e Barmashit. Ndërkohë Shtabi i veprimeve dha urdhër për largimin e forcave nga xhadeja. Një pjesë e forcave u tërhoq për në Rajan, kurse pjesa tjetër në pyllin e Rajanit (atje na zuri edhe mëngjezi).

Më 21 maj çetat u grumbulluan në pyjet e Vithkuqit. Shtabi i veprimeve i falënderoi partizanët për trimërinë që treguan në luftën e Leskovikut, ku armiku pati rreth 200 të vrarë, shumë të plagosur dhe 30 robër. Nga Barmashi në Leskovik partizanët dogjën 25 kamiona të armikut dhe 2 autoblanda.

Në mbrëmje çetat do të merrnin drejtime të ndryshme, por nga Erseka ardhni lajmi se armiku do të niste një operacion nëpër fshatrat. U vendos që të riktheheshim për kundërgoditje.

U nisëm me 23 maj. Çetës «Morava» bashkë me çetën e Tekiut ju caktua zona e Lubonjës. Mbas një udhëtimi jo shumë të gjatë, u kthyem përsëri në Vithkuq. Ushtria armike ishte larguar nga Kolonja. Në mbrëmje çetat ndahen në drejtime të ndryshme.

Për arësye ekonomike dhe për arësye se çeta jonë nuk e njihte vendin, u ndamë në tri grupe:

- 1) 29 veta me Medatin do të qarkullonin me çetën e

Aliut; 2) 10 veta në Devoll me Mitin e Baton; 3) 18 veta me Tekiun.

Mbas mesnate u nisëm për në Gjanç. Rrugën nuk e ndjemë, mbasi Faikoj na e kishte siguruar ushqimin e nevojshëm.

Mbas 5 ditësh, si kaluam Gjançin, Polenën e Voskopojën, u drejtuam për në Devoll. Me ne erdhi edhe Faiku. Me 27 maj u nisën për në Devoll edhe Midati, Gjezi, Petrika. Më 28 maj e gjithë çeta arriti në borigat e Boboshticës e prej atje vazhdoi rrugën për në Bradvicë. Jovani, Koçi, Mihali dhe i gjithë fshati dolën përjashta. Gëzimi i tyre qe i madh. Këngët buçitën nërpër rrugë. Partizanët u shpërndanë në të gjithë fshatin. Atë natë asnjëri nga fshatarët nuk donte të mbetej pa partizanë në shtëpi.

ÇETA E BASHKUAR

Të nesërmen shkuaam në Vërle. Çeçua, Sotiri, Pandi, Ramadani, e të tjerë kishin dalë jashtë fshatit për të pritur çetën. Në mbrëmje erdhi në Vërle edhe Raqi me partizanët që kishin ikur në Devoll që më përpara. Të gjithë u përqaftuam me mall.

Nuk kishim më shumë se një muaj e gjysmë që ishim ndarë... por na dukej sikur kishim një kohë të gjatë që s'ishim parë.

Raqi na informoi se Balli Kombëtar po përcante popullin. Vendosëm që celula jonë të mblidhej në Bradvicë për shqyrtimin e gjendjes.

Para se të mblidhej celula, vendosëm që çeta të lëvizte për 2-3 ditë në Gracë-Hoçisht e në fshatra të tjera.

Më 3 qershor çeta u vendos në Gjyras e Bradvicë.

Në Bradvicë u bë mbledhja e celulës. Ne, që kishim qenë në Rrëzë dhe në Leskovik, raportuam për punën e andejshme. Raqi e të tjerët, që kishin qenë në Devoll, raportuan për zbatimin e detyrave që u kishte ngarkuar celula me 14 prill në Kolanec.

Mbledhja analizoi gjithë punën dhe bëri kritikë dhe autokritikë të shëndoshë. Mbas analizës u cak-tuan detyrat.

Anëtarët e celulës vendosën njëzëri zgjerimin e radhëve të saj me komunistë të rinj. Për secilin që u fut në celulë u diskutua gjerësisht.

Në celulë u diskutua edhe çështja e demaskimit të Ballit, i cili kishte në bandën e vet rreth 50 vetë. Balli Kombëtar shkonte fshatrave dhe fuste për-çarje. Çdo shtëpie i vinte një «vulë» partizane ose balliste.

Celula vendosi që çeta të ndahej në dy pjesë. Njëra pjesë me Zijanë, Faikun e Lefterin të shkon-te në rajonin e Malit të Thatë, kurse pjesa tjetër në zonën kufitare me Greqinë dhe në qendër të De-vollit.

Raqi, që ishte ngarkuar me një detyrë të ve-çantë nga qarkori duhej të shkonte në Gorë.

Në Fund u bë një raport për qarkorin, ku u ana-lizuan me hollësi të gjitha çështjet që u diskutuan në celulë.

VELLEZËR NË LUFTE

Më 6 qershor, ndërsa ishim në Vidëhovë, një korrier na sjell një letër nga kufiri grek.

— Komandanti i një çete greke kërkon takim,
— na tha anëtari i njësimit të Vidëhovës që solli le-
trën.

Me Seitin e Petron mbërritëm tek piramidet ku
bëmë takimin. Folëm mbi luftën e përbashkët, mbi
lidhjet vëllazërore midis popujve tanë dhe mbi kom-
binimin e veprimeve tona. Bashkarisht vendosëm pa-
rullat e kundërparullat që do të përdroreshin nga të
dy palët në takimet e ndryshme.

Të gëzuar qenë edhe partizanët grekë që luf-
tonin kundër të njëjtit armik. Zbritëm në Vidëhovë.
Për gjithshka informuam shokët e byrosë dhe të
shtabit. Por, po atë ditë, afër mbrëmjes na vjen
një lajmërim tjetër nga Kalevishti.

Komandanti i batalionit të zonës së Nestramit
dëshëronte një takim. U takuam edhe me të.

Biseduam me të gjatë e në mënyrë shoqërore,
sikur të ishim njohur prej kohësh. Me të biseduam
edhe për çështje të tjera, si, lidhur me kondraban-
dën në kufi, kalimin e kufirit, e të tjera. Ne ja
theksuam se pa lejen tonë kalimi i kufirit është i
ndaluar.

U ndamë si shokë dhe zbritëm në Bozhigrad.

Kështu, në një krah të gjerë të Devollit, gjatë
kufirit me Greqinë, çeta «Morava» do të kishte në
luftë kundër armikut edhe vëllezërit grekë...

BATALIONI

«Lufta e partizanëve në gjithë Shqipërinë po
zgjerohet vazhdimisht. Fitoret e Ushtrisë së Kuqe
po shtohen njëra mbas tjetrës. Në këto kondita

Balli Kombëtar po e shton punën e tij për përçarjen e popullit. Ai duhet demaskuar edhe më fort për qëndrimin me dy faqe». Në këtë përfundim arriti mbledhja e celulës së çetës me 4 qershor 1943.

Çeta filloi të lëvizte me shpejtësi në të gjitha fshatrat e Devollit. Më 5 qershor u bë mbledhja e popullit në Sul, më 6 qershor në Menkulas, më 7 qershor në Vidëhovë dhe më 8 qershor në Bozhigrad. Po atë ditë grupi tjetër i çetës zhvilloi mbledhje në Tren, Rakickë, Bitinckë e në fshatra të tjera.

Në mjaft mbledhje erdhi dhe çeta e Ballit. Ne folëm për detyrat e luftës dhe dënuam qëndrimin përçarës të ballistëve. Mbas nesh folën edhe krerët e Ballit si Hydbiu, Demirshau e të tjerë, të cilët u munduan të na mbushnin mendjen se gjoja s'kishte ardhur koha për luftë.

Populli nuk ua vuri veshin. Në çdo fshat u bë riorganizimi i këshillave nacionalçlirimtare. Elementët e bashkuar me Ballin u përjashtuan prej tyre. Partizanë të rinj mbushën radhët e çetës. Shef-kiu, Taqua, Agroni, Besimi, Feimi, Xheladini, Qani, Gaqua e dhjetëra të tjerë dolën vullnetarë. Anëtarët e çetës arritën mbi 150. Kjo ishte përgjegjja më e mirë që ju dha Ballit. Në çetë filluan të vinin edhe vajza si Nora, Dhora, Vasilika, Athinaja, Noi e të tjera. Ato luftuan haptazi kundër armikut, për-krah vëllezërve partizanë.

Më 14 qershor, në Shënkostandin të Bradvicës, u bë gjyqi kundër spiunit fashist Fuat Bualli. Spiuni pranoi se kishte informuar karabinierinë për aktivitetin komunist të Raqi Grabockës dhe të Shyqyri Vishocicës dhe se qe bërë shkak për vrasjen e ty-

re. Gjyqi partizan e dënoi me pushkatim. Vendimi u zbatua menjëherë. Më 15 qershor spastrohet një spiun tjetër në zonën e Trenit. Ky ishte kapteri Sherif Çipani, një agjent i armikut, i cili vritet nga pjesa e çetës që kishte shkuar në ato anë.

Më 18 qershor në çetë erdhi një lajm i gëzuar: çeta «Morava» kishte marrë emrin batalion. Në letrën e Qarkorit thuhej se batalioni e merrte emrin Fuat Babani për kujtim të këtij shoku dëshmor.

Lajmi i formimit të batalionit «Fuat Babani» i gëzoi të gjithë.

Përshpëritjet e para të disa partizanëve, që thoshin se edhe ata nuk ishin më mbrapa nga rrethet e tjera, ku ishin formuar batalionet, u ndërprejnë.

«Si numër ne jemi edhe më shumë, veçse tani duhet ta lozim si duhet». Këto fjalë thoshin partizanët për formimin e batalionit.

Në celulë shqyrtuam organizimin e ri. Partizanët u ndanë në 3 kompani. Rifati, Zijaj dhe Bahriu u caktuan komandantë të tyre. Llaqi ishte kthyer përsëri në Devoll. Ai, Lefteri e Midati u ngarkuan me detyrat e komisarëve politikë të kompanive. Me vendim të Komitetit Qarkor Batua u caktua zëvendëskomandant, Raqi zëvendëskomisar i batalionit dhe Myzaferi komisar i batalionit, kurse Faiku u ngarkua me detyrën e intendentit të batalionit.

Formimi i 3 kompanive të plota dha mundësi për veprime më të gjera. Forcat e batalionit filluan lëvizjen nëpër Devoll e në drejtime të ndryshme.

ZJARRE PËR FASHISTËT

Që në fillim të qershorit një englez na u qep nga mbrapa. Quhej Gerri. Ishte toger. Ai erdhi nga Greqia. Ne e pranuan me urdhër të shtabit të qar-kut, mbasi ai do të na «sillte» veshje e municion... Për shumë ditë nën udhëzimet e tij, partizanët ndiznin zjarre në formë trekëndëshi në gropat e Grap-shtit. Asgjë s'po binte nga qielli. Ç'është e vërteta mbi zjarret kalonte çdo natë aeroplani, por ai s'hidhte gjë. Megjithatë partizanët e caktuar me Gerrin vazhdonin zjarret, pritjen...

Si duket mbi këto zjarre kalonin vetëm aero-planë italianë. Ata kishin zbuluar me saktësi vend-qëndrimet tona.

«Mendojmë kështu mbasi gjatë këtyre neteve, me 25 qershor një skuadër që pushonte në Ziçisht, u ndesh që në mëngjez me forcat fashiste. Ato kishin ardhur nga Bilishti. Kishin udhëtuar gjatë natës dhe në mëngjez kishin arritur në Ziçisht. Skua-dra jonë bëri pak përpjekje dhe u tërhoq pa asnjë humbje. Fashistët italianë s'e kanë zakon të udhëtojnë natën. Ata kanë frikë në çdo kohë. Edhe ditën kontrollojnë çdo drizë. Ata dyshojnë kurdoherë se mos mbrapa tyre fshihen partizanët. S'ka si të jetë ndryshe, — u shpreh Refat Poloska, — pran-daj është më mirë që englezin ta shporim...» Mbas disa ditëve e degdisëm në Voskopojë.

NJË MARREVESHJE PA SUKSES

Devollinjtë filluan të dërgonin njërin mbas tjetrit bijtë e tyre në radhët e batalionit «Fuat Babani». Forcat e Ballit e kishin vështirë të gjenin strehim dhe ushqim. Fshatarët nuk i hapnin dyert me lehtësi ashtu si i kishin hapur në muajt e parë për këta «shpëtimtarë të lirisë»... Për të dalë nga kjo gjendje ballistët kërkuan një takim me përfaqësuesit e batalionit. Kështu, më datën 1 korrik, u takuam në koriet e Sulit.

Problemi i aksioneve të përbashkëta luftarake ishte çështja e parë që u ngrit nga ana jonë, kurse propozimi ynë konkret ishte organizimi i goditjes së përbashkët të autokolonës fashiste në grykën e Kapshticës. Kundërshtimet e Ballit ishin të shumta, armiku ishte i fortë. Megjithatë ballistët, u detyruan të pranonin formalisht se brenda 1 muaji do të futeshin në përpjekje me armikun së bashku me partizanët.

Ndarja e bazave ishte çështja e dytë që ngritën ballistët.

«Populli vendos — ju përgjegjëm ne. — Le të dalim bashkarisht në mbledhjet e popullit, le të flasim të dy palët për të parë se si do të flasë populli».

Sa për sy e faqe, përfaqësuesit e Ballit i pranuan çështjet e ngritura nga pala jonë dhe nënshkruan marrëveshjen.

Me 2 korrik u bë mbledhja e popullit në Sul, kurse më 3 korrik në Menkulas, ku ne folëm për vijën e drejtë të Luftës nacionalçlirimtare. Mbas disa mbledhjesh të përbashkëta, përfaqësuesit e Ballit u shkëputën prej nesh.

Ata filluan të organizonin mbledhje pa pra-

ninë e partizanëve, me qëllim që të shfrytëzonin sipas qejfit marrëveshjen e nënshkruar. Por ne nuk i bëmë sehir. Për të gjitha këto e informuam hollësisht qarkorin.

Më 5 korrik na erdhi përgjegjja e firmosur nga Vreshti (Petro Papi). Në të thuhej: «Po të hyjnë në aksion do të jetë mirë. Kini kujdes! Ata s'e mbajnë fjalën. Në krerët ballistë bën pjesë edhe tradhëtari i partisë Dhimitër Fallo...»

Më 6 korrik, një përfaqësues i Ballit Kombëtar për qarkun e Korçës, me kopjen e marrëveshjes të firmosur në Sul, u paraqit pranë EAM-it (lëvizja nacionalçlirimtare greke) në Pendallofo, (Greqi) dhe kërkoi të bisedonte për arritjen e një marrëveshjeje midis EAM-it dhe Ballit Kombëtar. Partizanët grekë, që e njihnin mirë qëndrimin reaksionar të Ballit Kombëtar, e njoftuan shtabin e batalionit «Fuat Babani».

Më 10 korrik, ndërsa batalioni ndodhej në Vidëhövë, forcat e Ballit Kombëtar, me në krye Fazlli Frashërin, hynë në Baban dhe e lajmëruan popullin se në mbrëmje do të bënin mbledhje.

Fazlli Frashëri, Gani Zëmbllaku, Fuat Eçmeniku, Emin Suli, Hydbi Kulla, Ali Agushi, Hamdi Kasimati, toger Zija Gashi dhe plot bashibozukë u ndanë në grupe dhe po bënin presion mbi fshatarët për t'ua mbushur mendjen që të shkëputeshin nga Lufta nacionalçlirimtare. Duke menduar se Vidëhova është larg nga Babani dhe batalioni gjatë ditës nuk mund të lëvizte në fushë, ballistët e fjetën mendjen. Ata shpresonin të arrinin rezultate të mira qoftë edhe duke përdorur forcën.

Shokët e fshatit, si Fuati, Qamua, Xhevairi e të tjerë, pasi shqyrtuan gjendjen e krijuar nisën

menjëherë korrierët për Vidëhovë dhe njoftuan për atë që po ndodhte në Baban. Të dhënat e tyre i shqyrtuam në shtabin e batalionit dhe vendosëm që Balli të mos lihej i lirë për veprimet e tij në Baban.

U nisëm nga Vidëhova me Hamdiun, Ziqëriun, Sedatin dhe Abedinin, kur ende s'kish përënduar dielli. Ecëm nëpër ara. Mbas dy orësh rrugë hymë në fshat, duke kaluar nëpër vreshta e selishte. U drejtuam drejt për tek shkolla. Atje ishte grumbulluar shumica e fshatarëve. Fazlli Frashëri kishte hipur në shkallët e shkollës dhe bërtiste me të madhe:

— Ju nuk duhet të gënjeheni nga partizanët. Ata po shkallmojnë themelet e kombit. Ata janë agjentë të bolshevikëve, që s'kanë asnjë ideal.

Duke ecur njëri pas tjetrit, pa zhurmë, ju afroam shkallëve dhe hipëm në to. U futëm edhe në «presidium» pa i marrë lejë ndonjërit. Hamdiu dhe Ziqëriu qëndruan në fund të shkallëve nga njëra anë, kurse Abedini dhe Sedati nga ana tjetër. Ata, me buzëqeshje, u jepnin përgjegje përshëndetjeve të fshatarëve, të cilëve filloi t'u çelej fytyra. Duart e tyre lëviznin. Ata fërkonin bombat e varura në brez, përkëdhelnin kokat e revoleve, shtërngonin automatikët...

Kur na vuri re, Fazlli beut ju prish toni i oratorisë. Ai filloi të belbëzonte. Mallkimet e tij për partizanët filluan të zbuteshin. Ballistët filluan të lëviznin, të përshpëritnin: «Si erdhën? Kush i lajmëroi?»

«Ua tregojmë sonte këtyre», kanosej kapedani i Koshnicës, që rrinte afër shkollës.

Sedati i dëgjoji këto fjalë dhe ra në mendime, por e zgjidhi shpejt problemin:

— Të gjitha kodrat janë të mbushura me partizanë, kompanitë e batalionit e kanë rrethuar fshatin anëmbanë. Tani për tani vetëm rruga për në Stropan është e lirë, por edhe atë do të shkojë një skuadër mitraliere, — i tha ai Ahmetit kur ky e pyeti për ardhjen tonë.

Trillimi i Sedatit bëri efekt. Ballistët lajmëruan njëri-tjetrin për të dalë te shkolla. Si mbaroi Fazlliu erdhi radha tonë.

«Lufta nuk do fjalë. Partizanët po derdhin gjak, kurse ballistët po bashkëpunojnë me armikun; partizanët po përfytyen me fashistët, kurse ballistët po shkaktojnë përçarje në popull. Marrëveshjen e Sulit ata e shkelën! Në aksionin e Kapshticës nuk erdhën, me fashistët nuk po gjakosen!» thamë ne.

Fjalët tona për Luftën nacionalçlirimtare dhe demaskimi i Ballit u pritën me brohoritje nga populli.

«Ballistët s'kanë vend në Baban». «Ne jemi me partizanët», thoshin fshatarët.

«Ejani, o fshatarë, — tha Qamua, — se na u ftohën groshët.

Kjo ishte përgjegja që i dhanë fshatarët Fazlli Frashërit. Tek shkolla buçiti kënga.

Fuati dhe Qamua e vunë në gatishmëri luftarake të gjithë njësitin. Tek shkolla erdhën të armatosur mbi 30 veta. Krerëve të Ballit u hyri frika në palcë. Meqenëse plani i tyre në Baban dështoi, ata morën drejtimin për në Stropan, duke lënë në Baban vetëm agallarët, miqtë e tyre.

Xha Hamiti, kur po largoheshin ballistët, foli me zë të fortë:

— Edhe grurin që kanë mbledhur ballistët do t'ua japim partizanëve.

Ato ditë me urdhër të qarkorit, një grup partizanësh, u larguan nga Devolli. Ata do të bënin pjesë në Brigadën I S, që do të formohej në Vithkuq.

BATALIONET SHTOHEN... LUFTA ZGJEROHET

Më 28 korrik i deleguari i qarkorit zhvilloi një konferencë të gjerë me kuadrot kryesore të batalionit. Ai tha se në Barmash batalionet partizane kishin bërë një përpjekje të ashpër me armikun. Në Pojskë të Pogradecit partizanët kishin bërë një luftim të gjatë me italianët. Atje ishte vrarë Reshit Çollaku e partizanë të tjerë. I deleguari na shpiegoi se në Labinot ishte formuar Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Komisar i Shtabit të Përgjithshëm ishte zgjedhur Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Komuniste shoku ENVER HOXHA dhe komandant i shtabit Spiro Moisiu. Ky lajm i gëzoi të gjithë shokët. Forcat partizane do të vepronin mbi bazën e planeve më të koordinuara. Shoku i qarkorit na sqaroi edhe për lajmet në frontin sovjetik.

Kopjen e komunikatës e punuam me partizanët. Brohoritjet qenë të shumta.

NË SHKEMBINJTË E GOLLOMBOÇIT

Më 16 gusht 1943 një kompani e batalionit goditi fashistët në Gollomboç. Për këtë aksion komunikata e Komitetit Qarkor të Korçës, që doli ato ditë, shkruante:

«Në rrugën Pustec-Gollomboç armiku fashist hëngri një grusht të rëndë. Një kompani e batalionit «Fuat Babani» më 16 gusht 1943 bëri atje një pritë të organizuar mirë. Një autokolonë e drejtuar nga Prespa u godit nga partizanët kur hyri midis shkëmbinjve. Mbas gjysmë ore lufte të ashpër, e gjithë autokolona u dorëzua. Në fushën e betejës mbetën të vrarë një oficer italian, një milic shqiptar dhe dy ushtarë italianë. U dorëzuan 50 ushtarë italianë, midis të cilëve një kapiten, një nëntoger xhandarmërie, 3 nëntogerë italianë, një marshall, një resh-ter, 3 xhandarë.

U zunë këto plaçka lufte: një mitraloz i lehtë, 54 pushkë, 30 palë rroba, 50 këmbishë, 4 palë këpucë, 6 revole bereta, një maqinë shkrimi; u dogjën 3 automobila të ngarkuar me material. Nga ana e partizanëve nuk pati asnjë humbje.

Nga Rakicka, Treni, Vërniku, kompania e batalionit arriti në Ponçarë e Vidëhovë së bashku me oficerët e zënë rob. Ndërkohë aeroplanët fashistë kërkonin të zbulonin partizanët gjatë rrugëve malore. Ata mitraluan popullsinë e Rakickës, plagosën shumë njerëz dhe vranë mjaft bagëti. Kompanitë e tjera të batalionit ishin në Ponçarë. Italianët kërkuan kthimin e robërve. Fletushkat e tyre shpërndaheshin edhe me aeroplan.

Për këtë qëllim ata dërguan me forcë disa të deleguar nga fshatrat që të paraqiteshin në batalion ku do të njoftonin mbi kërcënimet fashiste për të djegur të gjitha fshatrat, e për të pushkatuar qindra njerëz, në qoftë se nuk do të liroheshin robërit e zënë në Gollomboç.

Por kërcënimet nuk dhanë asnjë rezultat. Shtabi i batalionit i përcolli robërit në shtabin e qar-

kut në Voskopojë. Forcat e batalionit u vunë në gatishmëri luftarake për të goditur çdo hyrje të armikut në drejtim të fshatrave të sipërme. Vija e shpërndarjes së forcave partizane u shtri nga Ponçara gjer në Sinicë. Armiku nuk guxoi të hynte në brendësi të Devollit.

KRIME BALLISTE

Në gusht të vitit 1943 bashibozukët e Ballit me në krye Demirshah Rexhepin dhe Fuat Eçmenikun, u grumbulluan në Stropan. Atje arrestuan komandantin e njësitit guerril, Beqir Sulejman Qosen.

E detyruan të lëshonte një deklaratë, ku të thoshte se hiqte dorë nga Lufta nacionalçlirimtare, por Beqiri nuk u bind. Që në fillim të luftës ai ishte kundër sundimit të bejlerëve dhe agallarëve, prandaj Demirshahu e kishte halë në sy. Krerët e Ballit, së bashku me Fuatin, etj. vendosën ta pushkatojnë. Dhe më në fund e vrasin barbarisht. Familja e Beqos, kur i vajtëm për ngushëllim, na tha:

«Ai u vra për partinë. Vetëm na vjen keq se u vra pabesisht».



Beqir Qose

Kriminelët e Ballit i përlyen duart me gjakun e partizanëve.

Kështu pra, Balli Kombëtar po hynte gjithnjë e më thellë në rrugën e tradhëtisë.

GJAKESORËT E RINJ

Në 4 shtator në Vërlen u bë mbledhja e shtabit të batalionit.

— Tani priten të ndodhin ngjarje të mëdha. Armatat e lavdishme të Stalinit i shpartalluan hor-dhitë fashiste italiane në frontin e Odesës. Si duket, Italia po del nga lista...

Kështu tha i deleguari i qarkorit në atë mble-dhje.

Dhe me të vërtetë, më 9 shtator u shpall botë-ri-ri kapitullimi i Italisë. Duçja u zhduk nga skena. Sotiri e nuhati këtë lajm në Zicisht. Ai e përhapì menjëherë. Partizanët dolën nga bazat. Pa lajmëruar njeri ata u grumbulluan në sheshin e shkollës. Ba-shkë me ta dolën edhe burrat, gratë, fëmijët. Sheshi jehonte nga këngët partizane.

Përgjegjësit e batalionit po u flisnin partizanëve dhe po u caktonin detyrat.

Një kompani duhej të nisej me Faikun për në Dardhë, kurse një kompani tjetër për në Bilisht.

Të merreshin në dorëzim e të çarmatoseshin italianët në Bilisht e Dardhë, t'u merreshin ushqimet e municionet dhe, po të mos bindeshin, të sul-moheshin gjersa të asgjësoheshin.

Të çliroheshin me çdo kusht Dardha dhe Bilishti.

Ende s'ishin sqaruar detyrat, kur një pushkë krisi nga një krah. Një partizan ra për tokë.

Ky ishte Rifat Poloska, anëtari i Partisë Komuniste Shqiptare, komandant i kompanisë.

Balli Kombëtar, që nuk kishte zbratur asnjë pushkë kundër fashizmit, e hapi luftën kundër vëllezërve të vet. Ballistët u bënë shkaktarë të vëllavrasjes. Tradhëtia e tyre u vulos me gjakun e shokëve tanë.

Partizanët e batalionit u sulën mbi ballistët. Fakja i vrarë i hodhi në sulm. Ballistët u përpoqën të largoheshin, por s'u shpëtuan dot plumbave të partizanëve.

Përgjegjësit kryesorë të çetës së Ballit si Hydbi Kulla, Hamdi Kasimati, togeri i akademisë italiane Zija Gashi, e të tjerë, mbetën të vrarë në vijat e Ziçishtit. Por vrasja e tyre nuk e lante gjakun e Fakes. Partizanët nuk mund të vazhdonin ndjekjen e tyre, sepse detyra kryesore e tyre ishte të çlironin Dardhën dhe Bilishtin. Një grup partizanësh u la për të varrosur Rifatin, të tjerët u nisën në drejtimet e caktuara.

Më 10 shtator partizanët e batalionit hynë në Bilisht. Populli i priti me gëzim dhe brohoritje. Ata filluan menjëherë çarmatosjen e italianëve dhe tërheqjen e ushqimeve e municioneve të tyre drejt bazave të Moravës. Zijai me një skuadër shkoi në Kapshticë dhe çarmatosi postën e atjeshme kufitare.

Të nesërmen, më 11 shtator në drekë, gjithshka ndryshoi. Në Bilisht filluan të qëndronin kamiona, autobllinda, motoçikleta. Prej tyre zbrisnin njerëz të armatosur. Këta ishin gjermanët, pushtuesit e

rinj, që do të zëvendësonin italianët. Në atë kohë me Latifin mbërritëm në Bilisht nga Janoveni. Bë më mbledhjen e shtabit të batalionit, shqyrtuam gjendjen dhe vendosëm që menjëherë të godisnim gjermanët.

Partizanët u lajmëruan njëri pas tjetrit të dilnin nga shtëpitë e fshatit dhe të zbrisnin në lagjen e qytetit. Prapa bashkisë u bë ndarja e forcave.

Një kompani, me Zijanë, Llaqin e të tjerë, do të sulmonte nga krahu i Kapshticës, një tjetër, me Hamdinë, nga krahu i Bitinckës, kurse e treta do të sulmonte qendrën e qytetit.

Të gjitha kompanitë, duke goditur gjermanët, do të kalonin xhaden dhe do të vendoseshin në pozicionet e poshtme të qytetit.

Urdhërat u transmetuan me shpejtësi.

Lëvizja e partizanëve nëpër sektorët filloi. Kur po zinin pozicionet e caktuara, një autokolonë e madhe gjermane, që vinte nga Korça, hyri në Bilisht. Ajo shkante drejt Follorinës.

10-15 maqinat e para kaluan. Ato dolën në krahun e djathtë të Bilishtit drejt Kapshticës. Në orën 4 mbasdreke u dha shenja e sulmit të batalionit mbi gjermanët. Tek bashkia, ku ishte shtabi i batalionit, krisi automatiku. Zhurma e tij u shoqërua me një buçitje të fortë pushkësh e mitralozash. Gjermanët u hutuan. Ata nuk e prisnin një zjarr të tillë. Filluan të shtinin dhe të shtonin shpejtësinë e motorëve të tyre.

Përpjekja u bë e ashpër në të gjithë lagjen e qytetit. Por ajo u bë më e fortë që përpara postës e gjer në pazarin e bagëtive. Që prapa avllive parti-

zanët hidhnin bomba dore. Ndërkaq mori flakë një kamion, pas tij edhe një tjetër. Në këtë drejtim sulmonte grupi më i madh i partizanëve. Edhe një kamion tjetër mori flakë. 5 kamionë të tjerë mbetën në vend. Kërmat gjermane u shtrinë në xhaden e Bilishtit. Partizanët kaluan nën xhade.

Lufta vazhdonte nga bahçet nën Bilisht. Në këtë kohë 3 kamiona, që kishin qëndruar në vend, filluan të lëviznin drejt Poloskës. Ata i morën partizanët.

Në kamionin e parë u bë shofer Jorgua, në të dytin Thimi dhe në të tretin Shabani. Po ecnin drejt Dardhës.

Afër Sinicës për pak u hodhën në erë nga fshatarët, të cilët dyshuan se mos ishin gjermanë.

Aty nga ora 5.30 drejt Bilishtit po afrohej një autokolonë tjetër. Partizanët u urdhëruan të spostoheshin në kodrinat e Poloskes. Ndërsa ende luftohej në bahçet, dy partizanë, komisari i kompanisë, Mihallaq Ziqishti, dhe Vasil Boro u plagosën nga plumbat e armikut. Lajmi u përhap menjëherë, por të gjithë u gëzuan, kur mësuuan se asnjëri nuk ishte në rrezik vdekjeje. Shokët e plagosur u tërhoqën përpara. Afër mbrëmjes batalioni u vendos në kodrinat e Poloskes. Gjatë luftimit të kësaj dite ai i shkaktoi armikut 30 të vrarë, shumë kamiona të djegur dhe 3 të rrëmbyer. Por armiku nuk doli nga qyteti. Ai vazhdoi lëvizjet Bilisht-Follorinë e anasjelltas dhe pastaj u drejtua për në Korçë.

3 kamionat e zënë më 12 shtator, kaluan Dardhën e zbritën në Boboshticë. Shoferët partizanë, duke kaluar midis kolonave gjermane, i shpunë ata në Vithkuq dhe ja dorëzuan Shtabit.

— Edhe ata i zënka plumbi, — thoshte Xha Kasua duke qeshur.

— Veç... derrat nuk lëviznin lehtë nga vendi, — ja priste Xha Aliu.

Gjermanët aktivizuan menjëherë bashkëpunëtorët e tyre, ballistët. Më 15 shtator gjermanët u nisën për në Poloskë e Çipan. Në Çipan një patrullë partizane u përpoq me ballistët. Atje u vra Syrja Çakçiri. Mbi 100 shtëpive e plevicave në Poloskë ju vu flaka.

DY DËSHMORE TË TJERË...

Më 15 shtator banda balliste kaloi në Tren. Komandanti i njesitit, Raif Hyseni, nuk pati kohë të largohej. Kriminelët e Ballit e arrestuan, e pushkatuan dhe pastaj u larguan.

Populli i Trenit u grumbullua menjëherë në familjen e Raifit. Të nesërmen ai e përcolli me nderime birin e tij besnik, i cili s'u përkul asnjëherë përpara presionit të armikut.

Mbi varrin e Raifit foli partizani i plagosur, që strehohej në Tren, Petro Lakrori. Ai foli për besnikërinë e patundur të Raifit në luftën për çlirimin e popullit. Petrua e ftoi popullin të rrokte armët dhe të luftonte kundër fashistëve dhe tradhëtarëve të vendit.

Mbas varrimit, kur fshatarët sapo ishin shpërndarë nëpër shtëpitë e veta, një grup i madh gjer-

manësh e ballistësh hynë në Tren. Ata kërkonin partizanin e plagosur, Petro Lakrorin. Shtëpia ku qe strehuar ai, u rrethua menjëherë. I thanë Petros të dilte jashtë e të dorëzohej, por ai ua ktheu përgjegjen duke hedhur nga dritarja një bombë dore, e cila vrau dy gjermanë.

Por ndërkaq edhe plumbat e armikut e goditën për vdekje. Në çastet e fundit të jetës, ai thirri:

«Të rrojë Partia Komuniste! Poshtë tradhëtarët!»

PËRLESHJE NË MORAVË

Grushtin që hëngrën në Bilisht gjermanët nuk e harronin.

Natën e 23 shtatorit një kompani e tyre prej rreth 70 vetash arriti në Bradvicë. Në mëngjez, në afërsi të atij fshati, hapën një breshëri zjarri mbi shtëpitë dhe hynë në fshat. Ata mendonin se atje ndodheshin forcat e batalionit, por më kot. Partizanët nuk ishin atje.

Vetëm në një shtëpi, në anë të fshatit, nuk mund të afroheshin gjermanët. Nga dritaret e saj qëllonin me kujdes dy pushkë dhe një mitraloz.

Aty ishte infermiera e batalionit me 3 partizanë të plagosur, Nevruz Poloskën, Myfit Stropanin dhe Xhemali Babanin. Ndonëse të rrethuar, ata nuk dorëzoheshin. Ata, edhe pse ishin të sigurt se do të vdisnin, luftonin me kurajë dhe shpirt të vendosur.

Të xhindosur nga zjarri i tyre, gjermanët ju afruan shtëpisë nga një krah dhe hodhën bomba

11-12

zjarri. Infermiera mori zjarr. Partizanët vazhdo-
nin të rezistonin. Në pragun e shtëpisë ata ngritën
barrikadën. Gurët e oborrit u lanë me gjakun e
tyre. Kauzën e çlirimit të popullit e të atdheut nuk
e tradhëtuan.

Gjermanët sulmonin popullin, mblihdnin fsha-
tarët, merrnin bagëtitë e tyre dhe digjnin shtëpi.
Në mes të popullit ata vranë partizanin Haxhi
Dobranji. Mbas këtyre krimeve nazistët filluan të
dilnin nga fshati. Një kompani e batalionit «Fuat
Babani», që ndodhej në Hoçisht, me të dëgjuar pu-
shkët, që zbrazeshin në Bradvicë, u nis. Duke ma-
rrë, udhëhoqën mbi faqen e Moravës doli mbi rru-
gën e armikut.

Kompania tjetër, që ishte në Sinicë, mori me-
njëherë drejtimin për në Bradvicë. Nga sipër, nga
lajthishtet, gjermanët u goditën në afërsi prej par-
tizanëve.

Armikut i hyri tmerri. Ai filloi të ikte me vrap,
duke lënë bagëtitë dhe të arrestuarit. Prapa e sipër
tyre oshëtinin plumbat partizane. U rrëzuan një, dy,
tre, pesë gjermanë; të tjerët vazhdonin të iknin.
Por edhe partizanët nuk ndaleshin. I ndoqën pa
pushim, duke kaluar Grapshtin, Vërlerin, gjersa
nuk dukej asnjë prej tyre.

Në Vërlerin doli njësi i fshatit dhe ja preu ar-
mikut vrapin që kishte marrë. Pyka e parë që futën
gjermanët në brendësi të Devollit, u thye. 13 gjer-
manë mbetën të vrarë në përrrenjtë e Grapshtit e të
Vërrenit. U zunë një mitraloz dhe 15 pushkë. Përra-
llës se gjermanët nuk tërhiqen nuk i besohej më.
Partizanët dhe populli ishin të gëzuar për fitoren
mbi pushtuesin e ri.

Por në këtë fitore pati dhe humbje. Në përleshjen e njësitit të Vërlenit u vra anëtari i tij Abdulla Sabriu. Ai ju qep një gjermani që ishte fshehur në shelgishtat e lumit dhe me pushkë në dorë shkonte drejt tij. Gjermani e shihte mirë nga drizat dhe e qëllloi për vdekje. Po atë ditë u vra dhe partizani Haxhi Dobranji.

Haxhiu kishte hyrë në çetë që në shkurt të vitit 1943. Thirrja e partisë për të luftuar kundër armikut e tërhoqi menjëherë. Të gjithë pjesëtarët e familjes së Haxhiut ishin me luftën. Bënte pjesë në njësitin guerril të fshatit.

— Edhe unë jam si të tjerët, — i tha ai komisarit kur çeta po largohej nga fshati. Këto fjalë tregonin se Haxhiu desh të bashkohej me të.

Në çdo aksion Haxhiu ishte ndër të parët.

Më 11 shtator në luftimet e Bilishtit ra befasisht në duart e gjermanëve.

Kur Haxhiu po pinte ujë tek çezma afër restorantit të Demirit, dy gjermanë ju hodhën për sipër. E lidhën dhe e futën në një kamion. Papritur ai u bë rob i gjermanëve. E shpunë në një kamp përqëndrimi në Kostur. Atje e ndjente veten të mbyllur si bisha në kafaz. Mendja e tij punonte vetëm për të ikur. Dhe rrugën e gjeti. Pas gjashtë ditësh ai kaloi telat me gjemba dhe u arratis. Udhëtoi drejt kufirit në Nestram, Shag dhe arriti në Vidëhovë. Në mbrëmjen e 22 shtatorit, arriti në bazën e lartë të batalionit në Bradvicë. Të nesërmen, gjermanët po hynin në fshat. Haxhiu nuk ndjente aspak frikë, ai u jepte zemër fshatarëve duke shkuar sa nga njëri tek tjetri. Ai mendonte rrugën për të shpëtuar nga kurthi i ri i armikut. U përpoq të largohej me kujdes nga turma, por u diktua nga armiku dhe sa

bëri disa hapa larg tij ra i vrarë nga plumbat e automatikut gjerman.

EDHE NJË GRUSHT TJETËR PËR GJERMANËT

Edhe nga grushti që morën në Bradvicë gjermanët nuk vunë mend.

Me 30 shtator 1943 një grup gjermanësh prej 100 vetash, drejtohet për plaçkitje nga Bilishtit në Hoçisht, ku pushonte një kompani e batalionit. Partizanët e batalionit i diktuan qysh së largu. U rrjesh-tuan poshtë fshatit në pozicion luftimi dhe po prisnin. Kur gjermanët, të shkujdesur, po afroheshin, partizanët hapën zjarr të menjëhershëm mbi ta. Armiku vraponte nëpër ara, me drejtim nga lumi. Partizanët i ndiqnin. Kur gjermanët ndaluan buzë lumit, zjarri i pushkëve partizane shtohet vazhdimisht. Kompania që ndodhej në Vërlen, doli menjëherë nga fshati dhe vrapoi në drejtim të fushës. Gjermanët u shpërndanë nëpër fusha. Atyre u kishte hyrë tmerri.

Duke u ndodhur midis dy zjarresh, gjermanët vraponin të shpartalluar nëpër fushat drejt Bilishtit. Partizanët i ndiqnin këmba-këmbës. Hamdiu, Petrika, Bektashi me mitralozat e lehtë, ecnin me vrap nëpër ugaret dhe qëllonin. Nga vrapi, nga plumbat, tymi i ugareve ngrihej përpjetë, dhe të dukej sikur i ngjante një autokolone.

Kur kaluan urën e Poloskës, partizanët kapën një kamp me robër italianë, që i kishin sjellë nga Follorina. Menjëherë vranë rojet gjermane dhe vazhduan të ndiqnin ata që iknin drejt Bilishtit. Nuk ishim më larg se 500 metra nga shtëpitë që ndodhe-

shin në anë të qytetit. Zjarri i mitralozave nga kazer-
mat gjermane shtohet vazhdimisht. Te vija e ujit, që
kalonte nëpër bahçet, u vendos vija e batalionit.

Xha Kasua, Xha Aliu, e të tjerë u shtrinë buzë
hendekut. Nga ai pozicion, për më se dy orë, partizan-
nët vazhduan goditjen mbi armikun dhe sprapsën
dy sulme gjermane, që vinin nga Bilishti.

Ndërkohë një autokolonë gjermane, që po vinte
nga Follorina, hyri në Bilisht. Në krye të saj ishin
tre autoblanda.

Mendua se armiku mund t'i fuste në veprim
këto autoblanda. Ne ishim në fushë. U dha urdhëri
që partizanët të lëviznin mbi kodrat e Poloskës.

23 italianë të çarmatosur u çliruan nga duart
e gjermanëve. Një kamion me materiale të ndryshme
u hoq nga partizanët drejt Shënkollasit. Më se 46
gjermanë mbetën të vvarë.

Gjermanët, të gjakosur rëndë, vendosën të hak-
marreshin menjëherë. Dy autoblanda, që udhëhiqnin
autokolonën gjermane, porsa kaluan urën e Devollit
u kthyen menjëherë dhe hynë përsëri në Bilisht.
Pastaj, të shoqëruar nga një numër i madh ushta-
rësh, dolën tek kazerma. Atje u ndanë në dy pjesë,
njëra mori rrugën drejt Poloskës, kurse tjetra drejt
Vishocicës. Qëllimi i armikut ishte të rrethonte par-
tizanët në fushë, por taktika e tyre dështoi. Parti-
zanët ishin zhvendosur në kodrat nën Poloskë dhe
në kodrën midis Kuçit e Poloskës, prej nga godisnin
pa ndërprerje gjermanët. Autoblanda, që vinte drejt
Poloskës, avancoi. Mbas saj vinin forca të konside-
rueshme gjermanësh. Mbas një ore luftimi, me ur-
dhër të shtabit të batalionit, partizanët filluan tër-
heqjen. Një kompani me Zijanë u tërhoq gjatë lu-
mit të Devollit drejt Braçanjit, dhe tjetra gjatë lu-

mit të Çipanit, duke prerë kontaktin me armikun.

Pjesa e batalionit që u tërhoq me Zijanë në drejtim të Braçanjit e pati rrugën më të vështirë. Ajo u vu nën zjarrin e të dyja kolonave të armikut në ormanet e Kuçit. Në këto çaste Zijaji u plagos në gju, kurse partizanët u tërhoqën plotësisht.

Plani i gjermanëve dështoi. Brenda ditës dy herë sulmuan me zjarr fshatarët e Poloskës, Shënkollasit, Kuçit e Braçanjit dhe dogjën një numër të madh shtëpish. Në këtë luftim, partizanët e batalionit luftuan me guxim më të madh kundër armikut. 5 partizanë, Zair (Pasho) Ponçara, Stavri Gjerasi, Hodo Aidini. Ismail Mustafai dhe Sokrat Taluri mbetën në fushën e luftës. Në këtë

luftim morën pjesë edhe një numër i madh luftëtarësh të njësiteve guerrile. Prej tyre ranë trimërisht në luftim e sipër Qamil Tahiri, Mehmet Rexhepi dhe Gani Hameti.

Luftimet e batalionit e ngritën moralin e popullit. Ai nuk kishte frikë nga gjermanët, nga djegjet, nga terrori. Radhët e batalionit shtoheshin vazhdimisht. Në atë kohë e-fetkivi i batalionit i kalonte të 300 partizanët. Nëpër fshatrat kishin shprehur gatishmërinë qindra të tjerë. Ata prisnin vetëm lajmërimin për të hy-



Zair Pasho (Ponçara)



Stavri Gjerasi

rë në radhët e partizanëve, kurse në çdo luftim merrnin pjesë vullnetarisht.

MYSAFIRË NË DARDHË

Më 4 tetor ishim në Dardhë.

Afër mbrëmjes u dëgjuan disa të shtëna nga Biglla, por s'ishte gjë: patrulla kishte shtënë disa herë mbi një ljepur që kalonte në pllajë. Në mbrëmje Faiku, sekretari i celulës së batalionit, u nis për në Voskopojë për mbledhjen e aktivitetit. Bashkë me

Faikun e disa partizanë përcollëm për shtabin e qarkut edhe 3-4 barrë plaçka. Po atë mbrëmje erdhën në Dardhë 27 të rinj grekë.

Brohoritje, këngë, gëzim. Sheshi para shkollës u mbush me fshatarë: burra, gra dhe partizanë. Më 5 tetor, qysh në mëngjes biseduam gjatë me përgjegjësin e rinisë së çetës partizane greke.

Meqenëse ai paraqiti nevojën për të biseduar me një përgjegjës të Rinisë Komuniste Shqiptare, vendosëm që ai të shkonte në Voskopojë. Atje mendonim se do të gjente përgjegjës rinie, meqenëse ato ditë do të bëhej një konferencë. Vendosëm gjithashtu të bënim një konferencë të përbashkët.

Pasdreke u mblodhëm në shkollë. Nëpër banka

shihje të përzier partizanë grekë e shqiptarë. Salla e mbledhjes u përgatit nga të rinjtë dardharë, grekë dhe partizanët e batalionit. Nëpër muret e shkollës u ngjitën fotografitë e Marksit, Leninit e Stalinit, flamuj me drapër e çekan sij dhe shumë letra të shkruara me parulla të ndryshme. Pastaj të dy palët kënduan Internacionalen, ata në greqisht, ne në shqip. Mbasi u uruam mirëseardhjen në vendin tonë, ja dhamë fjalën përgjegjësit të çetës greke. Ky së pari shprehu kënaqësinë që midis nesh ndodheshin partizanë grekë, foli mbi situatën duke shprehur besimin në fitoren e sigurt, mbi vëllazërimin greko-shqiptar dhe më në fund shfaqti dëshirën që një çetë shqiptare të shkonte në Greqi.

Pastaj kënduam dy-tri këngë dhe folën edhe shokët tanë.

Në orën 7 të mbrëmjes 20 partizanë, me përgjegjës Cockën, shkuan në Drenovë për të arrestuar disa persona të dyshimtë. Ata duhej të godisnin një nga postbloqet e Korçës. 5 partizanë të tjerë u nisën me çetën greke për në Qytezë; 8 partizanë shqiptarë dhe dy grekë me përgjegjës të çetës së tyre, si edhe korrieri ynë u nisën për në Voskopojë. Ata morën me vete edhe revolet që kishin mbledhur. Bashkë me ta u nis edhe partizani i plagosur, Vasfiu. Kompania jonë u nis për në Arrëz. Me të mbërritur atje, u ndamë nëpër baza. Nga ora 9 erdhi një letër prej shtabit të qarkut, me anën e së cilës urdhërohej batalioni «Gjashtë dëshmorët» për të shkuar në sektorin e Ploçishtit, ku kishte filluar operacioni gjerman. Ndërkohë na erdhi një letër prej Lefterit, i cili na pyeste për drejtimin. Pastaj na erdhi dhe një letër prej Dinços, i cili kërkonte ndi-

hmën tonë në sektorin e Malit të Thatë, ku kishte dalë Musa Kranji me një bandë ballistësh.

Shkruajmë urdhërat:

— Të lajmërohet batalioni «Gjashtë dëshmorët» për t'u nisur në drejtim të Voskopojës.

— Kompania II me Llaqin të marrë drejtimin në qendër të Devollit dhe të godasë postblokun e Bilishtit.

— Lefteri të niset në drejtim të Malit të Thatë, ku të bëjë lidhje me maqedonasit dhe të zhvillojë punë politike me fshatarët e atjeshëm.

Letrat i mori Myftar Progri me drejtim Ziçisht, ku ndodhej Llaqi.

OPERACIONI

Afër mesnatës të 7 tetorit, një skuadër e batalionit goditi postblokun e Korçës nga ana e Shëndëllisë. Zjarri partizan vazhdoi 20 minuta. Armiku nuk doli nga fortinat në luftim të hapur. Të nesërmen, më 8 tetor, një skuadër e kryesuar nga Hakiu, dhe një tjetër, e kryesuar nga Hamdiu, goditën të dy postbloqet e garnizonit gjerman në Bilisht, me qëllim që të zbulonin qendrat e tij të zjarrit. Nata e errët dhe qielli i ngarkuar me re të zeza i ndihmoi partizanët të afroreshin pa u diktuar. Por armiku i kishte marrë masat. Me të filluar zjarri i partizanëve ai u përgjegj me mitraloza dhe mortaja, duke bërë njëkohësisht një ndriçim të madh me anën e prozhektorëve. Mbas një qitjeje të shkurtër, skuadrat u tërhoqën pa asnjë humbje. Armiku s'mund ta duronte një gjë të tillë.

Më 7 tetor Llaqi lajmëroi nga Grapshti se një bandë balliste me rreth 100 veta, po hynte në Devoll. Nga ana e Kolonjës vazhdonte gjëmimi i artilerisë. Më 8 tetor, së bashku me Lonin, shkuam në Janoven, ku u takuam me shokët e atjeshëm dhe përsëri u kthyem në Vidëhovë. Të nesërmen erdhën 35 partizanë jugosllavë, të shkëputur nga operacionet në zonën e Manastirit. Më 10 tetor, në orën 6 e gjysmë të mëngjesit, një kolonë gjermane arriti në Grapsht. Llaqi, Hamdiu, Nasi Dimo dhe Gjezi, që ndodheshin atje me një grup partizanësh, drejtuan sulmin mbi armikun.

Mbas një luftimi prej gjysmë ore, grupi partizan me dy të plagosur, Ismail Sinicën dhe Ilo Andrean, u tërhoq nga krahu i Hoçishtit. Armiku dogji një numër shtëpish dhe vazhdoi përpjetë për në Bradvicë. Atje ua vuri zjarrin të gjitha shtëpive. Mbas këtij krimi bishat naziste morën me vete të gjitha kafshët, popullin e fshatit dhe zbritën drejt Gjyrasit. Edhe këtu armiku dogji një numër shtëpish dhe vazhdoi rrugën për në Ziçisht. Ndërkohë një kolonë tjetër, e përbërë nga 2 autoblanda dhe 7-8 kamiona, arriti në Shënkollas. Ndërkaq gjermanët, duke ndjekur vijën kufitare, më 11 tetor, dogjën fshatrat greke Janoven, Slimnicë, Pilkat e Kalevisht.

Në një situatë të tillë vendosëm që forcat të kalonin në Stropan. Armiku përpiqej ta sulmonte batalionin nga të gjitha krahët. Kështu, më 13 tetor, një kolonë gjermane u nis nga Korça, kaloi Boboshticën dhe arriti në Dardhë me 500 veta. Që atje një pjesë e kolonës mori drejtimin Sinicë — Grapsht — Hoçisht — Baban, kurse pjesa tjetër Arrëz — Bozhigrad — Menkulas — Poloskë —

Bilisht. Në Grapsht armiku dogji 18 shtëpi. Ndërkaq u nis nga Korça për në Cangonj, Pilur, Eçmenik edhe një kolonë tjetër gjermane, e cila, duke kaluar Moravën, doli në Dishnicë.

Në të njëjtën kohë, forca të tjera u nisën nga Bilishti me drejtim Stropan dhe Baban, ku u takuan me kolonën gjermane që vinte nga Hoçishti. Pararoja e batalionit u ndesh me kolonën që vinte nga ana e Cangonjit në meritë e Stropanit. Për të shpëtuar nga rrethimi i të gjitha kolonave armike, u tërhoqën nga Stropani në drejtim të Arrëzë — Nikolicës, duke kaluar nëpër shtigjet e Moravës.

Kështu kolonat armike, që ishin nisur nga drejtime të ndryshme, brenda një dite shkelën gati të gjitha fshatrat e Devollit. Në rrugën Bilisht-Korçë gjithë ditën vazhdonte një lëvizje e madhe forcash dhe mjetesh që vinin nga ana e Greqisë. Të nesërmen kolonat gjermane nuk u dukën më dhe forcat e batalionit filluan të lëviznin nga njëri fshat në tjetrin. Ato ditë Llaqi e pati pisk punën me englezin Gerri, të cilin ja kishin dhënë në ngarkim, .. se mund të hidhte me aeroplan ndonjë automatik të ri a ndonjë xhaketë. Prandaj më 8 tetor e futi në korijet e Grapshtit, më vonë e mbajti 3 ditë në borigat e Qytezës, dhe më 15 tetor e çoi në Nikolicë, ku kërkoi që t'ja hiqnin qafe.

— S'mund të mendoj vetëm për të. Le t'ja shohë hairin ndonjë tjetër.

Po atë ditë në bazë të urdhërit të shtabit të garkut Gerrin e çuam në Voskopojë, ku e lamë pranë shtabit, sikurse radhën e parë.

NE NDIHMË TË MAQEDONASVE

Më 13 tetor na vjen një letër nga partizanët maqedonas të zonës së Prespës. Ata kërkonin ndihmën e batalionit tonë. Pasi lexuam letrën, e diskutuam çështjen dhe vendosëm që të nisej kompania II me komandant Zijanë dhe komisar Lefterin.

Kështu, më 14 tetor, ajo u nis për në Tren. Detyra e saj ishte që të ndalonte mobilizimin e popullit me forcë nga ballisti Musa Kranji, i cili vepronte në fshatrat Lubonjë, Nakolec, Kranjë e të tjera. Kompania duhej t'i ndihmonte partizanët maqedonas, që vërtiteshin nëpër zonat malore, për të hyrë në fshatrat.

Dhe kompania i kreu me sukses detyrat e ngarkuara. Ajo qëndroi atje rreth 15 ditë. Në të gjitha fshatrat e Prespës së Madhe u bënë takime e konferenca me popullin. Ajo kapërceu të gjitha pengesat e ushtrive gjermano-bullgare, që ruanin rrugën Manastir-Follorinë. Banda e Musa Kranjit u detyrua të largohej. Me partizanët maqedonas u bashkua një numër i madh partizanësh të rinj. Efektivi i tyre u zgjerua. Forca e tyre ishte e mjaftueshme për të përballuar reaksionin e vendit. Mbasi kreu këtë detyrë, kompania u kthye përsëri në Devoll, ku u bashkua me forcat e tjera të batalionit.

SQARIME — ORGANIZIM

Mbas operacionit, detyra kryesore për disa ditë ishte të bëhej mbledhja e shtabit, e celulës së partisë, e grupeve të rinisë komuniste dhe e këshillave

nacionalçlirimtare. Më 21 tetor, shtabi i batalionit caktoi detyrat.

U vendos që Zijai të ishte nënkomandant i batalionit.

Lajme të mira na vinin çdo ditë. Një komunikatë e Shtabit të Përgjithshëm njoftoi për sukseset që kishin arritur partizanët në luftë kundër gjermanëve në Drashovicë, në Krujë e në vende të tjera. Filluan sqarimet.

Në Qytezë, më 22 tetor, Llaqi bëri mbledhjen e rinisë së këtij fshati. Më 23 tetor, Llaqi dhe Faiku bënë në Arrëzë mbledhje me kompaninë e Hamdiut dhe në mbrëmje Llaqi bëri mbledhjen e këshillit nacionalçlirimtar. Më 25 tetor u bë mbledhja e këshillit nacionalçlirimtar në Menkulas dhe më 26 tetor mbledhja e rinisë në Ziçisht. Më 29 tetor Llaqi me Nellën bënë mbledhjen e rinisë në kompaninë e Bahriut, ku u zgjodh këshilli antifashist i rinisë me kryetar Gristaq Cajon, kurse më 30 tetor rinia e kompanisë së Hamdiut zgjodhi si kryetar të këshillit antifashist të rinisë Pandi Gjezin. Po kështu më 4 nëntor në Hoçisht Faiku bëri mbledhjen e rinisë në kompaninë e Zijait që zgjodhi këshillin antifashist të rinisë. Po atë ditë Faiku bëri mbledhjen e këshillit nacionalçlirimtar të fshatit. Ato ditë bënë konferenca e mbledhje të ndryshme edhe Lefteri e shokët e tjerë. Më 27 tetor, erdhi në Sul Ibrahim, i cili na tha se organizatat e Rinisë Komuniste, po bënë një punë të madhe për sqarimin dhe mobilizimin e rinisë.

NJË «VULLNETAR»

Ditën e diel, më 31 tetor 1943, ishim në Dardhë. Në shtëpinë e Janit erdhi Bahriu. Ky na tha se në batalion është paraqitur një vullnetar nga Eçmeniku me emrin Demir. Në fillim Bahriu e kishte besuar, por më vonë i lindi dyshimi. Nga pyetjet që i bëri Bahriu, doli se Demiri ishte dërguar në batalion prej shtabit të Ballit Kombëtar, për të vrarë ndonjë nga anëtarët e shtabit. Bahriu desh ta ekzekutonte por vendosëm ta merrnim me vete në disa konferenca, ku ai të tregonte para popullit se ç'porosi i kishin dhënë bishat balliste.

Më 1 nëntor bëmë mbledhje me fshatarët e Bozhigradit, të cilëve ua paraqitëm «vullnetarin» e Ballit Kombëtar. Demiri foli para popullit për porositë që i kishin dhënë Mahmut Zëmlaku, Fuat Eçmeniku, Gani Zëmlaku, Demirsha Stropani e të tjerë. Nga fytyrat e fshatarëve që e dëgjonin me vëmendje dhe të atyre që ishin me Ballin dukej se u bënte përshtypje të madhe jo vetëm fakti që e shihnin Demirin midis partizanëve, por edhe detyra që i ishte ngarkuar. Më 2 nëntor u bë një mbledhje me popullin e Sulit. Edhe atje Demiri për detyrën që i kishin ngarkuar të vriste përgjegjësit e batalionit. Edhe fshatarëve të Sulit u bëri përshtypje të thellë sjellja e Demirit. Por nuk zgjati shumë ditë kur, duke u gdhirë 4 nëntor, në Sinicë Demiri iku nga baza e Palo Gutes, të cilit i ishte lënë nën përgjegjësi. Bahriu u inatos më shumë se të gjithë.

«Ta dija, — tha ai, — nuk do ta kisha pyetur fare... Kur s'e vrava laron në vend!.. Hë de! si-

kur komisari s'fliste dot vetë... por desh edhe ndihmës! E, .. le ta gjejë tashi!...»

SULMI MBI BALLISTËT

Poshtërsitë e Ballit s'po mbaroheshin. Shtabi i batalionit vendosi të sulmonte pa ndërprerje mbi ballistët. Forcat e batalionit u vunë në lëvizje për të ndjekur bandën e tyre.

Më 2 nëntor kapën një pionier që vinte nga Vërleri në Zicisht me një letër që na i dërgonte Zijai. Ja morën letrën dhe e lëshuan. Çeçua, përgjegjësi i njesitit në Vërleri, lajmëroi shtabin për ngjarjen. Dolëm drejt Vërlerit, për t'i ardhur në ndihmë kompanisë së Zijait, e cila mund të vihej në ndonjë rrezik. Në rrugën për në Vërleri, kapëm dy ballistë të bandës së Musa Kranjit nga Resnja, Azemin dhe Eminin. Më 4 nëntor Balli na dërgoi një letër me anën e së cilës kërkonte lirim të robërve. Letra ishte shkruar nga Ali Agushi dhe firmuar nga Musa Kranji. Pasi ju përgjegjëm se për robërit mendon shtabi i batalionit, tri kompani u nisën drejt Sulit, ku ishte vendosur Balli. Atë natë ata kishin ikur, por u kapën natën tjetër.

Më 5 nëntor, në orën gjashtë e gjysmë të mëngjezit, kur ne ishim në Zicisht, na lajmëruan se në Menkulas po zbrazeshin pushkë. U ngritëm dhe morëm drejtimin për në Sul. Morëm vesh se Balli Kombëtar ndodhej në Menkulas. Qëndruam dhe vendosëm rrethimin. Lajmëruam ardhjen e dy kompanive prej Çipani. Në orën tetë e gjysmë, grupe ballistësh dolën prej kodrave sipër Menkulasit dhe morën drejtimin për në Koshnicë. Disa prej nesh

vazhduan rrugën dhe u përqëndruan në kodrat sipër Sulit, ku kishte llogore të hapura nga italianët. Në orën nëntë mbërritëm afër Sulit, tek kompanitë që ndodheshin në Çipan. Së bashku me Zijanë morëm një kompani dhe u nisëm përpjetë, më të djathtë, për të rrethuar nga sipër Sulin dhe Koshnicën. Hamdiu qëndroi në Vreshtë, gati për sulm, përpara se të bëhej rrethimi. Bahriu me Llaqin shkuan për rrethim nga ana e Bozhigradit.

Në orën 9.45", kur kompanitë ecnin në drejtimet e caktuara, Bahriu goditi një grup ballistësh.

U ndez zjarri në të gjitha anët. Objektivi kryesor ishin kodrat ndën Koshnicë, ku kishin zënë vënd ballistët. Zijai mori mortajën dhe goditi kodrën nga e djathta. Ballistët u shpërngulën. Avancuam dhe dolëm në të majtë të Sulit. Llaqi e Bahriu dolën më të majtë të Koshnicës. Ndërkohë arriti edhe kompania e Hamdiut. Të gjitha forcat e batalionit, duke kaluar arave, sulmuan drejt Koshnicës. Afër fshatit sulmi u ngadalësua. Ballistët, të mbyllur nëpër shtëpi, qëllonin mbi partizanët. Forcat e batalionit bënë rrethimin e fshatit në 20-25 metra largësi. Në orën dy pasdreke një grup partizanësh me Baton e Bahriun, hynë në mëhallën e parë të fshatit. Zjarri i ballistëve sa vinte e dendësohej. Nga shtëpitë e tyre të larta, ata shihnin çdo lëvizje të partizanëve dhe qëllonin pa pushim, por partizanët nuk ndaleshin. Ata ecnin drejt shtëpive. Në këtë sulm të drejtpërdrejtë u plagos në krah Kroni Qyti, kurse mbas tij u plagos në qafë Myftar Progri. Të dy shokët i tërhoqën mënjanë. Para partizanëve dolën Bektash Dobranji, Hamdi Vërleni e Fiqiri Treni. Përparimi i tyre drejt shtëpive ishte i guximshëm. Tradhëtarët e popullit, si Gani Peqini, Musa

Kranji, Qamil Koshnica, e të tjerë shtinin pa pushim mbi partizanët. Gjatë këtij luftimi plumbi i armikut goditi për vdekje partizanët e vijës së parë Bektash Dobranjin e Fiqiri Trenin. Vrasja e shokëve e shtoi urrejtjen dhe zjarrin mbi armikun. Partizanët u hodhën në sulm, të vendosur për shpartallimin e plotë të armikut. Njëra pas tjetrës filluan t'i merrnin të gjitha shtëpitë ku ishin futur ballistët. Më në fund, në orën 5 pasdreke zjarri pushoi. Një grup ballistësh, që mbetën gjallë, mundën të tërhiqeshin nga krahu i sipërm i Koshnicës. Nga çeta balliste mbetën 6 të vrarë, 7 robër, dhe disa të plagosur. Në orën gjashtë e gjysmë të mbrëmjes po largoheshim nga Koshnica. Nata ishte e errët. Rruga nuk ishte shumë e njohur për ne. Kaluam midis korijeve të dendura mbi Bozhigrad dhe mbërritëm natën në Sinicë.

Në këtë përpjekje morali i partizanëve ishte shumë i lartë. Ata sulmonin më këmbë, pa menduar për plumbat që u vinin përreth. Në këtë sulm u dalluan për qëndrueshmëri mitraljerët: Shabani e Rasimi. Ata përdornin pa pushim mitralozat e rëndë, megjithëqë goditeshin nga zjarri i tradhëtarëve.

Gjaku i Bektashit dhe i Fiqiriut e shtoi edhe më tepër urrejtjen e partizanëve në sulmin e fundit. Fiqiriu e Bektashi shquheshin në batalion. Bektashi e kaloi jetën e tij në fshat, duke u marrë me bujqësi. Hyri në çetë që në muajt e parë të formimit të saj. Ishte një nga ata partizanë që kanë marrë pjesë gati në të gjitha aksionet që kreu batalioni «Fuat Babani». Ai ka qenë gjithnjë i vendosur e i disiplinuar dhe i bindur ndaj urdhërave dhe përgjegjësve. Bektashi e simpatizonte Partinë dhe bënte pjesë në grupin edukativ. Duke rënë dëshmorë ai tregoi edhe një herë se ishte i vendosur dhe i gat-

shëm për të dhënë edhe jetën për lirinë e popullit. Edhe Fiqiriu luftoi me trimëri. Ai lindi në Tren. Hyri në radhët e batalionit që në aksionin e Gollomboçit. Ishte i ri, i vendosur dhe i dashur me shokët. Ra dëshmor nga plumbat e armikut.

NË NDIHMË TË RRËZËS

Më 9 nëntor 1943, korrierët që ishin nisur për në Voskopojë, u kthyen. Në Polenë kishin filluar luftimet midis partizanëve dhe gjermanëve. Më 10 nëntor shtabi i qarkut kërkonte një kompani për ndihmë. Pasi e studjuam problemin në mbledhjen e shtabit dhe të byrosë, me 11 nëntor në mbrëmje një kompani, me Llaqin e Bahriun, u nis për Boboshticë. Po atë natë ajo doli në Dërsnik.

Më 15 nëntor një kompani e batalionit «Hakmarrje», mbërriti në Dardhë. Për t'u takuar me të u nis nga Ziçishti për në Dardhë një kompani me Hamdiun, Baton e Lefterin. Pjesa tjetër e batalionit shkoi në Vërlen. Në Ziçisht i thirrëm në gjyq disa kontrabandistë të kufirit, dhe ua sekuestruam një pjesë të plaçkave, me të cilat ata bënë kontrabandë kundër rregullave që ishin vendosur mbi kalimin e kufirit.

KESHILLAT NACIONALÇLIRIMTARE TË KOMUNAVE

Sipas udhëzimeve që kishim marrë, me 12 nëntor filluam punën për zgjedhjen e këshillave nacionalçlirimtare të komunave. Lefteri me Hamdiun ka-

luan në Komunën e Bozhigradit. Me pjesën tjetër të batalionit kaluam nga Ziçishti në Vërle. Si në Ziçisht ashtu edhe në Vërle zhvilluam konferencat me popullin për zgjedhjen e delegatëve, për në këshillat nacionalçlirimtare të komunave. Nga Vërle kaluam në Hoçisht, Gracë dhe më 18 nëntor në mbrëmje kaluam urën e Devollit (ura e Hoçishtit) dhe mbërritëm në Tren. Të nesërmen, në shkollën e fshatit bëmë një konferencë të gjatë me partizanët. Atje folëm për situatën dhe kritikua gabimet e të metat. Pastaj nga Treni kaluam në Rakickë, ku u mbledhën të gjitha këshillat nacionalçlirimtare të komunës së Progrit. Mbledhjen e filluam me 20 nëntor në orën 3.30". Çdo këshillë fshati zgjodhi delegatin për në këshillat nacionalçlirimtare të komunës. Në mbrëmje bëmë konferencën me popullin e Rakickës. Më 21 nëntor në Rakickë u bë mbledhja e aktivitetit të rinisë antifashiste të fshatrave të komunës së Progrit. Më 24 nëntor në mbrëmje u kthyem në Hoçisht.

Atje morëm vesh se në Korçë kishte pasur shtetrrethim. Agjenti gjerman Lefter Ruço ishte vrarë në mes të pazarit. Shoku ynë «S», që ndiqte Lefter Ruçon, ishte efektiv i batalionit. Shoku ynë kishte hyrë në një dyqan. Pastaj kishte hyrë edhe Lefteri, i cili i kishte kërkuar atij letërnjoftimin. Por në vend që t'i jepte letërnjoftimin Lefterit, shoku ynë «S» kishte nxjerrë nga gjoksi dhjetëshen turke dhe e kishte qëlluar për vdekje. Ishte bërë alarm. Një turmë e madhe ishte grumbulluar tek dyqani. Partizani ynë kishte hyrë në turmë dhe kishte humbur gjurmët. Kështu ai kreu me guxim dhe me sukses detyrën që i kishte ngarkuar populli e partia.

PREGATITJE PËR FESTË

«28 Nëntori të festohet me konferenca në popull, të cilat do të jenë grusht për armikun!» Kështu kishte bërë thirrje Komiteti Qendror i Partisë Komuniste dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Batalioni u nda në grupe. Lefteri, me një pjesë partizanësh, shkoi në Dardhë. Faiku dhe Hamdiu me disa të tjerë shkoi në Vërlen; disa shkuan në Tren e Rakickë, kurse një kompani me Zijanë u nis për në grykat e Kapshticës për të goditur gjermanët. Grupet partizane lëviznin për të kryer detyrat e caktuara. Më 26 nëntor, së bashku me Zijanë, kaluam në Bitinckë, kurse të nesërmen në Vërnik, ku morëm një letër nga Lefteri i cili na shkruante:

«Kemi zënë një spiun nga Boboshtica. Është ai që njoftonte për kalimin e partizanëve nga Boboshtica në Polenë dhe anasjelltas. I ka pranuar të gjitha ç'ka bërë. Gjyqi i kompanisë e dënoi me vdekje dhe e pushkatuam.

Më 28 nëntor në grykat e Kapshticës buçiti mitralozi partizan, i cili goditi një autokolonë gjermane. Kompania u tërhoq pa asnjë humbje, duke vrarë mjaft armiq. Mbas këtij aksioni ajo duhej të përqëndrohej në Rakickë. Dhe kështu u bë.

Mbas festës batalioni vazhdoi lëvizjen Vërlen-Ziçisht-Trestenik-Kurilë-Vishocicë e në fshatra të tjera. Kudo u zhvilluan mbledhje dhe konferenca. Në Ziçisht me 2 dhjetor bëmë mbledhjen e celulës së kompanisë III me Lefterin. Në këtë mbledhje u pranuan anëtarë partie 3 partizanë, të cilët ishin dalluar në luftë për trimëri dhe besnikëri.

Ato ditë shumë fshatra i dhuruan batalionit sa-

sira të mëdha ushqimi, drithë, fasule e të tjera, të cilat i grumbulluam në depot e batalionit në Dardhë dhe Bradvicë.

Për luftimet e batalionit flitej në çdo fshat. Ato përhapeshin me shpejtësi dhe gëzonin zemrat e popullit. Sotir Andoni i kishte marrë të gjitha masat. Së bashku me Mihallaq Kondën ai kishte siguruar radio, shaptilograf, maqinë shkrimi dhe letër. Më 1 dhjetor 1943, simbas shënimeve, Sotiri nxori komunikatën e parë përmbledhëse mbi luftimet e batalionit. Edhe lajmet në frontin sovjetik ai na i jep-te çdo ditë. Teknikën e batalionit e kishte instaluar në Sinicë.

LUFTË NË GORË

Më 7 dhjetor po pushonim në Vidëhövë. Atje na erdhi një letër nga shtabi i qarkut, i cili urdhëronte që një kompani tjetër e batalionit të nisej për në Gorë, mbasi atje po zhvilloheshin luftime të ashpra me ballistët dhe gjermanët.

Pasi e shqyrtuam çështjen në shtab, vendosëm që një kompani të mbetej në Devoll me Hamdiun, kurse tjetra të nisej menjëherë për në Gorë.

Kështu me 8 dhjetor 1943 së bashku me Zijanë dhe kompaninë u nisëm nga Vidëhova. Drekën e hëngrëm në Qytezë, kurse darkën në Dardhë. Udhëtuam tërë natën pa ndërprerje, dhe në orën pesë të mëngjezit të ditës së nesërme arritëm në Lavdar. Nga Voskopoja na lajmëruan që të shkonim drejt Dolanit.

Në Gjonomadh takuam kompaninë që e udhëhiqnin Llaqi dhe Bahriu, të cilët kishin marrë urdhër të ktheheshin në Devoll.

Pushuam pak në Shipckë dhe vazhduam rrugën. Kompania jonë u nda në dy pjesë. Në një pjesë ishte Zijai me Nuriun kurse pjesa tjetër me 35 partizanë shkuan me Teki Kolanecin. Në mëngjezin e datës 10 ne mbërritëm në Tresovë, kurse Zijaj me Nurinë në Senisht. Ndërkohë ballistët ishin hedhur përtej lumit.

Gryka e Lozhanit nuk dukej nga tufani. Shtëllungat e dëborës valëviteshin në hapësirë. Era fishkëllonte e tërbuar.

Tekiu rrinte mbështetur mbas murit, afër dritares, dhe vështronte i mërzhitur natyrën e egërsuar. Ai mundohej të shihte tej Lozhanit, tej Devollit, nga Babieni, nga Mokra, por nuk dallonte dot gjë.

Ai ecte nëpër dhomë kokulur, duke mbajtur një dorë në xhepin e qillotave dhe tjetrën në mjekër. Kështu ai e përshkoi me dhjetëra herë distancën midis dy mureve, sikur në këtë mënyrë do ta zgjidhte hallin që kishte. Kur hymë në dhomë, ai na pyeti menjëherë:

— E, a ka shumë ujë? — dhe pastaj shtoi: — Devollin duhet ta kalojmë edhe ne, edhe korrierët. Duhet të bëjmë ndërlidhjen edhe me forcat e Mokrës. Ky është urdhëri i Shtabit të Përgjithshëm. Korrierët tanë duhet të shpien edhe postën e Shtabit të Përgjithshëm në zonën e Shëngjergjit.

I thamë se ballistët ishin tërhequr krejtësisht përtej Devollit dhe se lumi ishte mbushur buzë buzë nga shiu dhe bora. Në disa vende ujët kishin dalë edhe mbi xhade, por ai i kishte parashikuar të gjitha.

— Pisk e kemi, — tha Tekiu, — por do ta kalojmë. Ne duhet ta marrim urën e drurit përfund

Babjenit. Duhet parë puna e korrierëve, sepse ata e kanë më vështirë. Pas pak Tekiu tha përsëri:

— Mendoj, që ata ta kalojnë Devollin së bashku me ne. Porsa të kalojmë lumin, ne do të ndeshemi me ballistët, dhe kështu në atë rrëmujë ata do të mund të ndahen nga kompania dhe të ikin në drejtimin e Mokrës.

Plani i Tekiut u diskutua dhe një herë dhe mendimi i tij u pa i drejtë. Rrugë tjetër nuk kishite. Pas pak në dhomë hynë 5 partizanë, që ishin lajmëruar më parë nga Tekiu.

Të gjithë u ulën këmbëkryq. Tekiu nxori nga çanta një letër të trashë dhe e shpalosi mbi rrogaz. Ishte harta e Shqipërisë. Sytë e Tekiut lëviznin me shpejtësi duke ndjekur gishtin që u ngul së pari atje ku shkruhej Lozhan dhe që mandej filloi të lëvizte mbi vijat e zeza, mbi pullat bojë kafe, mbi vijat blu, gjersa arriti në vendin ku shkruhej Shëngjergj. Tekiu ua tregoi korrierëve rrugën që duhej të ndiqnin dhe i porositi të ishin të kujdesshëm.

— Detyra është sa e rëndësishme, aq edhe e rrezikshme, — përfundoi Tekiu.

— Ne do ta kryejmë, shoku komandant, — u përgjegjen partizanët.

Në agimin e 11 dhjetorit kompania jonë sulmoi përtej lumit të Devollit dhe qe gati të kapte majën e Babjenit, por u diktua nga ballistët që ndodheshin në fshat. U hap zjarr. Nga ana e djathtë e Babjenit erdhën fuqi të tjera balliste dhe e zgjeruan goditjen. Por s'kaloi shumë kohë dhe ata filluan të tërhiqen me shpejtësi. Teki Kolaneci me forcat e tija u doli përballë. Ballistët ndërruan drejtim dhe u tërhoqën nga Bubuq-Zboqi. Në orën dymbëdhjetë të drekës zjarri pothuajse pushoi. U zbraz vetëm

një pushkë. Kur po hynim në fshat, disa fshatarë na thanë:

«Kini kujdes se në fshat janë fshehur 10-12 ballistë, të cilët mund t'ju godasin papritur.»

Në orën katër e gjysmë pasdite një grup partizanësh, me në krye Azemin, ju afruan shtëpisë ku ishin ballistët dhe hapën zgjarr me bomba dore. Ballistët dolën përjashta. Partizanët që ishin nga ana e sipërme ju afruan më shumë shtëpisë. Ballistët nxorën mitralozat në portën e shtëpisë dhe hapën zjarr të pandërprerë. Zijaj me një grup shokësh u sul përsëri mbi Babjen. U err. Ballistët u tërhoqën. Hymë në fshat dhe shkuam drejt shtëpisë ku ballistët bënë qendresën e fundit. Atje gjetëm një mortajë, një mitraloz të rëndë dhe dy kuaj. Mortaja kishte 10 predha. I morëm të gjitha dhe shkuam në lartësitë e Marjanit, prej nga dukej zjarri i ballistëve që kishin qëndruar në majat e Kozelit. Provuam mortajen e rëndë, duke zbrazur 3 predha në drejtim të ballistëve. Me të dëgjuar mortajën, ballistët u shpërndanë nga mundën. Në kodrat e Marjanit, pranë zjarreve kaluam gjithë natën. Fshatarët e Babjenit na sollën ushqime.

Të nesërmen në drekë batalioni filloi të lëvizte. Përpara shkoi Tekiu me batalionin «Gorë-Opar». Në kodrat më të majtë të Grypecit ai ndeshet me një forcë ballistësh e gjermanësh që kishin ardhur nga Mokra. Guri me Veshë ndodhej në duart e gjermanëve. Në orën dy pasdreke erdhi shtabi i veprimeve të përbashkëta partizane. Dy skuadra të kompanisë sonë bashkohen me Tekiun, kurse pjesa tjetër qëllonjë me mortajën e rëndë nga ana e poshtëme. Në orën 4 pasdreke ne zemë Gurin e Bletës, kurse skuadrat që ishin me Tekiun zënë Gurin me

Veshë. Në orën 5 grupi i Zijajt, që ishte nga ana e poshtëme, u ngjit në majat e Kozelit. Ballistët u tërhoqën. Shtabi i veprimeve shkoi në Grybec. Morali i partizanëve ishte shumë i mirë.

Afër drekës të 13 dhjetorit forcat e Agush Gjergjeviçës arritën në Gurin e Kamjes. Shtabi i veprimeve u vendos në Osnat. Kompania jonë qëndroi në Kozel dhe atje e kaloi natën.

Në orën 7 të mëngjezit të 14 dhjetorit, u dëgjua mitralozi në drejtim të Kamjes. Mblodhëm forcat me Zijanë dhe u larguam nga Kozeli. Afrohemi në naltësitë afër Prenishtit.

Biseduam me shtabin. Në orën 11 kompania jonë arriti te Guri i Kamjes. Ndërkohë forcat gjermano-balliste po sulmonin dhe gati po dilnin në qafë. E gjithë kompania hapi zjarr. U vunë në përdorim mortaja dhe mitralozi i rëndë. Rreziku u largua. Në Kamje ishte vendosur batalioni «Reshit Çollaku». Në orën një pasdreke në forcat tona erdhi Teki Kolaneci. Ai na tha të sulmonim brenda pyllit. Lajmëruam krahun e djathtë, ku ishte Spiro Shalësi, dhe krahun e majtë, ku ishte Xhaferr Lubonja, që në të njejtën kohë të sulmonin edhe ata. Kështu, në orën dy pas dreke, shpërtheu sulmi gjatë gjithë vijës ku ishin përqëndruar forcat partizane. E gjithë kompania jonë u hodh në sulm në pyllin mbi Beragozhd. Trupat e aheve të mëdhenj ishin deri diku një mbrojtje kundër plumbave të armikut. Zbritja po bëhej me shpejtësi drejt Beragozhdit, por s'kaloi shumë kohë dhe filloi të ngadalësohej. Nga shkëmbinjtë përballë vinin pa ndërprerje plumbat e mitralozëve të armikut. Nga grupi ynë në fillim u vra partizani i ri Hamdi Vërleri, që ishte në radhën e parë të sulmonjësve. Zbritja jonë vazhdonte. Duke

u mbrojtur prapa trunqeve të ahut, dolëm në një vend me drurë të rrallë. Por armiku dëndësoi zjarrin. Në breshërinë e plumbave u vranë partizanët Nafis Sherifi nga Vërteni dhe Selami Qazimi nga Bitincka. Të ecej më përpara nuk kishte mundësi, sepse armiku, që ishte vendosur prapa shkëmbinjve mbi Beragozhd, kontrollonte çdo lëvizje.

Vendosëm të tërhiqeshim në pozicionet e para buzë Gurit të Kamjes. Por edhe kjo nuk ishte e lehtë. Armiku shtinte vazhdimisht. Si pasojë, gjatë tërheqjes dhe ngritjes së shokëve të vrarë, kompania jonë pësoi humbje të tjera. U plagosën 6 shokë, ndër të cilët Teki Kolaneci, Taqo Pali nga Treni, Sero Beqiri, Fahri Shabani, Xhemil Hoxha dhe Minella Dinushi. Tekiu mori një plagë të fortë në thembrën e këmbës, Taqo Treni u plagos në gju, prej nga i rridhte gjak vazhdimisht, kurse Pali vdiq. Edhe nga batalionet e tjera pati humbje të disa shokëve. Nga batalioni «Shqiponja» u plagos partizani Xhume dhe nga batalioni «Gorë-Opar» u vra partizani Elez.

Në orën tre e gjysmë mbasdite shokët e vrarë dhe të plagosur i grumbulluam në një lëndinë afër Gurit të Kamjes. Ishte një skenë mjaft ngjethëse: të vrarët ishin shtrirë në një anë... të plagosurit kishin dhimbje të forta.

U ndamë nga shokët. Vija frontale duhej mbajtur. Armikut duhej t'i pritej hovi, nëse do të guxonte të sulmonte. Si komandant i sektorit të Kamjes, në vend të Tekiut, u caktua Zijai.

Në orën katër e gjysmë të gjithë partizanët u vendosën në pozicionet e mëngjezit. Natë. Bënte ftohtë. Binte shi i përzier me dëborë. Ushqimi mungonte. Ne rrinim pranë zjarrit dhe s'ankoheshim.

Pozitat gjatë Gurit të Kamjes i mbajtëm plotësisht:

Në orën 7 të mëngjezit të datës 15 dhjetor 1943 u takuam në shtabin e veprimeve. Na urdhëruan të ndërronim pozicionet. Duhej të tërhiqeshim nga sektori i Kamjes dhe të krijonim një vijë të re qëndrese. Në darkë arritëm në Osnat (një pjesë kaloi sipër Kamjes) prej nga shkuaam në Niçe. Ndërsa ne ishim në Niçe, gjermanët mbërritën në Kamje.

Në Niçe gjetëm një letër të shtabit, i cili na urdhëronte që në mbrëmje të kalonim në Qafë-Panjë.

U nisëm në orën katër pasdite. Udhëtuam deri në orën gjashtë dhe pastaj qëndruam në majat mbi Niçe. Ajo natë na mërzi, mbasi bënte shumë ftohtë. Në mes të pyllit, mbi dëborë, u ndezën zjarret, rreth të cilëve e kaluam gjithë natën.

Pa u gdhirë mirë, fshatarët e Krushovës, që e dinin se ne do të gdhieheshim mbi dëborë, na sollën me bollëk bukë, lakror, qepë, djathë.

Në mesditë Janaqi me Sabrinë u kthyen nga Mokra. Ata nuk u takuan me forcat e Teles, sepse ato ishin larguar...

Në orën dy e gjysmë u dëgjuan zbrazje pushkësh dhe mitralozash në drejtim të Moçanit. U nisëm menjëherë në atë drejtim, sepse mendonim që forca të batalioneve të tjera duhej të ishin ndeshur me gjermanët.

Porsa u nisëm, 7-8 predha mortaje të rëndë ranë në Qafën e Panjës, drejt së cilës po vinin gjermanët nga Llënga. Vazhduam rrugën dhe arritëm afër Krushovës. Nga Panja gjylet e mortajave binin në kodrat mbi Niçe. Pastaj arritëm në Selcë-Velçan. Pas pak predha mortajash ranë rreth e rrotull vendit ku ishim ne. Vazhduam rrugën dhe në orën dy pas

mesnate arritëm në Strelcë. Kompania jonë udhë-
tonte bashkë me batalionin «Gorë-Opar». Menjë-
herë u nisëm në drejtim të Lozhanit, duke kaluar
urën e Zvarishtit. Sa dolëm nga fshati u takuam
me dy korrierë që kishin ardhur nga shtabi. Me
t'u gdhirë hymë në fshat, ku ndodhej batalioni «To-
morri», i cili ruante ato kodra.

Më 17 dhjetor në Loxhan morëm vesh se mi-
tralozët që kërcitën më 16 dhjetor ishin në Moçan.
Qysh në mëngjezin e 16 dhjetorit, batalioni «Tomo-
rri» hyri atje bashkë me shtabin. Një fuqi gjermane,
që kishte qenë në Niçe, në kohën kur ne rrinim mbi
Niçe, rrethoi Moçanin nga ana e Zvarishtit. Bata-
lioni dhe shtabi u tërhoqën pa humbje. Ndërkaq
gjermanët dogjën Krosnishtin dhe Moçanin; në
Desmirë pushkatuan 12 persona.

Në mbrëmjen e 17 dhjetorit kompania jonë u
ngarkua të ruante urën e Zvarishtit.

Të nesërmen në mëngjez morëm drejtimin
për në Zvarisht. Në drekë na urdhëruan që kom-
pania jonë të merrte drejtimin për të ruajtur pozitat
mbi Kolanec-Damjanec. Në orën dy e gjysmë u
nisëm. Në orën shtatë arritëm në Gjyras, ku u
shpërndamë në baza.

Të nesërmen në orën pesë të mëngjezit dolëm
nga Gjyrasi dhe u vendosëm mbi majat Kolanec-
-Damjanec. Aty ishte përqëndruar një forcë e një-
siteve të fushës (35 veta) me Llambi Dishnicën dhe
Llazo Bulgarecin. Koha ishte e butë. Kishte diell.
Mbas shumë ditësh të ftohta, na u duk sikur ishim
në mes të verës.

Në mbrëmje zbritëm në Kolanec dhe u shpër-
ndamë në baza. Atje bëmë mbledhjen e kompanisë.

Mbas gjithë këtyre veprimeve kompania jonë me 22 dhjetor u vendos në Krushovë.

Gjatë luftimeve të Gorës, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare urdhëroi krijimin e Brigadës IV Sulmuese me partizanë të batalioneve të Korçës.

Më 25 dhjetor në Krushovë na komunikuan, që e gjithë kompania jonë të qëndronte në brigadën e re. Shokët e shtabit të qarkut të Korçës dhe të Komitetit qarkor të Partisë kërkuan nga ne 100 partizanë me Zijanë për komandant batalioni, Llaqin për komisar batalioni dhe mjaft shokë si Thimin, Shabanin e të tjerë.

Pasdreke përcollëm korrierët në Devoll për të lajmëruar mbërritjen e 25 partizanëve të kompanisë që do të mbetej në brigadë si dhe të Llaqit, të cilët gjatë luftimeve në Gorë ishin në Devoll.

Na erdhi shumë keq që u ndamë nga Zijai dhe gjithë shokët e tjerë që do të mbeteshin në Brigadën IV S.

U nisëm për në Voskopojë me Milton, Lefterin, Latifin, e Gjezin. Në mbrëmjen e ftohtë të 26 dhjetorit arritëm në Boboshticë. Atje u takuam me Llaqin e Kalon, të cilët, simbas lajmërimit që u bëmë me Zijanë vinin nga Devolli për Krushovë. Pasi u ndamë me mall dhe dashuri nga njëri-tjetri, ne shkuam në Dardhë, kurse ata në Voskopojë. Në Grapsht-Bradvicë u takuam me shokët e batalionit. Atë ditë edhe në Devoll ndodhën përleshje me armikun.

Në Sinicë ishte vrarë nga gjermanët partizani Paio Guta. Në Arrëzë forcat e batalionit ishin përpjekur me gjermanët. Partizanët Mihallaq Havalea dhe Bexhet Goce, që ishin roje, u përleshën të parët.

Ata rezistuan gjersa shokët dolën nga bazat. Por gjermanet, që kishin hyrë befasisht në Arrëzë, i goditën nga të gjitha anët. Mbas një qëndrimi të guximshëm që i bënë armikut, të dy këta shokë ranë dëshmorë.

NJË GODITJE PËR VITIN E RI

Në mëngjezin e 29 dhjetorit ishim në Gracë. Na lajmëruan se drejt Babanit ishte nisur një bandë ballistësh me Mahmut Zëmlakun.

Dolëm në formacion të zgjeruar dhe në orën tre e gjysmë pasdreke hymë në Baban, ku morëm vesh se në shtëpitë e Tefikut ishin 12 ballistë. Kur po bisedonim për të rrethuar shtëpitë dhe për të goditur bandën e Mahmutit, Hamdiu, që kishte hipur majë minares, diktoi një grup gjermanësh që vinin nga Bilishti.

Dolëm poshtë fshatit. Një grup ballistësh po çante drejt Babanit. Ndërkohë filloi goditja nga klishat. U ndez zjarri nga të gjitha anët. Partizanët dhe anëtarët e njësitit guerril u vendosën në pozicione luftimi. Në meratë e klisave, forcat gjermane u ndanë në dy pjesë: njëra ecte përpara, drejt Babanit, kurse tjetra mori rrugën e Stropanit për të dalë në anë të fshatit. Partizanët e kuptuan qëllimin e armikut. Duke luftuar u tërhoqëm brenda fshatit. Luftime zhvilloheshin në të gjitha lagjet. Ballistët e gjermanët u bashkuan. Në luftim e sipër u kap i gjallë Ali Koshnica, nipi i komandantit ballist Qamil Koshnica. Rreth orës 5 pasdreke dolëm drejt korijeve të Shehut dhe rrugës së Hoçishtit. Atje e shkëputëm kontaktin me armikun, që kishte

grumbulluar forca shumë të mëdha. Duke kaluar mbi Gracë dhe në mes Hoçishtit, forcat e batalionit u vendosën në Manastirin e Shëndëllisë.

Në kohën që u nisën forcat gjermano-balliste nga Bilishti për në Baban, një kolonë tjetër e tyre u nis drejt Hoçishtit. Armiku mendonte t'ja priste rrugën batalionit. Ai deshte ta godiste atë brenda në fshat ose në krye të tij. Por kur ata mbërritën në Hoçisht, partizanët ishin në Shëndëlli. Vetëm një grup shokësh qëndruan në Hoçisht për të mbledhur ushqimet për batalionin.

Gjermanët, që erdhën në Hoçisht, filluan të hynin nga njëra shtëpi në tjetrën. Më në fund shkuan te porta e Gavrilit. Duke e gjetur atë të hapur ata hynë në oborrin e shtëpisë dhe prej andej kaluan në oborrin e Ilos. Në katin e dytë të shtëpisë, në një dhomë plot dritë kishte njerëz.

Hamdiu dhe Nasi i vogël ndodheshin brenda. Ata po u tregonin hoçishtarëve për luftimet që ishin zhvilluar në Baban. Por gjatë këtij tregimi u bë një zhurmë e madhe, shtëpia u tund, xhamet u thyen. Gjermanët hodhën branda në dritare bomba dore dhe qëlluan pa ndërprerë me automatik. Nasi i Vogël u plagos në 3-4 vende. Hamdiu hipi në katin e sipërm dhe hodhi 2 bomba dore në oborr. U dëgjuan të thirrura të shumta. Në rrëmujën e tymit e të zjarrit, ai zbriti me shpejtësi në oborr dhe mori përpjetë fshatit. Një oficer dhe një ushtar gjerman mbetën të vrarë. Në manastirin e Shëndëllisë gjyqi i batalionit e dënoi me pushkatim ballistin Ali Koshnica.

Në përpjekjen që u bë në Hoçisht ra dëshmor partizani i ri Nasi i Vogël (Dino) nga Hoçishti. Ai vdiq mbas 4 orësh nga plagët e rënda.

Me këtë përpjekje e mbyllën partizanët e Devollit vitin 1943. Në darkë të vitit të ri, ata qenë mysafirë te dardharët, kurse në drekën e vitit të ri te sinicarët.

Nga Sinica kaluam në Qytezë, Vidëhovë, Ponçarë, Braçanj, Grapsht dhe në fshatra të tjera të Devollit. Fshatarët e Ponçarës dhanë si dhuratë për Batalionin 9 kv. drithë, të Vërlenit 4 kv. e gjysmë, të Trestenikut 29 kv., të Menkulasit 15 kv, kurse ata të Qytezës 5 kv. drithë dhe 11 napolona.

Më 7 janar 1944 në Vidëhovë bëmë mbledhjen e celulës së batalionit. Në atë mbledhje u vendos që shoku Ndreko Sinica të caktohej si komisar kompanie. Më 8 janar 1944, në Qytezë, Lefteri bëri mbledhjen e celulës së kompanisë, ku u shqyrtua gjendja e kompanisë dhe detyrat për vitin e ri. Më 10 janar 1944, në Dardhë gjyqi i batalionit vendosi pushkatimin e agjentit fashist, toger Thanasit. Vendimi i gjyqit u zbatua menjëherë.

Në mbrëmjen e 29 dhjetorit, mbas largimit të partizanëve, edhe ballistët, edhe gjermanët u larguan nga Babani e shkuan drejt Stropanit dhe Bilishtit. Errësira e mbrëmjes filloi të mbulonte rrugët, njerëzit, shtëpitë. Në atë kohë vetëm Vaska rrinte te zalli i lumit e shtrëngonte dhëmbët. Ai nuk i arriu shokët e batalionit. Kur u ndez lufta qëndroi prapa avllisë së një shtëpie, prej nga godiste armiqtë që i zinte syri. U largua nga pozicioni vetëm kur lufta pushoi gati krejtësisht. Herë më këmbë, herë ulur kaloi bahçet, dhe arriti lumin. Kur po ngjitte ledhin për të hyrë në koriqe, një plumb e shpoi në kupën e gjurit. Ra përsëri në lumë. Mendoj se e kishin diktuar dhe priti barakas një copë herë me pushkën gati, por asnjë e

shtënë tjetër nuk erdhi drejt tij, asnjë zhurmë nuk ndihej. Errësira mbuloi gjithshka. Dhimbja e shtrëngoi. U ngrit ngadalë, por sa e mbështeti këmbën në tokë u rrëzua përsëri. Provoi edhe një herë të ngrihej, por përsëri i ndodhi e njëjta gjë. E kuptoi se nuk mund të ecte më këmbë dhe vendosi të zvarritej. Eci barkas 3-4 metra dhe u ndal.

«Ku do të shkoj? Shokët s'kam si t'i arrij» — tha me vete dhe ndaloi në vend. Vaska nuk i njih-te mirë rrugët. Nuk njih-te njeri! Por edhe sikur të njih-te s'kishte se si të takohej me ta, sidomos atë natë kur në çdo shtëpi mund të kishin hyrë ballistët. (Ai nuk e dinte se ata kishin ikur).

Nëpër shtëpitë filluan të ndriçonin llambat, kandilat, por Vaskës i dukeshin ato shumë të largëta. Ndërkohë, në një shtëpi në anë të fshatit pa një dritë të vogël. Ju duk sikur ajo shtëpi ishte më afër dhe më e veçuar nga të tjerat dhe filloi të zvarritej drejt saj. Ju afrua deriçkës që ishte nga ana e bahçes dhe qëndroi.

Dhimbjet po i bëheshin më të forta. Kupa e gjurit filloi t'i shpönte gjithnjë e më shumë. E ftohta po i hynte në palcë...

Vendosi të trokiste në derë duke shpresuar se atje s'do të kishte armiq, po përsëri u ndal.

«Po sikur të ketë ballistë?» mendoi me vete dhe të rrëngethura i kaluan nëpër trup.

«Populli është me ne, me partizanët.» shtoi me vete dhe ky mendim i dha kurajo. Trokiti në deriçkë dhe me gjakftohtësi po priste përgjegjen.

— Kush je? — pyeti një grua që nga brenda oborrit.

— Ju lutem, më ndihmoni, — tha Vaska me gjysëm zëri.

Deriçka u hap pa zhurmë. Gruaja doli në errë-sirë, pa Vaskën të shtrirë, u ndal dhe pyeti kush ishte.

— Një i plagosur, — ju përgjegj Vaska dhe, duke marrë kurajo që ajo ishte nënë, shtoi: jam një partizan!

Gruaja u përkul mbi Vaskën, e ndihmoi të ngrihej dhe e futi në oborr... në shtëpi.

Kjo grua ishte nënë Xheka, e cila e ngrohu, e mjekoi Vaskën. Ajo lajmëroi që atë natë shokët e njësitit të fshatit. Ata shkuan menjëherë në shtëpinë e plakës. Mbas 2 ditësh Vaskën e shpunë në infermierinë e batalionit, ku ai tregoi se si shpëtoi atë natë.

SHOKË TË PLAGOSUR

Që në ditët e para të janarit, në Gorë dhe Kolonjë gjëmonte pa pushim artileria gjermane. Partizanë të krahinave të ndryshme që erdhën në Devoll na thanë se andej kishte filluar një operacion i gjerë nga gjermanët.

Më 19 janar në Vidëhrovë erdhën 5 partizanë të sëmurë e të plagosur: Hyseni, Enveri, Lilua, Xhevdeti dhe Reshati, që kishin marrë pjesë në luftimet e Gorës. Ata na spjeguan se forcat partizane të sektorit të Voskopojës kishin manovruar drejt Skraparit, për t'u bashkuar me forcat e çarkut të Beratit. Armiku u nis me forca të mëdha në të gjitha drejtimet për të rrethuar forcat tona. Luftimet u bënë shumë të ashpra.

Në mëngjez të 20 janarit, u nisëm për në Kalevisht. Nuk shkuam po atë ditë në Llëngë, sepse partizanët e sëmurë kishin mjaft dhimbje në këmbë.

Në mëngjezin e 21 janarit, me kafshët që kishim marrë në Vidëhovë, u nisëm me të sëmuret nga Kalevishti për në Llëngë të Greqisë, ku kishte spitale partizane. Rruga ishte shumë e keqe. Shokët ranë disa herë nga mushkat dhe lënduan këmbët e ënjtura. Në mbrëmje arritëm në Llëng, I shtruan shokët në spital, doktori na mjekoi këmbët.

Që në mëngjez të 22 janarit shkuaam në spital. Partizanëve që sollëm ua kishin zgjidhur këmbët, prej të cilave rridhte gjak e qelb. Nga gishtat e tyre dhe nga pllazi i këmbëve u vareshin copra lëkure. Gjashtë ditë e gjashtë net kishin luftuar këta shokë nëpër majat e maleve të mbuluara me dëborë dhe u kishin rezistuar me vendosmëri sulmeve gjermane.

Mbasdreke mjeku vendosi të dërgonte në spitalin e Pendallofos Enverin, Hysenin dhe Xhevdetin për të operuar gishtërinjtë e këmbëve. Këtë operacion nuk e bënë dot mjekët e Llëngës. Në mbrëmje, u takuam me shefin politik të një regjimenti, me të cilin diskutuam për situatën e Luftës në Shqipëri e në Greqi. Ai gëzohej për sukseset tona.

Që në mëngjez të 23 janarit shkuaam në spital. Shokët kishin mjaft dhimbje. Në orën 11, me 5 partizanë grekë, me mushka, të 3 shokët i nisëm për Pendallofo. Bashkë me ta shkuan edhe 2 partizanë të batalionit.

Më 22 janar Faiku na lajmëroi me telefonin e partizanëve grekë se batalioni kishte mbërritur në Janoven.

Mitua lajmëroi me telefon nga Janoveni se kishin ardhur 50 pallto nga Korça, kurse buka kishte ardhur prej Dardhe, e Qyteze. Në mbrëmje Mitua

na lajmëroi se kishte marrë një letër nga Zijai prej Vithkuqi.

Në mëngjez të 25 janarit u nisëm nga Llënga për në Devoll.

Gjatë gjithë këtij udhëtimi nëpër luginat dhe përrenjtë e thellë e nëpër të futurat e shkëmbinjve, nuk shihje gjë tjetër veçse tym! Populli grek, i dëgjur nga fashistët, kishte ngritur banesa nëpër guvat e shkëmbinjve.

PERSËRI ME BALLISTËT E GJERMANËT

Në mëngjez të 29 janarit bëmë mbledhjen e këshillit nacionalçlirimtar të Qytezës. Pasdreke bëmë mbledhjen e byrosë, ku vendosëm të kryenim aksione të reja. Na informuan se ballistët kishin shpërgulur nga Babani në Bilisht disa familje partizane, të cilat i mbanin mbyllur në një shtëpi me roje balliste dhe ushtronin presion mbi to.

Në mbrëmje morëm vesh se Balli Kombëtar ndodhej në Vidohovë. Lajmëruam partizanët të dilnin nga Dardha dhe ua komunikuam vendimin për sulm. Partizanët e pritën me entuziazëm këtë vendim. Kur zbritëm në Sinicë morëm vesh se Balli Kombëtar kishte ikur. Vendosëm të qëndronim në Qytezë. Në orën katër pasdite u shpërndamë nëpër baza.

Në mbrëmje të 30 janarit morëm vesh se në Ponçarë ndodhej një çetë balliste. Vendosëm ta rrethojmë atë fshat. Prej Qyteze dolëm në mesnatë. Në mëngjezin e 31 janarit, batalioni u gjend mbi kodrat që dominojnë mbi Ponçarë e Menkulas. Ndarja e forcave tona në këto pozicione u bë mjaft

e rregullt. Me të bërë rrjeshtimin takuam në kufi një fshatar prej Ponçare. i cili na tha se Gani Zëmlaku me 100 veta ndodhej në Ponçarë, kurse Xhemali Arrëza me 40-50 veta (ballistë) ndodhej në Menkulas. Ballistë kishte edhe në Braçanj e Trestenik.

Disa nga kodrinat që kishim zënë ne, kishin edhe llogore të hapura që në kohën e luftës italo-greke.

Në orën 9 të mëngjezit, krahu i mezit ndërmjet Ponçares dhe Braçanjit goditi një grup prej 10 ballistesh që po dilnin prej Braçanji në drejtim të Ponçarës. Ballistët e Ponçarës nuk u përgjegjën fare. Vetëm 3-4 pushkë gjuanin nga dritaret.

Me të filluar zjarri në Ponçarë, ballistët e Menkulasit dolën të godisnin në pozitat tona, por zjarri që u drejtua kundër tyre i detyroi të futeshin shpejt nëpër shtëpitë. Në orën 10 forca të tjera ballistësh zbritën nga Suli në drejtim të Menkulasit, por u goditën nga partizanët dhe u kthyen nga kishin ardhur. Zjarri i mitralozëve dhe pushkëve tona ishte shumë i dendur. Grupi ballist që doli nga Braçanji u shpartallua dhe mori drejtimin për Trestenik, duke lënë 3 të vrarë. Në orën 11, partizanët që ishin buzë lumit lëvizën nga krahu i kufirit. Kështu, gjatë kufirit, u krijua vija frontale e batalionit. Ballistët që ishin nëpër fshatrat e tjera nuk bënë asnjë përpjekje për të sulmuar apo për të ndihmuar të rrethuarit. Edhe ballistët e rrethuar në Ponçarë nuk bënë asnjë përpjekje për të dalë jashtë. Ata e ndjenin veten më të sigurt brenda shtëpive. Ponçara është brenda një përroi. Çdo zbritje nga kodrat diktohet nga dritaret e shtëpive. Zjarri i pushkëve tona me urdhër u rra-

llua, mbasi përveç dritareve të shtëpive nuk kishte objektiv tjetër për të qëlluar.

Në mbrëmje u larguam për darkë në Vidohovë.

Në atë përpjekje, nga Balli Kombëtar pati 4 të vrarë dhe disa të plagosur, kurse nga ne asnjë humbje.

Morali i partizanëve dhe i popullit u ngrit. Goditja u zgjerua.

Qëndresa e partizanëve ishte mjaft e mirë. Ndonëse ishin pa gjumë, të lodhur, ata këndonin pa pushim edhe gjatë kohës që mbanin të rrethuar larot ballistë. Një pjesë prej tyre tregoheshin mjaft të etshëm për të sulmuar me bomba dore. Porsa filloi përpjekja, njësi i Menkulasit, i përbërë prej 12-13 vetash, që ndodheshin në Revan, erdhën menjëherë në ndihmë të batalionit. Erdhën gjithashtu në ndihmë Batua, Kasua dhe Kristua, që ishin në Shag. Në mëngjezin e 1 shkurtit dolëm nga Vidëhova.

Një autokolonë gjermane mbërriti në Shënkollas.

U vendosëm në Vijën e kufirit prej Halevice deri mbi Qytezë, me qëllim që ta godisnim armikun, po që se do të ngjitej në këto fshatra. Në këtë kohë Xhemaliu me ballistët e tij doli prej Menkulasit e hyri në Bozhigrad. 13 maqina gjermane ndaluan në Shënkollas. Pjesa më e madhe e ushtarëve hyri në Ponçarë. Ajo nxori Gani Zemblakun nga rrethimi i ditës së parë. Mbas këtij veprimi forcat gjermane u kthyen në Bilisht dhe Gani Zemblaku hyri me lehtësi në Menkulas.

Në mbrëmje batalioni u vendos në Qytezë.

Populli i Qytezës, Sinicës dhe Dardhës ishte mjaft i entuziazmuar për goditjen që i qe dhënë Ballit Kombëtar. Në mëngjez të 3 shkurtit bëmë mbledhjen e celulës në kompaninë e Hamdiut. Atje punuam broshurën «Fshatarësisë së varfër» të Leninit.

Mbasdreken e 3 shkurtit bëmë në Dardhë mbledhjen e shtabit, ku vendosëm të godisnim pa ndërprerje bandat balliste.

Në mëngjez të 4 shkurtit (ora 2) Guçja me dy skuadra partizanësh shkoi në Bigël të Drenovës, ku vinin me pushkë dvoranaket, qatromaret, disa nga të cilët flisnin keq për Luftën nacionalçlirimtare. Afër orës 10 Guçja i mblodhi bashkarisht fshatarët që kishin ardhur për dru. Ai u foli atyre për rrugën e gabuar që kishin ndjekur një pjesë prej tyre dhe për luftën e drejtë të partizanëve. Mjaft prej tyre e ndjenë veten të turpëruar.

Në orën 6 të mëngjezit të 6 shkurtit, Hamdiu e Lefteri me skuadrat e tyre hynë në Baban, ku morën informata se Balli Kombëtar kishte ikur. Atje vendosën të çarmatosnin ballistët me në krye Barriqin, që ishte kryetar i Ballit Kombëtar në atë fshat. Kur ju afruan portës së shtëpisë, ai i priti me pushkë.

Në orën 9 të mëngjezit të 6 shkurtit, batalioni mori rrugën për në Vërlen. Ndërkohë Xhemaliu me 50 ballistë po dilte nga Çipani me drejtim Pilur-Vranisht. U lajmërua Hamdiu në Hoçisht që të merrte shokët dhe të dilte në qershizat e Gracës. Ndonëse ishte larg, Hamdiu e goditi Xhemaliun kur kalonte llofkat. Ballistët, të trembur, filluan të vraponin nëpër ara. Ata e ndalën vrapin në Cangonj, ku takuan «trimin me fletë» Gani Zëmlaku, i cili

4 ditë më parë kishte pësuar të njëjtin fat. Në mbrëmje Hamdiu e Lefteri erdhën në Vërlen, ku e kaluam natën së bashku.

Në orën tetë të mëngjezit të 10 shkurtit, Bahriu me 6-7 shokë doli nga Braçanji për Menkulas. 60-70 ballistë dhe gjermanë ishin nisur nga Bilishti për në Sul (e diktuan Bahriun dhe shokët, i goditën por s'u bënë gjë, sepse këta kishin zënë pozita luftimi). Me të dëgjuar të shtënat, partizanët që ishin në Braçanj dolën menjëherë. Kështu armiku u godit me shpejtësi dhe u vu përpara deri afër Sulit. Disa bozhigradas dolën në ndihmë të Ballit Kombëtar, por batalioni i vuri përpara edhe këta. Ballistët zunë kodrat e Sulit dhe shtinin në hava.

Më 12 shkurt në Dardhë bëmë mbledhjen e celulës, kurse më 16 atë të shtabit. Lefteri bëri mbledhjen edhe të një celule të kompanisë. Në atë mbledhje u vendos që më 19 shkurt batalioni të kalonte Sinicën, Arrëzën dhe të gjykonte kryeplakun e Arrëzës, i cili kishte ndihmuar gjermanët në luftimet kundër partizanëve.

Në Sinicë, me 18 shkurt bëmë një mbledhje të të gjithë batalionit, ku folëm për situatën e brendshme. Atje u tha: «Operacioni armik i dimrit dështoi. Forcat partizane i dhanë armikut kundërgoditje të forta. Armiku e zgjeroi terrorin. Në Tiranë bëri një masakër të madhe më 4 shkurt. Nëpër fshatrat ai dogji e pushkatoi, por populli nuk u tremb. Radhët e Ushtrisë Nacional-çlirimtare zgjerohen. Shtabi i Përgjithshëm drejton forcat partizane në veprime të kombinuara».

Me anën e teknikës Sotiri kishte mbledhur lajme të shumta për frontin sovjetik.

Ushtria sovjetike që në mez të janarit shpërtheu

ofensivën e madhe në frontin e Leningradit e të Novgorodit. Komunikatat sovjetike njoftonin për shpartallimin e gjermanëve në këto fronte.

Më 19 shkurt në Sinicë bëmë mbledhjen e cë lulës së kompanisë II. Punuam kapitullin «Partia» të broshurës, «Bazat e leninizmit» të Stalinit. Në mbledhje merrnin pjesë: Lefteri, Loni, Kurti, Meleku dhe Hamdiu.

Më 21 shkurt u vendosëm në Dardhë. Shtabi i qarkut na urdhëroi të nisnim 25 partizanë për në Brigadën VII sulmuese, që do të formohej në rrethin e Beratit. Po atë ditë kompania që ishte në Arrëzë gjykoi dhe pushkatoi kryeplakun e fshatit si agjent të armikut. Në Arrëzë u çarmatosën 11 elementë ballistë, pushkët e të cilëve u nisën për në depon e batalionit.

KRASITJA III

Më 24 shkurt u mblodhëm në Sinicë. Me vendim të Byrosë së batalionit u caktua përgjegjës i kompanisë së partizaneve që do të shkonin në Brigadën VII S Guçe Stropani. Mblodhëm batalionin në shkollë dhe ja njoftuam urdhërin e shtabit të qarkut. Me të dëgjuar urdhërin, 39 partizanë dolën vullnetarë. Prej tyre 26 ishin partizanë të vjetër, kurse 13 ishin të rinj. Bashkë me ta u nisën edhe 19 partizanë të batalioneve të ndryshme që kishin ardhur në Devoll gjatë operacionit të dimrit. Ata që kishin qenë të sëmurë e të plagosur lehtë ishin shëruar.

Në mes të fshatit u bë ndarja me vullnetarët për Brigadën VII S. Me keqardhje u ndamë me Guçen e shokët e tjerë. Ata u nisën për në Dardhë

e Vithkuq, kurse ne për në Gjyras. Atë ditë erdhën 5 vullnetarë nga Sinica dhe 5 nga Qyteza.

SPASTROHET EDHE NJË AGJENT

Nga Gjyrasi, me 25 shkurt, arritëm në Hoçisht. Skuadra e Gjqit, shkoi të arrestonte kryeplakun. Atë e kishte lajmëruar Tefiku dhe ishte fshehur bashkë me shokët e tij. Menjëherë u bë rrethimi i fshatit. Të nesërmen kryeplaku u gjend dhe u arrestua. Disa elementë të lëkundshëm nga Hoçishti ndërhyjnë për ta liruar kryeplakun.

Në mbrëmje batalioni lëvizi për në Vërren. Atje gjyqi i batalionit gjykoi kryeplakun e Hoçishtit dhe e dënoi me pushkatim si shërbëtor të armikut. Vendimi u zbatua më 27 shkurt.

Të nesërmen u nisëm nga Vërreni për në Ziçisht. Mitua me një skuadër shkoi përpara. Afër Ziçishtit, ai goditet nga një grup ballistësh që kishin zënë vend në korijet e Sulit. Me të dëgjuar të shtënat e pushkëve, partizanët sulmuan drejt koriëve. Ballistët u tërhoqën, ata hynë brenda në Sul.

NJË NDESHJE TJETËR ME ARMIKUN

Marsi i vitit 1944 filloi me një tufan që s'kishte të pushuar. Shtëllungat e dëborës ngriheshin në ajër! Era frynte me tërbim. Bënte ftohtë!

Ato ditë u vërtitëm në Ziçisht, Sinicë, kurse në mbrëmjen e 3 marsit arritëm në Dardhë.

Atje bëmë mbledhjen e dy celulave. Punuam kapitullin I të «Historisë së Partisë Komuniste të

B.R.S.S. (Bolshevike). Bëmë edhe mbledhjen e batalionit së bashku me popullin, të cilin e informuam për sukseset e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe fitoret e reja të Ushtrisë së Kuqe, pas shpartallimit të gjermanëve në Leningrad.

Në mbrëmjen e 6 marsit arritëm në Vidëhovë. Fshatarët i morën vetë partizanët nëpër shtëpitë e veta. Secili medonte t'i kënaqte sa më shumë.

Të nesërmen në mëngjez në Vidëhovë, erdhi nga Poloska anëtari i njësitit guerril, Xhevat Qerimi: Ai raportoi shpejt:

«Gjermano-ballistët po rrethojnë Menkulasin e Ponçarën. Forcat e tyre nga Bilishti kanë lëvizur gjatë gjithë natës. Unë ika me nxitim».

U dha menjëherë alarmi dhe partizanët e batalionet u grumbulluan në sheshin e fshatit. Nga ana e shtabit u njoftua:

«Armiku kujton se ne jemi në Menkulas ose në Ponçarë. Ashtu si plot një vit më parë në Hoçisht ai kërkon edhe sot të godasë batalionin në befasi. Le t'i japim atij përgjegjen e merituar!

Një skuadër me Fazon të niset drejt Menkulasit. Të lajmërohen menjëherë partizanët që kanë shkuar rëpër familjet e veta në Menkulas. Forcat e tjera të rreshtohen në pozicionet kodrinore mbi Ponçarë e karshi Menkulasit.»

Një urra e gjatë, që dilte nga gjokset partizane, oshëtia në të gjithë Vidëhovën.

Forcat e batalionit u vunë në lëvizje. Njëshkolona partizane çau rrugën mbi dëborën e pashkelur.

Skuadra e Fazos u nis më përpara. Ajo zbriti me shpejtësi tek lumi. Menkulasin e kishte afër, por nuk mund të hynte.

Një grup ballistësh e gjermanësh ishte përqëndruar në lagjen e poshtme të fshatit.

Fazua vendosi skuadrën në pozicion dhe urdhëroi për goditje. Me zjarrin e parë, armiqtë u shpërndanë, duke lënë në vend 3 të vrarë. Por s'kaloi shumë kohë dhe përsëri e morën veten, filluan të përgjigjeshin me pushkë dhe mitralozë të shumtë.

Skuadra e Fazos bënte lëvizje drejt kodrave. Ajo doli në pararojë të forcave të tjera të batalionit. Gjithë partizanët u vendosën në pozicione. Zjarrin e batalionit mbi armikun u dendësua. Por edhe gjermano-ballistët u përgjegjën shpejt. Ata vunë në veprim edhe artilerinë.

Mbas një zjarri të dendur një grup prej tyre u vërsul drejt pozicioneve të batalionit por u thye dhe u tërhoq duke lënë në zallin e lumit 2 të vrarë.

Armiku, të cilit i hipi gjaku në kokë, e shtoi zjarrin. Predhat e topit dhe të mortajave vinin njëra pas tjetrës. Fazua u bëri thirrje partizanëve.

«Përpara, shokë të skuadrës!» thirri ai, dhe të gjithë u nisën drejt kodrës ku ishte vendosur një mitraloz armik. Me ta u bashkua edhe Nesimi i Braçanjit, që kishte ardhur nga fshati. Përkrah tij qëndron Koci Drenova. Shkojnë në ballë të sulmit.

Sulmojnë, godasin, por armiku nuk tërhiqet. Kur po ngjite kodrën, Nesimi plagoset... Ashtu i plagosur zë një vend e qëllon. Të tjerët ecin përpara. Duke qëlluar me bomba dore, ata e shpërngulin armikun nga pozicioni dhe i shkaktojnë 3 të vrarë. Por edhe Nesimi me Kocin nuk janë më. Në sulmin drejt kodrës ata u goditën për vdekje nga plumbat e armikut.

Koci pak kohë kishte që kishte ardhur në ba-

talion. Ai qe i ri, por trim e guximtar. Xha Nesimi nuk ishte efektiv i batalionit.

— Unë jam plak, — thoshte ai, — e s'e ndjek dot, por në çdo luftim që të bëhet do të mundohem të jem pranë.

Edhe atë natë ai ishte te miqtë e vet në Pongarë. Fshati u rrethua, por ai mundi të dalë e të bashkohet me forcat e batalionit. Në sulmin e skuadrës ai mori pjesë vullnetarisht.

Në krahun e majtë të batalionit u vra duke luftuar partizani trim Shaban Braçanji. Ai hyri në radhët partizane që në korrik të vitit 1943.

Lajmi i vdekjes së shokëve u përhap në të gjithë batalionin: Ndjenja e urrejtjes për armikun u shtua edhe më tepër. Partizanët sulmuan pozicionet e armikut. Armiku u mbyll brenda fshatit.

Në drekë zjarri pushoi. Në mbrëmje forcat e batalionit kaluan në Qytezë e në Sinicë.

MBLEDHJE, TRAKTE, LUFTË.

Më 9 mars u nisëm me Sotirin nga Sinica për në Dardhë. Në bazë të vendimeve të celulës duhej të nxirrnim gazetën e batalionit dhe urdhërin mbi ndalimin e kondrabandës. Në Dardhë gjetëm edhe një pjesë të batalionit «Hakmarrje». Më 10 mars erdhën Bahriu e Ndreku me gjithë kompaninë. Ata vinin nga Nikolica, ku u kishin dhënë 7 armë dhe 4 dhen si dhuratë për batalionin. Me 11 mars Lefteri bëri mbledhjen e celulës së kompanisë. Më 12 mars me Sotirin përfundam traktet për t'ja shpërndarë popullit. Në mbrëmje ato u shpërndanë në të gjithë Devollin. Po atë mbrëmje Ndreku bëri mbledhjen

e celulës. Më 13 mars u bë mbledhja e byrosë kurse më 14 mars mbledhja e të dyja celulave ku u punua kapitulli II i «Historisë së Partisë Komuniste (Bolshevike) të BRSS.

Por armiku përgatitej për një operacion në Devoll. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që njihte mirë situatën, mendoi t'i jepte armikut përgjegjen e merituar. Për të mos e lënë batalionin «Fuat Babani» të izoluar, ai urdhëroi që të futeshin në Devoll 2 batalione të Brigadës IV S. Më 16 mars Gaqua solli një letër nga shtabi i Brigadës IV, i cili njoftonte: Më 19 mars do të vijnë 2 batalione të brigadës. Hapni rrugën për kafshët. Të mbahet sekreti më i madh».

Më 17 mars fshatarët e Dardhës, Arrëzës dhe partizanët, filluan të hapnin nga dëbora rrugën ku do të kalonin kafshët e Brigadës IV. Fshatarët filluan të mendonin se aty do të kalonin mortaja, topa.

Më 19 mars mbërriti në Dardhë batalioni I, kurse më 20 mars batalioni II i Brigadës IV Sulmuese. Shokët e shtabit të brigadës koordinuan veprimet.

Më 21 mars batalioni «Fuat Babani» dhe batalionet e Brigadës IV S u ndeshën menjëherë me armikun, që tentonte të kalonte në Dardhë, Arrëzë, Sinicë e Qytezë. Lufta zhvillohej gjithë ditën me ashpërsinë më të madhe. Gjermanët e ardhur nga Bilishti tentonin të kalonin në Dardhë nga ana e Arrëzës. Forcat partizane, që kishin marrë masat e duhura, sulmonin. Nga çdo anë kërciste bomba dhe mitralozi. Gjermanët filluan të largohen. Në Sinicë ata donin të rezistonin, por sulmi partizan i shtyu më poshtë, në Qytezë, por edhe aty s'qëndruan dot. Ndërkohë forca të reja gjermane mbërritën nga

Bilishti. Afër Bozhigradit ato goditën nga një kompani e batalionit «Fuat Babani», që ishte vendosur në Vidëhövë. Gjermanët me forca të shumta ju afëruan Vidëhövës. Në përpjekje, të borigat, u vranë partizani i vjetër i çetës «Morava», Bajram Sinica, si dhe partizani Mazllëm Karaiskaj nga Bilishti, ndërsa Gurtaliu u plagos.

Kur ra nata, lufta u ndërpre. Armiku u vendos në Bozhigrad.

Të nesërmen, më 22 mars, lufta filloi që heret në mëngjez. Partizanët sulmuan Bozhigradin. Armiku u përpoq të rezistonte, por më në fund u tërhoq duke lënë me dhjetëra të vranë. Partizanët hynë në Bozhigrad, ku zunë një top gjerman dhe sasi të madhe municionesh.

Më 23 mars lufta u ndërpre. Me 24 mars ajo filloi përsëri. Afër drekës një bombardues gjerman erdhi mbi Qytezë, mbi pozicionet tona, dhe filloi bombardimin. Nga katër bombat që hodhi, asnjëra nuk plasi. Aty nga dreka partizanët sulmuan dy herë mbi Bozhigrad, por pa sukses, sepse forcat armike ishin të shumta dhe mbroheshin nga shtëpitë dykatëshe, që zbulonin çdo lëvizje të partizanëve. Pas dy ditësh u ndërpre luftimi. Bashibozukët u vendosën në Sul e Koshnicë. Më 27 mars forcat partizane i sulmuan këto fshatra. Armiku përdori artileri nga Poloska, por kjo nuk i ndaloi partizanët të hynin në fshat dhe të thyenin armikun.

Grushtat e ditëve të fundit i detyruan gjermanët e ballistët të tërhiqen e të mbyllen në Bilisht. Batalionet e Brigadës IV S. e kryen detyrën e tyre. Ata, së bashku me batalionin «Fuat Babani», goditën armikun në çdo lëvizje. Më 6 prill u nisën nga Dardha për në zonën e Ersekës.

Batalioni «Fuat Babani» filloi të bënte një punë të gjerë politiko-ushtarake.

Më 20 prill u bë në Dardhë mbledhja e celulës. Më 21 dhe 22 prill kompania e Lonit bëri stërvitje në lëndinat e Shën-Pjetrit. Në bazë të vendimeve të shtabit, një pjesë e kompanisë së Lonit u nis, më 23 prill, me Lonin e Lefterin për Gjyras, kurse pjesa tjetër, me shokë të shtabit të batalionit, drejt fushës. Kompania e Hamdiut u njoftua që të fillonte lëvizjen Tren-Rakickë. Brenda pak ditëve gati të gjitha fshatrat u përshkuan nga forcat e batalionit. Kudo u bë çarmatimi i ballistëve.

Ndërkohë nga Bilishti mbërritën në Dardhë 15 vullnetarë, kurse nga Suli 12. U shtypën qarkoret për lejeqarkullimet në kufi. Doli dhe numri i parë i gazetës së xhepit.

Më 28 prill kompanitë e batalionit mbërritën në Dardhë me efektiv më të madh. Në Tren ishin marrë 40 pushkë, në Rakickë 25, në Baban Loni kishte mbledhur 23 pushkë dhe kishte bërë një goditje në fshat me një grup ballistësh.

Në mbremje erdhi një letër nga qarkori. Ajo njoftonte transferimin e Myzaferit nga Devolli për në Lavdar. Si komisar batalioni caktohej Faiku. Urdhëri kërkonte nisjen e menjëhershme. Të nesërmen, më 29 prill 1944, mbasdreke, mbasi u ndamë me të gjithë shokët, u nisëm për Boboshticë së bashku me Vasfiun e Latifin e prej aty për në Po-lenë.

NJË VEPRIM I SHTREMBËR

Më 30 prill përcollëm nga Lavdari për në Shtabin e Përgjithshëm informacionin mbi veprimet e fundit të batalionit «Fuat Babani». Në informacion, përveç veprimeve luftarake, flitej edhe për qëndrimin politik të fshatarësisë dhe për punën e kryer nga ana jonë. Në të shkruanim se disa elementëve reaksionarë, ballistë të Sulit e të Bozhigradit, ua kishim marrë bagëtitë në mal. Ato dhen që ua morëm atyre dhe ato që i ishin dhënë batalionit si dhuratë, i bashkuam në një kope. Ne e bëmë këtë raport duke qenë krenarë dhe plotësisht të bindur se kishim vepruar mirë.

Raportin e mori shoku ENVER HOXHA. Ai na u përgjegj menjëherë. Ai na lavdëroi për sukseset e batalionit në luftën kundër armikut. Për çështjen e bagëtive të Sulit e të Bozhigradit shoku ENVER HOXHA na kritikoi rëndë, duke na shkruar se në qoftë se disa fshatarë të Sulit e të Bozhigradit nuk janë me ne, kjo rrjedh nga puna e paktë politike që është bërë me ta. Në qoftë se ne duam që bozhigradasit e Sularët të vijnë me ne, kjo nuk arrihet duke ua marrë bagëtitë, por duke i sqaruar sa më shumë për drejtësinë e luftës sonë.

Në fund të letrës shoku ENVER na urdhëronte që t'ua kthenim fshatarëve menjëherë të gjitha bagëtitë që ua kishim marrë me forcë. Kritika që na u bë ishte e drejtë dhe ne e pranuan që kishim vepruar shtrembër.

Latifi e Vasfiu u nisën menjëherë për në Devoll, që të shpinin urdhërin e shokut ENVER. Urdhëri i dhënë u zbatua menjëherë.

TRADHETIA VAZHDON

Fitoret e Ushtrisë së Kuqe dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare po e bënë të qartë të ardhmen e Gjermanisë naziste dhe të bandave tradhëtare në vendin tonë. Krerët e Ballit po e kuptonin se Gjermania e humbi luftën dhe po përpiqeshin të gjenin mbështetje tek armiqtë e tjerë të popullit tonë.

Për këtë qëllim, në prill të vitit 1944, nisët për Greqi tradhëtari Dhimitër Fallo. Ai ishte ngarkuar të përfundonte marrëveshje të veçanta me monarko-fashistët e Greqisë.

Nga dokumentat që ndodhen në Muzeumin e Luftës nacional-çlirimtare në Korçë, del se Dhimitër Fallua merrte udhëzime nga qendra e Ballit Kombëtar dhe qeveria kuislinge në Tiranë.

Në letrën Nr. 191/7 të datës 10.V.1944, Mehdi Frashëri i shkruante Dhimitër Fallos në Selanik:

«Arrini marrëveshje me grekët..., qoftë edhe duke i vënë forcat tona nën komandën e tyre. Komandanti i forcave të përbashkëta le të jetë grek...»

Pra, Mehdi Frashëri e shiste Shqipërinë, vetëm e vetëm për të shpëtuar lëkurën e vet.

Me shkresën e datës 2.V.1944, Mehdi Frashëri, si kryetar i Ballit Kombëtar, lëshon një autorizim për Dhimitër Fallon. Në të thuhet:

«Zoti Dhimitër Fallo është i ngarkuar nga Komiteti Qendror i Ballit Kombëtar që të lidhë e të nënshkruajë me Partinë Nacionalçlirimtare Greke çdo marrëveshje».

Por në atë kohë partizanët grekë nuk pranuan asnjë marrëveshje me krerët e Ballit.

Bahri Omari, si ministër i jashtëm i qeverisë

kuislinge të asaj kohe, me datën 4 maj 1944, i dërgoi një letër rekomandimi (frengjisht) Dhimitër Fallos, në të cilën thuhet:

«... luten shtetet miq të Shqipërisë që të ndihmojnë z. Dhimitër Fallo në detyrën e ngarkuar...»

Por edhe kjo tradhëti e re nuk e ndaloi shpartallimin e krerëve të Ballit Kombëtar. Ata u bënë njerëzit më të urryer.

TRE DESHMORË TË RINJ

Më 14 maj, një kompani e batalionit ndodhej në Progër. Forcat gjermano-balliste nisen nga Piliuri e Cangonji në drejtim të Progrit. Një pjesë partizanësh, u dalin përpara nga ana e Maçurishtit, të tjerët vendosen drejt xhadesë. Përpjekja fillon menjëherë gjatë bregut të lumit. Forcat e armikut shtohen. Artileria vendoset në xhaden kryesore të Bilishtit. Mbi pozicionet partizane dhe mbi fshat dendësohen predhat. Mbas dy orësh e gjysmë luftimi, kompania e batalionit fillon të tërhiqet drejt Malit të Pavliqit. Ajo nuk mund të zhvillonte luftë pozicioni me forcat e shumta të armikut. Gjatë luftimit, në përlëshje me armikun, mbeti i vranë i riu Ismail Gjata nga Cangonji. Ai ishte një nga aktivistët më të mirë të organizatës së rinisë në Devoll. Me zjarrin e rinisë ai u hodh në sulm mbi armikun. Në këtë përpjekje të ashpër u vranë edhe dy të rinjtë e Progrit: Maqo Lakrori dhe Petraq Dushi, të cilët nuk deshën të dorëzoheshin në duart e armikut.

NGA ÇDO ANË GODITJE MBI ARMIKUN...

Në ditët e para të majit në Grapsht u bë mbledhja e shtabit. Aty u vendos që të zgjerohej puna politike ndër fshatra dhe të dendësoheshin goditjet mbi armikun. Pastaj u bë mbledhja e gjithë batalionit.

Më 2 maj, në Sinicë u mbledhën përfaqësuesit e Dardhës, Arrëzës, Qytezës e Sinicës. Faiku punoi vendimet e konferencës mbi forcimin e këshillave nacionalçlirimtare. Në këtë mbledhje të përfaqësuesve më të mirë të fshatrave u zgjodh këshilli komunal i Dardhës. Më 7 maj në Grapsht u zgjodh këshilli komunal i Hoçishtit, ku kishte përfaqësues nga Hoçishti, Vërteni, Ziçishti, Grapshti dhe Bradvica.

Njëri mbas tjetrit u zgjodhën edhe këshillat komunale të Progrit, Bozhigradit dhe Bilishtit.

Më 6 maj një kompani e batalionit goditi në Dumbravë të Poloskës një bandë balliste të shoqëruar nga gjermanët, që drejtoheshin nga Bilishti për në Sul. Goditja filloi në orën 3 mbasdreke dhe zgjati deri në orët e vona të mbrëmjes. Ballistët dhe gjermanët nuk u kthyen menjëherë. Ata tentuan të çanin rrugën drejt Sulit, por më në fund u detyruan të iknin të shpërndarë nëpër fusha drejt Bilishtit.

Më 21 maj, në orët e para të mëngjezit, forcat e batalionit, duke zbritur nga Morava, goditën përnjëherësh postbloqet armike në Dishnicë, Zëmlak e Cangonj. Veprimet e batalionit i detyruan ballistët të grumbulloheshin në baza të sigurta, në vende që mbroheshin nga gjermanët.

Më 23, 24 dhe 25 maj, të goditur nga kompanitë e batalionit ata u shpërngulën edhe nga Suli e

nga Tresteniku, duke i lënë edhe këto baza të rëndësishme. Ata u futën në Bilisht, nën mbrojtjen e gjermanëve. Mbas luftimesh të ashpra forcat e batalionit hynë edhe në këto fshatra. Shumë ballistë u zunë rob. Fshatarët, që ishin armatosur me detyrim prej Ballit, i dorëzuan armët. Komunistët e batalionit zhvilluan një punë të madhe politike me fshatarët, duke u folur atyre për tradhëtinë e Ballit Komëtar. Fshatarët që ishin gënjyer nga Balli u lanë të lirë. Një pjesë e tyre u rrjeshtua në radhët e batalionit.

Më 27 maj kompania e dytë e batalionit, goditi një kolonë gjermano-balliste që vinte nga Kamënica. Kompania III po atë ditë goditi një kolonë tjetër armike ndërmjet Vërlenit dhe Çipanit. Lëvizjet e armikut gjatë rrugës Bilisht-Bozhigrad-Dardhë-Korçë i detyruan forcat e batalionit që të rrjeshtoheshin gjatë vijës kufitare me Greqinë, në pozicionet mbrojtëse më të favorshme. Mbas dy ditësh në rrugën Bilisht-Dardhë-Boboshticë, kaluan forca të mëdha gjermane të pajisura me mjete të koracuara dhe me artileri. Ato erdhën nga Greqia.

KRASITJA IV

Më 29 maj batalioni u mblodh për konferencë, ku u punua trakti i shtabit të Qarkut të Korçës, i cili njoftonte mbi mbledhjen e Kongresit të Përmetit. Formimi i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar me shokun Enver Hoxha në krye dhe caktimi i shokut Enver si Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare ngjalli një gëzim të madh në të gjithë partizanët. Funkcionet e Komitetit, që

ishte një qeveri e përkohshme, ishin një grusht i rëndë për armikun. Në ditët e para të qershorit, trakti i shtabit të qarkut filloi të punohej edhe në mbledhjet me fshatarët.

Po ato ditë u muar vesh se në Gorë-Opar, kishte filluar operacioni armik. Edhe në Devoll batalioni përgatitej për ndeshje. Kompanitë e batalionit u hodhën përsëri në sulm. Më 10 qershor, një kompani e batalionit goditi ballistët në Sul dhe në Menkulas. Dy ballistë u vranë, kurse 3 u zunë rob. Më 11 qershor kompania tjetër goditi një grup plaçkitësish gjermanë, që drejtoheshin për në Hoçisht dhe vrau dy prej tyre. Po atë ditë, një skuadër e batalionit goditi tek Guri i Cjapit një grup xhandarësh që ishin nisur për plaçkitje në Bradvicë. Më 12 qershor, forca të tjera të batalionit goditën në të dalë të Sinicës një grup gjermanësh e ballistësh, të cilët kishin vënë përpara bagëtitë që kishin marrë në Dardhë e në Sinicë. Armiku u tërhoq në panik. Të gjitha bagëtitë ju kthyen fshatarëve.

Në zjarrin e këtyre luftimeve, me urdhër të shtabit të qarkut të Korçës, më 17 qershor, 170 partizanë u nisën për në Opar, për të marrë pjesë në inaugurimin e Brigadës XV sulmuese, në efektivin e së cilës do të ishin edhe vetë. Së bashku me ta u nisën edhe kuadro të vjetra të batalionit si Lefteri, Hamdiu, Miltua e të tjerë. . . Partizanët që mbetën u inkuadruan në dy kompani të vogla, të cilat u zmadhuan shpejt. Thirrja e celulës së batalionit për vullnetarë të rinj, solli në batalion me qindra partizanë të tjerë. Forcat e batalionit filluan përsëri sulmin mbi armikun. Urdhëri i Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, shokut

ENVER HOXHA, për të goditur pa ndërprerje armikun, u punua me të gjithë partizanët.

NË GRYKAT E KAPSHTICËS

Me 10 korrik, grykat e thella të Kapshticës gjëmuan nga zjarri i partizanëve të batalionit. Që në mbrëmjen e 9 korrikut një kompani e batalionit u vendos në pozicionet shkëmbore në krahun e Vërnikut. Në mëngjez ajo sulmoi grupin e gjermanëve që rregullonte linjën telefonike Kapshticë-Follorinë. Dy gjermanë mbetën të vrarë, ndërsa të tjerët vrapuan menjëherë drejt kufirit. Partizanët menjëherë filluan të mblidhnin telat, por nuk shkoi shumë kohë kur një makinë gjermane kaloi rrugën tek «Dogana» dhe zbriti drejt Kapshticës. Ajo vinte nga Follorina. Partizanët e lanë punën e filluar dhe u vendosën prapa shkëmbinjve. Porsa kamioni mbërriti afër, partizanët filluan goditjen. Gjermanët zbritën nga kamioni, u munduan të zinin pozicione të përshtatshme por nuk mundën. Kështu ata u detyruan të tërhiqeshin drejt Kapshticës duke lënë dy të vrarë. Partizanët kaluan në Vërnik e në Bitinckë.

ME PARTIZANËT E BRIGADËS II S.

Më 21 korrik, një batalion i Brigadës II S., arriti në Hoçisht, ku u takua me forcat e batalionit «Fuat Babani» Gëzimi i të dy palëve qe i madh. Tiranasi e devollinjtë i treguan njëri-tjetrit mbi luftën që kishin zhvilluar secili. Por në mes të atij

gëzimi plasi pushka. Në fushën poshtë Hoçishtit, partizanët u përleshën me gjermanët, që vinin nga Bilishti. Lufta bëhej me ashpër nga njëri çast në tjetrin. Në krye të forcave gjermane doli autoblin-
da. Zjarri i saj i detyroi partizanët të largoheshin në pozicionet kodrinore midis Vërlenit e Hoçishtit. Duke kaluar nga Hoçishti për në Gracë, gjermanët u kthyen përsëri drejt Bilishtit. Në këtë përpjekje u vra partizani Nuri Ohrani nga Gollobërda.

Më 25 korrik shtabi i batalionit u takua me komandantin e Brigadës II S., shokun Beqir Balluku. Ata vendosën të koordinonin veprimet kundër armikut. Më 26 korrik, forcat e batalionit «Fuat Babani», goditën postblokun e Drenovës, ndërsa forcat e Brigadës II S. goditën armikun në Mborje dhe Kamenicë. Më 29 korrik forcat e batalionit «Fuat Babani» dhe ato të Brigadës II S. goditën forcat gjermano-balliste në Bozhigrad. Mbas një goditjeje të ashpër, forcat armike u tërhoqën duke lënë 5 të vrarë. Nga forcat e Brigadës II S. ranë dëshmorë 2 partizanë, ndërsa 5 të tjerë u plagosën.

Më 10 gusht shumica e forcave balliste të Devollit u grumbulluan në Baban. Një batalion i Brigadës II S. dhe forcat e batalionit «Fuat Babani» e rrethuan këtë fshat nga tri anë. Ballistët, që diktuan se kishin ardhur partizanët, u vendosën në shtëpitë më të larta të fshatit, nga katet e sipërme të të cilave shtinin pa pushim mbi partizanët. Partizanët vazhdonin të sulmonin dhe të futeshin nëpër rrugica Ballistët u tërhoqën të tmerruar. Një pjesë e tyre u tërhoq nga Kopaci, 58 u dorëzuan, kurse 8 mbetën të vrarë. Prej partizanëve, në lagjen e sipërme të Babanit, u plagos rëndë komisar i batalionit II të Brigadës II S. Raqi The-

meli. Raqin e tërhoqën drejt Hoçishtit. Pa mbërritur në fshat, ai vdiq në duart e shokëve me këngën «Hakmarrje rini!» në gojë. Të nesërmen, në Grapsht, partizanët e fshatarët e varrosën me lot në sy Raqin.

Devollinjtë e njihnin Raqin që në fillim të Luftës nacionalçlirimtare në Devoll. Ai ishte komisar i parë i çetës «Morava». Punëtori i Korçës, marangozi Raqi Themeli, braktisi familjen e vet dhe hyri në gjirin e popullit të Devollit. Ai u bë një nga bijtë e tij më të mirë, më besnikë e më guximtarë. Si komunist ai ishte një nga edukatorët e parë të partizanëve në Devoll. Ja pse qe e madhe dhimbja e të gjithëve.

SHKRIRJA E BATALIONIT

Partizanët që shkuan në Brigadën XV S. u zëvendësuan shpejt. Partizanë të rinj zgjeruan radhët e kompanive. Një kompani e re u formua në fund të gushtit, kurse një kompani e madhe prej 150 partizanësh, me komandantin e komisarin e saj, u largua nga batalioni. Me urdhër të shtabit të qarkut ajo u nis për në Brigadën XX S. Bashkë me të u largua edhe zëvendëskomandanti i batalionit Loni Dimoshi. Pjesa e batalionit që mbeti në Devoll u nda në dy kompani, njëra prej të cilave kishte komandant Emin Tahon kurse tjetra Ramadan Dobranjin. Si komisar kompanish u caktuan Pandi Gjezi e Servet Dvorani. Edhe këto kompani u zgjeruan shpejt. U formua kompania III. Batalioni, me më shumë se 200 partizanë, vazhdoi përsëri goditjet mbi armikun.

Më 10 shtator, së bashku me forcat e batalionit II të Brigadës II S., batalioni «Fuat Babani» hyri në Bozhigrad. Ballistët e fundit u tërhoqën për në Bilisht. Shumë fshatarë nga Bozhigradi, Suli e fshatrat e tjera u futën në radhët e batalionit. Armët e shpërndara nga ballistët ju dorëzuan batalionit.

Më 12 tetor forcat e batalionit «Fuat Babani» kaluan Moravën dhe u futën në fushën e Korçës. Me urdhër të shtabit të qarkut ato u inkuadruan në radhët e Brigadës IX S., që ishte formuar ato ditë. Në majën e Moravës buçitën si një jehonë fjalët: «Lamtumirë, Devoll!» që dilnin nga zemrat e partizanëve.

Me parullën «Vdekje Fashizmit» ata u futën në Brigadën IX S. Dhe partizanët e Devollit luftuan me vetëmohim në të gjitha anët e atdheut si pjesëtarë të denjë të brigadave sulmuese të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare.

PËRMBAJTJA

Parathënje	3
Dy fjalë mbi Devollin	6
Muajt e parë të vitit 1942	9
Çeta «Morava»	14
Komunistë dhe nacionalistë	17
Një partizan më shumë	19
Spastrohet një armik	22
Fuat Babani — partizan dhe komandant	23
Celula dhe çeta	24
Në rrugën e çetës	27
Në përpjekje me armikun	29
Nga Sinica në Polenë	33
Tre dëshmorët e parë	35
Larg Devollit	41
Dy dëshmorë të rinj	44
Një «Mestan» në mal të thatë	46
Sulmi mbi Leskovik	48
Çeta e bashkuar	52
Vëllezër në luftë	53
Batalioni	54
Zjarre për fashistët	57
Një marrëveshje pa sukses	58
Batalionet shtohen... Lufta zgjerohet	62

Krime balliste	64
Gjakësorët e rinj	65
Dy dëshmorë të tjerë	69
Përleshje në Moravë	70
Edhe një grusht tjetër për gjermanët	73
Mysafirë në Dardhë	76
Operacioni	78
Në ndihmë të maqedonasve	81
Sqarime-organizim	81
Një «Vullnetar»	83
Sulmi mbi ballistët	84
Në ndihmë të Rrëzës	87
Këshillat nacionalçlirimtare të komunave	87
Pregatitje për festë	89
Luftë në Gorë	90
Një goditje për vitin e ri	99
Shokë të plagosur	103
Përsëri me ballistët e gjermanët	105
Krasitja III	110
Spastrohet edhe një agjent	111
Një ndeshje tjetër me armikun	111
Mbledhje, trakte, luftë	114
Një veprim i shtrembër	118
Tradhëtia vazhdon	119
Tre dëshmorë të rinj	120
Nga çdo anë goditje mbi armikun	121
Krasitja IV	122
Në grykat e Kapshticës	124
Me partizanët e Brigadës II S	124
Shkrirja e batalionit	126

Tirazhi 5000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

SHTYP N.I.Sh. SHTYPSHKRONJAVE «MIHAL DURI»
STABILIMENTI «8 NËNDORI» — TIRANË 1969